



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.182

dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.1010, datë 10.12.2010	Për miratimin e shtesës nr.3 të kontratës, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe “Lockheed Martin Global, Inc” për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror shqiptar, të miratuar me vendimin nr.665, datë 18.12.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar 10151
Vendim i BSH nr.83, datë 13.12.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.44, datë 8.6.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” 10206
Vendim i BSH nr.88, datë 22.12.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave” 10208
Vendim i BSH nr.89, datë 22.12.2010	Për disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” 10209
Vendim i BSH nr.90, datë 22.12.2010	Për një ndryshim në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka” 10209
Vendim i BSH nr.91, datë 22.12.2010	Për shfuqizimin e udhëzimit “Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave”, miratuar me vendimin nr.45, datë 12.6.2002 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 10210

VENDIM
Nr.1010, datë 10.12.2010

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS NR.3 TË KONTRATËS, NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTERIA E PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT DHE “LOCKHEED MARTIN GLOBAL, INC” PËR
MODERNIZIMIN E SHËRBIMIT TË TRAFIKUT AJROR SHQIPTAR, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN NR.665, DATË 18.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 “Për aviacionin civil shqiptar” dhe të neneve 128 e 151 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës nr.3 të kontratës, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil), dhe “Lockheed Martin Global, Inc”, për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror shqiptar, të miratuar me vendimin nr.665, datë 18.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektkontratës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe “Lockheed Martin Global, Inc”, “Për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror shqiptar”, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Fondet për financimin e shtesës së kontratës të përballohen nga Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA).

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA) për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LOCKHEED MARTIN

AFATET DHE KUSHTET E KONTRATËS ALBANIA NAMP

AMENDIM I RISHIKUAR 3
1 TETOR 2010

QEVERIA SHQIPTARE DHE LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC

KONTRATË KRYESORE LIDHUR ME PROGRAMIN E MODERNIZIMIT TË HAPËSIRËS
AJRORE KOMBËTARE (NAMP SHKURTIMI NË ANGLISHT)

Çështja 5

Numër reference: ALBGEN02-0025

8.12.2008

Rishikuar më 1.10.2010

Lockheed Martin Global Inc.
IS&GS Civil
9211 Corporate Boulevard
Rockville, Maryland 20850
USA

ABDIKIM
KONTRATA NAMP

Ky dokument i jepet Ministrisë Shqiptare të Punëve Publike dhe Transportit për qëllimet e fazës së 3-të, amendimit të 3 për NAMP (programi i modernizimit të hapësirës ajrore). Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të kopjohet, fotokopjohet, riprodhohet, përkthehet apo të kthehet në ndonjë formë elektronike të mesme apo në ndonjë program lexues pa miratimin paraprak me shkrim të Lockheed Martin Corporation. Logot *SkyLine* dhe Lockheed Martin janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të Lockheed Martin Corporation. Këta artikuj të përdorimit të gjerë, teknologji apo *software* janë eksportuar nga Shtetet e Bashkuara në përputhje me rregullat e administratës së eksportit për destinacion final Shqipërinë. Devijimi në kundërshtim të ligjit të SHBA-së është i ndaluar.

KONTROLLI I DOKUMENTIT TË KONTRATËS
HISTORI NDRYSHIMESH

Inspektimi	Data e publikimit	Përmbledhje ndryshimesh
Versioni 0.1	Tetor 2002	Drafti fillestar
Versioni 1.0	4 nëntor 2002	Versioni i bazuar në linjë
Versioni 2.0	6 nëntor 2002	Versioni i bazuar në linjë
Versioni 2.1	7 nëntor 2002	Versioni i negociuar fillimisht
Versioni 3	13 nëntor 2002	Versioni i rishikuar i bazuar
Versioni 4	13 nëntor 2002	Versioni i rishikuar i bazuar
Versioni 5	22 nëntor 2002	Versioni i rishikuar i bazuar
Çështja 1	30 dhjetor 2002	Versioni i rishikuar i bazuar
Çështja 2	30 qershor 2008	Rishikuar për amendimin 2
Çështja 3	15 gusht 2008	Rishikuar për amendimin 2 të rishikuar
Çështja 4	8 dhjetor 2008	Rishikuar për amendimin 2 të rishikuar
Çështja 5	1 tetor 2010	Rishikuar për amendimin 3

Kjo Marrëveshje e bërë sot më datë 30.12.2002, që këtej e tutje e referuar si “Kontratë”, e lidhur ndërmjet palëve: Qeverisë Shqiptare, Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, me seli kryesore të biznesit në Rrugën e Kavajës, përballë Xhamisë Tiranë, Shqipëri, e që këtej e tutje e quajtur si “Blerësi” dhe palës tjetër, Lockheed Martin Global Inc, një degë e Lockheed Martin Corporation me seli qendrore biznesi në adresën: 9211 Corporate Boulevard, Rockville, në shtetin e Maryland SHBA, që këtej e tutje e referuar ose e quajtur si “Shitësi”. Blerësi dhe Shitësi mund të quhen, gjithashtu, në njëjës si “Palë” dhe në shumës si “Palët”.

Meqenëse Shitësi dëshiron të sigurojë mallra ose shërbime të caktuara ose të dyja së bashku ndaj Blerësit; dhe

Meqenëse Blerësi dëshiron të blejë këto mallra apo shërbime ose të dyja së bashku me çmimet e siguruar në këtë, dhe subjekt ndaj kushteve dhe afateve të rëna dakord më sipër; dhe

Meqenëse Blerësi dhe Shitësi dëshirojnë të hynë në këtë Marrëveshje për të gjithë programin për të implementuar modernizimin e plotë të infrastrukturës ANS për periudhën 2002 deri në 2006. Programi ndahet në dy faza:

Faza 1

Asistimi i Republikës së Shqipërisë për të arritur financimin komercial. Sigurimi i produkteve që kanë afat të gjatë dhe shërbimet e nevojshme për të mundësuar instalimin e sistemit të automatizimit fillestar, në mënyrë të tillë që të arrihet një mjedis me kontroll radarësh në fazën e 2. Sigurimi i asistencës në operacionet e trafikut ajror për të arritur aftësi kontrolli me radar për 6 muaj pas datës efektive të kontratës, duke përdorur mjedisin aktual të kontrollit. Modifikimi dhe rinovimi i ndërtesës ekzistuese ACC/APP në mbështetje të instalimit të sistemit të automatizimit fillestar. Përfundimi i ndërtesës në mënyrë të shpejtë për një ACC dhe kullë të re. Përfundimi i çështjeve/detyrave të ndryshme të operacioneve të trafikut ajror. Kjo punë u financua drejtpërdrejt nga të ardhurat e ANTA-s. Kjo punë është pjesë përbërëse e kontratës dhe e programit dhe do të konsiderohet pjesë e kontratës dhe e programit për të mbështetur llogaritjen vlerës së programit dhe përmbajtjes së SHBA-së për qëllime të marrëveshjes së kredisë së garantuar nga Exim Bank SHBA.

Faza 2

Sigurimi i një sistemi fillestar automatizimi për të arritur një kapacitet kontrolli me radar për trafikun e verës 2004, Olympics, duke përfshirë hapjen e një sektori të ri në po të njëjtin vend. Projektimi i një ndërtese kulle të re ACC/APP. Modernizimi i komunikimeve, navigacionit, mbikëqyrjes dhe nënsistemet e menaxhimit të trafikut ajror të automatizimit me financim të siguruar. Përfundimi i çështjeve të ndryshme të operacioneve të trafikut ajror. Krijimi i një zyre për menaxhimin e projekteve me staf shqiptar për të pranuar teknologjitë dhe transferimin e aftësive. Kjo punë u financua drejtpërdrejt nga të ardhurat e ANTA-s.

Faza 3 Amendimi 1 dhe amendimi 2 i rishikuar

Të qenit konform (në përpjesëtim të drejtpërdrejtë) me financimin e siguruar. Sigurimi i produkteve dhe shërbimeve siç specifikohen në listën e punimeve (SOW). Sigurimi i një përmirësimi të sistemit të automatizimit. Modernizimi i komunikimeve, navigimit, mbikëqyrjes dhe nënsistemet e menaxhimit të trafikut ajror të automatizimit. Përfundimi i çështjeve të ndryshme të operacioneve të trafikut ajror. Sigurimi i menaxhimit dhe i këshillimit financiar. Mirëmbajtja e një zyre për menaxhimin e projekteve me staf shqiptar për të pranuar teknologjitë dhe transferimin e aftësive. Kjo punë do të financohet nga të ardhurat e ANTA-s dhe nga një hua tregtare.

Në amendimin 3 të fazës së tretë, qëllimi i punimeve të shitësit do të përfshijë të mëposhtmet:

Sigurimi i një përmirësimi të sistemit të automatizimit *SkyLine* dhe modernizimi i komunikimeve, navigimit, mbikëqyrjes dhe nënsistemet e menaxhimit të trafikut ajror të automatizimit. Përfundimi i çështjeve të ndryshme të operacioneve të trafikut ajror. Sigurimi i ditëpërditshëm i programit mbështetës të menaxhimit për kontratën e NAMP.

Prandaj tashmë, në bazë të premisave të dyanshme dhe kësaj Marrëveshjeje, që këtej e tutje, Palët ranë dakord si më poshtë vijon:

1. Data e hyrjes në fuqi

Kjo kontratë e konsoliduar përfshin masat e përmbajtura në amendimin 3 të kontratës dhe do të hyjë në fuqi sapo të përmbushen dy prej ngjarjeve të mëposhtme:

- Marrja e autorizimit për të proceduar e firmosur nga përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit,

- Kontrata e nënshkruar nga palët pas aprovimit nga Këshilli i Ministrave.

2. Qëllimi i kontratës

Kjo kontratë është për mallrat dhe shërbimet e navigacionit ajror, ashtu siç do të shpjegohet edhe më tej.

3. Përkufizimet

“ARO (pas marrjes dijeni)” do të thotë ajo periudhë kohe, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi e kësaj kontrate, dita që pason menjëherë pas datës së hyrjes në fuqi duke qenë dita 1 ARO.

“Përfaqësuesit e autorizuar” do të thotë ato persona me emër dhe me titull, të cilët kanë autoritetin që të lidhin secilën nga palët, dhe duhet të përfshijnë përfaqësuesit e duhur të autorizuar, ashtu siç është specifikuar në këtë kontratë, dhe individë të tjerë të specifikuar në njoftimet e dërguara ndaj Palëve në vijim të nenit mbi njoftimet që këtej e tutje.

“Pronësia e pajisur e Blerësit, personeli dhe mbështetja” do të thotë avioni, pajisja e mbështetjes së tokës, pjesët rezervë, dokumentacioni, personeli dhe mbështetja që dërgohet nga Shitësi të Blerësi në përputhshmëri me afatin e programit për pajisjen e pronës së Blerësit, personelin, dhe mbështetjen në përputhje me përcaktimet e punës.

“Kalendari” do të thotë kalendari gregorian, në qoftë se nuk është specifikuar ndryshe.

“Kërkesa për ndryshim” do të thotë kërkesa për ndryshim e filluar nga Blerësi të lëshuara në përputhje me dispozitat e nenit 17, ose që lind mbi bazën e rrethanave, kushteve apo ngjarjeve të përkufizuara diku tjetër në kontratë.

“Të dhënat” do të thotë: vizatimet, skicimet, shpikjet dhe informacione të tjera teknike për ta pajisur Shitësin dhe/ose Blerësin në këtë kontratë dhe në deklaratën e punës (ashtu siç do të përkufizohet që këtej e tutje), duke përfshirë shfaqjen dhe shtesat.

“Ditët” do të thotë ditët kalendarike, në qoftë se nuk është specifikuar ndryshe.

“Mjetet e transportueshme” do të thotë ato objekte të identifikuar në nenin 7 dhe, të cilat Shitësi duhet t’ia dërgojë Blerësit në pajtueshmëri me kushtet e kontratës.

“Mospërputhje” do të thotë një defekt në material ose në kushtet e funksionimit të një artikulli, përbërësit, apo pjesë, e cila nuk përputhet me specifikimet e aplikueshme dhe rezultatet e të cilave ose mund të rezultojnë në dështim qoftë artikulli, përbërësi apo pjesë që janë të pashërbyeshme.

“Dollarët ose US\$” do të thotë dollarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat janë të gjindshme lirisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

“Data e ekzekutimit” do të thotë data në të cilën kjo kontratë është firmosur nga Pala e fundit, ashtu siç tregohet në faqen e fundit të firmave të kësaj kontrate.

“Data e hyrjes në fuqi” do të thotë data në të cilën ngjarja e fundit e listuar në datën e hyrjes në fuqi të nenit të kontratës ka ndodhur.

“Përdoruesi i fundit” do të thotë entiteti, i cili autorizon Blerësin që të importojë mjetet e transportueshme të kontratës dhe është i përgjegjshëm për trajtimin e çështjeve teknike mbi bazën e kësaj kontrate. Për qëllime të kësaj kontrate, termat “Blerës” dhe “Përdorues i fundit” duhet të përdoren në mënyrë të shkëmbyeshme.

“Pajisja” do të thotë *hardware* (dhe manualët shoqëruese teknike), e cila i sigurohet Blerësit në bazë të kushteve të kontratës.

“Qeveria e Shqipërisë” do të thotë çdo agjenci apo autoritet të Qeverisë së Shqipërisë, veprimet e së cilës mund të ndikojnë/prekin këtë kontratë.

“Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës” do të thotë çdo agjenci apo autoritet i Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës veprimet e të cilave mund të ndikojnë në këtë kontratë.

“Garantuesi (dhënësi)” do të thotë pronari i licencës *software* dhe i të drejtave të pronësisë intelektuale për produktet e programit të dhëna të marrësi mbi bazën e ligjit 26 të kësaj kontrate.

“Përmirësimi” do të thotë çdo pjesë apo kombinim i pjesëve, ose metodës së përdorimit, mirëmbajtja, modifikimi, përmirësimi, prodhimi dhe/ose përpunimi i këtyre që sapo përmendëm, përdorimi i të cilave ndikon tek të drejtat e të dhënave në pronësi dhe të licencuara nga Shitësi në

çdo apo më shumë nga mënyrat në vijim: 1. zvogëlon kostot e prodhimit; 2. përmirëson performancën; 3. rrit jetëgjatësinë e shërbimit; 4. zgjeron aplikueshmërinë; 5. rrit tregun; 6. përmirëson pamjen.

“Fatura” do të thotë një listë me objektet e shërbimeve dhe/ose me mallrat e transportuara ndaj Blerësit.

“Muajt” do të thonë muajt kalendarikë në qofshin ndryshe të specifikuar.

“Njoftim” ka kuptimin që, ndërmjet Palëve, një njoftim me shkrim i dërguar nga njëra prej Palëve ndaj tjetrës në bazë të nenit të njoftimeve që këtej e tutje.

“Produktet” do të thotë pajisja, produktet e programit, dokumentacioni teknik, shërbimet teknike, trajnimi teknik dhe pjesët rezervë të siguruara mbi bazën e kontratës.

“Produktet e programit” do të thotë *software* që është në pronësi të Shitësit ose palës së tretë dhe i sigurohet Blerësit me kod objekti mbi bazën e kushteve të kontratës. *Software* në pronësi të Shitësit përfshijnë *software* të gjindshëm komercialisht (CAS) dhe *software* të përshtatur të zhvilluar posaçërisht për këtë kontratë.

“Afati/lista i/e programit” do të thotë afati i programit ashtu siç është i bashkëngjitur në shtojcën 4 dhe pjesë që këtej e tutje.

“Marrësi” do të thotë Blerësi dhe përdoruesi i fundit, i cili merr licencën *software* dhe të drejtat e pronësisë intelektuale ndaj produkteve të programit të dhëna nga Shitësi në përputhje me nenin 26.

“Deklarata (lista e punimeve) e punës” do të thotë deklaratat e punës e bashkëngjitur në shtojcën 2 dhe pjesë e kësaj kontrate, e cila duhet të përmbajë vetëm punimet që duhen kryer, materialet, shërbimet, procedurat e aplikueshme dhe afatin e dërgimit për mallrat dhe/apo shërbimet që duhet të sigurohen në bazë të kontratës nga Shitësi ndaj Blerësit në bazë të kontratës.

“Dokumentacioni teknik” do të thotë i gjithë dokumentacioni i projektit që duhet të dërgohet në bazë të kontratës ashtu siç është rënë dakord në nenin 7.

“Trajnimi teknik” do të thotë trajnimi teknik që duhet të bëhet nga Shitësi te Blerësi/përdoruesi i fundit mbi bazën e instalimit, operacioneve dhe mirëmbajtjes së pajisjes dhe për punime të tjera në kontekstin e qëllimit të kontratës, ashtu siç është përkufizuar.

“Palët e paautorizuara” klauzola e referencës 21, paragrafi 6. Palët e autorizuara për të ndryshuar, modifikuar, riparuar, ndërlidhur apo vendosur çështje/elemente janë ato të autorizuara nga DGCA, ANTA ose Lockheed Martin, të cilët kanë kryer kurset e trajnimeve përkatëse dhe kanë dokumentacion me shkrim nga punëdhënësi i tyre që specifikon elementet në të cilat ato autorizohen të punojnë. Puna e autorizuar duhet të jetë e dokumentuar në ditarin e mirëmbajtjes dhe të punimeve. Palët, të cilat nuk plotësojnë kushtin e mësipërm, janë palë të paautorizuara.

“Ditët e punës” do të thonë ditët normalisht të planifikuara të punës në çdo vendndodhje ku puna respektive duhet të kryhet, zakonisht duke përjashtuar pushimet dhe fundjavën.

4. “Radha e precedencës” në ndodhinë e ndonjë mospërputhje apo dykuptimësie ndërmjet dokumenteve që formojnë komponentët e kësaj kontrate, kjo mospërputhje apo dykuptimësi duhet të zgjidhet duke përdorur radhën e mëposhtme të precedencës së dokumenteve:

1. Afatet dhe kushtet e kontratës

2. Numrat e shtojcave 1, 2, 3, 4 dhe 5 të afateve dhe kushteve të kontratës, në radhë numerike.

3. Çdo dokumentacion tjetër.

4. Marrëveshja financiare për fazën 2.

5. Dokumenti i vendimit të studimit të realizueshmërisë/fizibilitetit nga Këshilli i Ministrave. Vendi i performancës (zbatimit)

Kjo kontratë mund të realizohet kudo në botë me mjete të ndryshme të Shitësit dhe me mjete të Blerësit kudo në Shqipëri, ashtu siç mund të specifikohet në shtesat e projektit.

6. Afati i zbatueshmërisë dhe afatet e kontratës

Periodha e zbatueshmërisë për këtë kontratë (gjithashtu, “afati i kontratës”) është nga data e hyrjes në fuqi më 30.12.2002 deri më 5.6.2014, e cila mund të shtyhet me marrëveshje ndërmjet dy palëve. Afati i kontratës përbëhet nga periudha e datës së zbatimit, duke përfshirë ndërtesën 7.0 SAT, për të përfunduar më 15.12.2011, ndjekur nga periudha e garancisë së përgjithshme, e cila

fillon më 16.12.2011 dhe mbyllet më 16.12.2013. Kjo është pritshmëria e radiove të hershme, shpërndarë më 15.6.2010 me periudhën respektive të garancisë që mbyllet më 15.6.2014. Gjithashtu, periudha e kalimit në ndërtesën e re do të jetë nga data 15.12.2011 deri më 15.3.2012. Një plan i detajuar i afatit të zbatueshmërisë, duke përfshirë gurin kilometrik të zbatueshmërisë së ndërmjetme, gurin kilometrik të dërgesës, gurët kilometrikë të pranueshmërisë dhe gurët kilometrikë të garancisë, është i përfshirë në afatin e programit në shtojcën 3 të bashkëngjitur që këtej e tutje:

7. Pjesët e transportueshme dhe çmimet

Objektet e transportueshme duhet të jenë ashtu siç është specifikuar në deklaratën e punës mes Shitësit dhe Blerësit. Vlera fillestare e kësaj kontrate është \$32,977,807 që përbëhet nga \$3,295,000 dollarë amerikanë për fazën 1 dhe \$29,682,807 për fazën 2, së cilës i është shtuar edhe shuma prej 17,451,831 USD për fazën e 3 që rezulton në një shumë totale prej 50,429,638 USD. Amendimi 2 rrit shumën totale me 28,351,505 USD për fazën e tretë duke rezultuar në një shumë prej 78,781,142 USD. Amendimi 2 i rishikuar ndryshon amendimin 2 të nënshkruar më 30.6.2008 dhe ul shumën totale me 21,981,142 në një shumë totale prej 56,800,000 USD. Amendimi 3 rrit shumën totale me 3,051,305 USD për fazën 3, amendimi 3, duke rezultuar në një vlerë/çmim total të kontratës prej 59,851,305 USD.

Të gjitha çmimet përjashtojnë TVSH-në dhe taksa të tjera e detyrime, të cilat do të aplikohen në faturë në vlerën që ekziston në kohën e datës së faturës.

Banka Eksport Import e Shteteve të Bashkuara po siguron sigurim rreziku për të garantuar financimin Paribas BNP. Në të kundërt Banka e Import Eksportit të Shteteve të Bashkuara kërkon që një pjesë e lartë e produkteve dhe shërbimeve të kenë origjinë Shtetet e Bashkuara.

Meqenëse sistemet CNS/ATM duhet të arrijë kriteret e standardeve europiane dhe duhet të ndërperojë me lidhjet europiane, atëherë disa mundësi nuk mund të gjenden në Shtetet e Bashkuara. Blerësi dhe Shitësi si rrjedhojë bien dakord që shitësi mund të shesë produkte dhe shërbime, dhe Blerësi mund të paguajë për produktet dhe shërbimet me fonde, të cilat nuk janë të lidhura me bankën import eksport të Shteteve të Bashkuara, brenda fondeve të limituara nga çmimi total i kontratës.

Në çdo kohë përpara dërgesës së transportit, Shitësi ka të drejtën të bëjë korrigjimet e nevojshme ose ndryshimet në numër të pjesëve, komponentët apo faturat e materialeve, në mënyrë të tillë që forma, përshtatja, funksioni i montimeve të komponentëve të mos dëmtohet. Të gjitha objektet janë të dërguara CIF në vendet e Blerësit.

8. Afati i pagesës

Për pagesën e firmave/nënshkrimit të kontratës Blerësi duhet të dërgojë pagesën në Bankën e Shitësit brenda 30 ditëve pas firmosjes së kontratës, pas marrjes së një (1) kopjeje të kontratës së firmosur dhe tri (3) kopje të faturës tregtare të Shitësit në formë origjinale.

Pagesat pasuese janë në ngarkim të Shitësit sipas afatit të gurit kilometrik ose datave të shpjeguara në planin shkallë-shkallë të pagesave në shtojcën 4.

Blerësi nuk do të bëjë pagesa për punën që nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë së kontratës.

Faza 2 e planit të pagesës do të bihet dakord/caktohet gjatë fazës 1 në pajtueshmëri me marrëveshjen e financimit.

Një nen për dëmtimet e likuiduara të pranuar reciprokisht do të bihet dakord për fazën 2.

Faturat për pagesat duhet të lëshohen nga Shitësi 30 ditë kalendrike përpara datës në të cilën duhet bërë pagesa.

Afatet dhe programi i mëposhtëm i pagesës do të aplikohet në fazën 3 amendimi 3 i kontratës:

1. Të gjitha faturat e Shitësit do t'i dërgohen Blerësit dhe Blerësi do të ketë 30 ditë që të nënshkruajë dhe të aprovojë faturën;

2. Pagesa do të bëhet nëpërmjet një letër-krediti vërtetuese dhe në përputhje me afatet dhe kushtet e përmbajtura brenda klauzolës 9.1 dhe të lëshuar në formatin e shtojcës 5 të kontratës.

3. Faturat, të cilat nuk janë firmosur dhe aprovuar nga Shitësi brenda 30 ditëve që nga data e lëshimit nga shitësi, do të jenë subjekt i interesit, të cilat do të llogariten në vlerën/kursin e 1% për çdo muaj vonesë dhe për të cilat të gjitha detyrimet përkatëse do të paracaktohen në bazë të numrit 10156

të ditëve brenda një muaji të dhënë kalendarik ku faturat përkatëse janë subjekt i vonesës.

4. Shitësit do t'i kërkohej të sigurojë një faturë shembull që përmban fushat e kërkuara të të dhënave, të cilat duhet të plotësohen për të marrë aprovimin dhe pagesën vijuese të faturës nga Blerësi. Për shmangien e dyshimit, Blerësi nuk do të jetë përgjegjës për pagesën e vlerave të interesit, siç specifikohen në klauzolën 8.3 nëse vonesat në pagesa janë rezultat i dështimit të Blerësit për të paraqitur një faturë që nuk është në përputhje me këto kërkesa.

9. Metoda e pagesës/valuta

Pagesat duhet të bëhen me anë të transfertës së fondit në mënyrë elektronike në llogarinë e Shitësit në:

Citibank NA

111 Wall Street

New York, New York 10043, USA

Nr. Llogarisë: 0210-008-9

ABA ose numri routing: 30627381

Të gjitha pagesat e treguara janë në dollarë amerikanë dhe janë subjekt i pagesës neto të të gjitha detyrimeve të operimit bankar ose shkëmbimit të valutës.

10. Letrat vërtetuese të kredisë, faza 1

Brenda dyzet e pesë (45) ditëve prej firmosjes së kontratës nga Blerësi dhe Shitësi, Blerësi duhet të hapë një letër vërtetuese krediti të paanulueshme në favor të Shitësit me anë të një banke, ashtu siç është e bashkëngjitur në shtojcën 7 të kësaj kontrate. Letra e kredisë duhet të përcaktohet me një periudhë vlefshmërie prej dymbëdhjetë (12) muajsh dhe duhet të jetë në shumën ekuivalente me vlerën totale të fazës 1 të kësaj kontrate, më pak se pagesa e firmosjes së kontratës (pagesë në avancë e rënë dakord në shtojcën 3). Nëse financimi komercial për fazën 2 nuk është arritur nga Blerësi nga dita e 30 përpara datës së skadencës së letrës së kredisë, Blerësi duhet të shtyjë vlefshmërinë e letrës së kredisë, në mënyrë të tillë që ajo të mbetet e hapur dhe e gjindshme për tërheqje deri në dyzet (40) ditë pasi huadhënësi të hapë një maksimum krediti për financimin komercial. Letra e kredisë duhet të konfirmohet nga banka në Shtetet e Bashkuara për Shitësin dhe duhet të jetë lirisht e negociueshme dhe e pagueshme menjëherë në Shtetet e Bashkuara. Ndryshimet bankare të pësuara në Shqipëri, plus detyrimet e konfirmimeve duhet të kryhen nga Blerësi. Detyrimet bankare të pësuara jashtë Shqipërisë, duke përfshirë detyrimet e konfirmimit janë për llogari të Blerësit. Nuk ka pasur letër krediti për fazën e parë. Blerësi i ka paguar të gjitha faturat nga fondet e Blerësit.

Nuk ka pasur letër krediti për fazën e dytë. Blerësi i ka paguar të gjitha faturat siç ishte rënë dakord në ITP 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Letra e kredisë për fazën 3 amendimi 1, u lëshua në datën 19.9.2007.

Letra e kredisë për fazën 3, amendimi i rishikuar 2, do të përcaktohet si pjesë e marrëveshjes së financimit.

10.1. Letrat vërtetuese të kredisë, faza 3 – amendimi 3

Të gjitha pagesat e fazës 3, amendimit 3, do të paguhen nëpërmjet një letre vërtetuese krediti (letra e kredisë) në shumën prej njëmbëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e katërmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë USD (11,074,877), sikurse në formën e dhënë në shtojcën 5 të kësaj kontrate, si dhe kushteve e afateve shtesë vijuese:

- Letra e kredisë do të hapet nga Blerësi në favor të Shitësit nëpërmjet një banke në Shqipëri dhe do të konfirmohet nga banka e caktuar e Shitësit në Shtetet e Bashkuara. Shitësi do të paguhet për produktet dhe shërbimet në përputhje me shtojcën 4, programi historik i pagesës, sapo Shitësi të paraqesë në bankën e tij një faturë origjinale dhe një kopje të nënshkruar enkas nga përfaqësuesit e autorizuar nga Shitësi dhe Blerësi.

- Blerësi do të jetë përgjegjës për të gjitha detyrimet e shkaktuara në lidhje me vendosjen dhe mirëmbajtjen e letrës së kredisë në Shqipëri dhe duke përfshirë të gjitha detyrimet e konfirmimit të Shtetet e Bashkuara. Shitësi do të jetë përgjegjës për të gjitha detyrimet në Shtetet e Bashkuara, duke përfshirë konfirmimin.

- Blerësi do të lëshojë letrën e kredisë dhe shitësi do ta aprovojë letrën e kredisë para datës efektive të amendimit 3 të kontratës. Kjo letër krediti do të mbetet në fuqi deri në 45 ditë pas ngjarjes së fundit në shtojcën 4, programi historik i pagesës.

- Blerësi do ta amendojë letrën e kredisë herë pas here sipas nevojave në vijim të afateve të kësaj kontrate.

11. Kufizimet e fondeve

Palët janë në dijeni (njohin faktin) që Blerësi mund të mos ketë autorizuar financimin e duhur të barabartë me çmimin e kontratës. Shuma e financimit të autorizuar është e përcaktuar në \$3,295,000. Palët parashikojnë që financimi i autorizuar do të jetë i mjaftueshëm për të financuar fazën 1 të kontratës. Palët parashikojnë që fondet shtesë do të sigurohen gjatë financimit komercial dhe burime të tjera të pranuar reciprokisht për të financuar fazën 2, të kontratës dhe lejojnë autorizimin e financimit deri në vlerën e çmimit total të kontratës. Palët miratojnë dhe bien dakord që faza 2, kontrata e realizueshmërisë varet nga marrja e financimeve të mjaftueshme tregtare apo financimeve të tjera të pranueshme nga dy palët.

Palët njohin faktin që fonde shtesë do të sigurohen nëpërmjet financimit tregtar dhe burimeve të tjera për financim, faza 3 e kontratës, dhe për të lejuar autorizimin e financimit deri në çmimin total të kontratës.

Palët njohin faktin që fonde shtesë do të sigurohen nëpërmjet financimit tregtar dhe burime të tjera për financim, amendimi 2 i rishikuar i kontratës, dhe për lejimin e financimit deri në shumën e çmimit total të kontratës.

Shitësi bie dakord të kryejë ose të ketë kryer, të punojë në kontratë deri në pikën që shuma totale e duhur nga Blerësi të arrijë, por të mos kapërcejë nivelin e financimit të autorizuar, duke i dhënë rëndësi të veçantë përfundimit të detyrimeve të fuqishme, të cilat duhet të pranohen nga Blerësi. Kjo vlerë duhet të përfshijë të gjitha kostot, pasiguritë, shumat, përfitimet dhe shpërndarja sipas zërave për të arritur shpenzimet dhe çdo borxh të mëparshëm që Shitësi duhet të pranojë.

12. Taksat dhe detyrimet doganore

Për fazën 1, çdo taksë, detyrim dhe vënie, të cilat janë të ngarkuara nga qeveria kombëtare e Blerësit dhe/ose çdo nënndarje politike prej saj, në fuqi prej datës së hyrjes në fuqi të kontratës duhet të paguhet nga Blerësi. Nëse në vijim bihet dakord që taksat do të paguhet nga Shitësi, një gjë e tillë do të jetë subjekt ndaj një modifikimi të kontratës reciprokisht të pranueshme duke pasur si objekt parësor çdo pagesë. Taksat, detyrimet dhe taksa të tjera të vëna nga çdo qeveri tjetër apo nënndarje e saj politike që krijojnë një detyrim shtesë apo shpenzim të Shitësit, apo të furnizuesve të tij, apo personelit të Shitësit ose furnizuesve të tij, ose mbi pronën e secilit nga të mësipërmët gjatë realizueshmërisë ose pas përfundimit të kësaj kontrate, duhet t'i shtohet çmimit total të kësaj kontrate. Këto shtesa duhet të paguhet menjëherë nga Blerësi me kërkesë me shkrim nga Shitësi.

Nëse Blerësit i kërkohet me ligj që të bëjë ndonjë zbritje apo fshehje/ndalim për ndonjë taksë, detyrim apo tatim tjetër nga të ardhurat e punonjësve, taksa apo ngarkime të tjera nga çdo pagesë e kërkuar mbi bazën e kësaj kontrate, shuma për t'u paguar duhet të rritet, kështu që pasi të jenë bërë të gjitha zbritjet e kërkuara, Shitësi të marrë një shumë të barabartë me shumën që ishte predispozuar për të marrë në datën e kësaj pagese, sikurse të mos ishte bërë zbritje apo ndalim i tillë.

Për fazën 2 të marrëveshjeve mbi taksat do të përkufizohen në pajtueshmëri me marrëveshjen e financimit dhe me amendimin pasues të kontratës.

Taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera në përputhje me amendimin për fazën 3, do të jenë të njëjtat sikurse ato të cituara në klauzolën 12 të kontratës për fazën 1.

Taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera të amendimit 2, të rishikuara mbi produktet dhe shërbimet të siguruara nga shitësi dhe furnitorët e shitësit në çdo nivel do të jenë të njëjtat, sikurse ato të cituara në klauzolën 12 të kontratës për fazën 1 dhe amendimin 1 faza 3.

Taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera të fazës 3, amendimi 3, mbi produktet dhe shërbimet të siguruara nga Shitësi dhe furnitorët e Shitësit në çdo nivel do të jenë të njëjtat, sikurse ato të cituara në klauzolën 12 të kontratës për fazën 1 dhe amendimin 1 faza 3.

13. Inspektimi dhe pranueshmëria

Inspektimi dhe pranueshmëria për transferimin e të gjitha pjesëve të transportueshme do të përkufizohet dhe do të dokumentohet në një plan test. Ky plan test duhet të përgatitet nga Shitësi dhe të aprovohet nga Blerësi, dhe pasi të jetë aprovuar, duhet rënë dakord ndërmjet Palëve. Plani test duhet të përshkruajë procesin e përgjithshëm, çdo test individual, dhe duhet të përfshijë seksione të ndara që çojnë në testet e pranimit. Plani i testit duhet të përcaktojë dhe të përkufizojë kriteret e kalimit/dështimit për çdo test dhe kriteret e përgjithshme të kalimit/dështimit për të dyja testet. Testet duhet të udhëhiqen me demonstrim ose me analizë.

Shitësi mundet sipas zgjedhjes së tij të dëshmojë në ndonjë apo të gjitha testet. Të gjitha shpenzimet e lidhura me aktivitetet e Blerësit duhet të mbulohen nga Blerësi, Shitësi duhet të sigurojë raportet e testit, ashtu siç është e përkufizuar në planin e testit ndaj Blerësit menjëherë pas përfundimit të testeve. Këto raporte të testeve janë dokumente të statusit dhe nuk janë objekte të transportueshme, subjekt pranimi me të drejtën e tyre. Përfundimi i suksesshëm i testeve duhet të dokumentohet nga ekzekutimi i dokumentit protokollues të pranueshem bilateral, i cili duhet të listojë çdo pamjaftueshmëri për të cilën është rënë menjëherë dakord reciprokisht të korrigjohet, dhe me anë të lëshimit të një certifikatë formale bilaterale të pranueshmërisë. Këto dokumente duhet të lëshohen brenda katërmëdhjetë (14) ditëve pas përfundimit të aktivitetit të testit. Data e këtyre dokumenteve duhet të konsiderohet të jetë data e pranueshmërisë për qëllime të mbulimit të garancisë ashtu siç është e përshkruar në nenin 20.

Kostot e ripërsëritjes së testeve të pranueshmërisë si rezultat i dështimit të Shitësit do të jenë në ngarkim të Shitësit.

14. Përdorimi i mjeteve lehtësuese

Blerësi duhet të sigurohet që Shitësi të marrë të gjitha autorizimet dhe lejet e nevojshme, që e lejojnë atë të hyjë në *site* dhe të përdorë pajisjen e klientit, në mënyrë të tillë që të shlyejë totalisht detyrimet sipas kësaj kontrate.

15. Aprovimet e dokumenteve

Dokumentet e transportueshme që kërkojnë pranimin e Blerësit dhe miratim duhet t'i sigurohen përfaqësuesit të përcaktuar të Blerësit për shqyrtim dhe komente. Blerësi duhet të ketë 14 (katërmëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e dërgesës së dokumenteve, për të pajisur Shitësin me çfarëdo komenti me shkrim. Dështimi i sigurimit të komenteve brenda periudhës së kërkuar duhet të jetë me aprovim të Blerësit për dokumentet. Brenda 21 ditëve të marrjes së çfarëdo komenti të Blerësit, Shitësi duhet të bjerë dakord me ndryshimet e Blerësit, të cilat janë për t'u inkorporuar në dokumentin final. Pranimi i dokumentit final duhet të bëhet pas marrjes së dërgesës.

16. Paketimi dhe transportimi

Shitësi duhet të përdorë paketimin tregtar për të gjitha dërgesat, duke i dhënë rëndësinë e duhur ruajtjes dhe kushteve klimaterike në destinacion. Blerësi është përgjegjës për të gjitha formalitetet e lejeve doganore. Shitësi duhet të sigurojë dokumentet e lejeve doganore ndaj Blerësit 7 ditë kalendarike përpara ardhjes së mallrave.

17. Ndryshimet

Blerësi mund të kërkojë ndryshime në qëllimin e punës dhe, nëse pranohen këto ndryshime nga Shitësi, afati i çmimit dhe masa të tjera që i përkasin të kontratës duhet të përshtaten me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve përpara implementimit të ndryshimeve.

Shpenzimet e Shitësit si rrjedhojë: e (a) vonesave të shkaktuara nga Blerësi dhe vonesat (të tjera përveç atyre të shkaktuara nën përgjegjësinë e Shitësit); (b) ndryshimet në ligjet e aplikuar dhe dispozitat pas datës së kuotimit të Shitësit; dhe (c) inspektimet shtesë ose testet e kërkuara nga Blerësi përtej atyre të kërkuara në pajtueshmëri me programin e sigurimit të cilësisë së Shitësit, do të trajtohen si ndryshime të qëllimit të punës dhe kontrata do të përshtatet.

18. Gjuha

Të gjitha komunikimet, njoftimet, mjetet e transportueshme, manualët dhe korrespondenca që kanë të bëjnë me këtë kontratë ose projekti që mund të kalojë ndërmjet Blerësit dhe Shitësit duhet të jenë vetëm në gjuhën angleze.

19. Njoftimet

Çdo njoftim i kërkuar ose i lejuar për t'u siguruar sipas kushteve të kësaj kontrate duhet të jetë me shkrim dhe duhet të jepet me dërgesë nga e njëjta dorë, faks apo adresë e njëjtë dhe e regjistruar.

Në rastin e Blerësit për:

Ernest Noka

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

Sheshi Skënderbej, nr.5, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4222 7140

Fax: +355 4222 7590

E-mail: ernest.noka@mppt.gov.al

Kopje për:

National Air Traffic Agency

Mother Tereza International Airport

Rinas, Albania

Dhe në rastin e Shitësit për:

Michael Konefal

Lockheed Martin IS&GS Civil

9221 Corporate Boulevard

Building 869/Room 4F29

Rockville, MD 20850-3248

USA

E-mail: Michael.j.konefal@lmco.com

Dhe për:

Alberta Allan

Lockheed Martin IS&GS Civil

321 Ballenger Center Drive, Suite 125

Frederick, MD 21703

USA

E-mail: Alberta.allan@lmco.com

Ose në ndonjë adresë tjetër së secilës prej Palëve, nga koha në kohë, duke përshkruar me shkrim ndaj njëra-tjetrës. Palët duhet të njoftojnë për çdo njoftim dërgesë dhe për datën kur është dërguar, nëse është çuar me teleks apo me faks, në datën e transmetimit me faturë njoftimi. E-mail-i është i përshtatshëm për komunikimet formale.

20. Emërtimi/e drejta dhe rreziku i humbjes

Emërtimi në të gjitha pjesët e transportueshme duhet të kalojë ndaj Blerësit pas konfirmimit të Lockheed Martin's Bank ose të ndonjë institucioni tjetër financiar që merr pagesën, si rrjedhojë Shitësi në këtë rast. Blerësi kupton që emërtimi në transportimin e pronësisë intelektuale (*software*, manualet etj.) i aplikohet vetëm medias fizike, dhe që dërgesa të tilla janë të licencuara sipas dispozitave të nenit 26.

Rreziku i humbjes në të gjitha transferimet e elementeve të transportueshme nga Shitësi te Blerësi pas pranimit në platformën ngarkuese të Blerësit.

21. Garancia dhe mbështetja për mirëmbajtje

1. Shitësi duhet të sigurojë mbështetje garancie ashtu siç është përcaktuar në nenin 21 për një periudhë prej 24 muajsh, që fillon nga data e firmosjes së certifikatës së pranueshmërisë së vendit përkatës të punimeve, duke përjashtuar objektet e mëposhtme të dërgueshme të kontratës:

- Radiot e hershme, shpërndarë/dërguar më 15.6.2010 me periudhë respektive garancie që mbaron më 15.6.2014.

2. Brenda një periudhe kohore të arsyeshme, pas marrjes në dijeni të Blerësit, Shitësi duhet të zëvendësojë ose të riparojë me shpenzimet e veta dhe opsione, çdo mjet të transportueshëm, i cili gjatë periudhës së garancisë ka defekte në mjeshtëri, material ose formë, ose i cili në të kundërt nuk

pajtohet në thelb me dispozitat e kësaj kontrate, dhe i cili ka një impakt të pafavorshëm materiali gjatë operacionit të sistemit. Gjithashtu, me marrjen e informacionit nga furnitorët dhe/ose nënkontraktuesit e tij, Shitësi do të njoftojë Blerësin për datën e pritshme të riparimit dhe rikthimit të të gjitha pajisjeve me defekt brenda 2 ditëve punë që nga marrja e informacionit nga furnitori/nënkontraktuesi.

3. Në rastin kur përmbushja e ndonjë detyrimi të Shitësit sipas këtij neni 21 rezulton në ndryshime të dokumentacionit të dërguar, Shitësi duhet me shpenzime të veta, të zëvendësojë apo riparojë të tillë dokumentacion në shumën që është dërguar fillimisht.

4. Nëse Blerësi dështon t'i sigurojë Shitësit akses në sistem, me kërkesë të Shitësit, periudha e garancisë përfundon në mënyrë të menjëhershme.

5. Gjatë periudhës së garancisë, Shitësi duhet të jetë i përgjegjshëm për të gjitha shpenzimet e tij në lidhje me çdo veprim të kryer për të përmbushur detyrimet e tij që këtej e tutje.

6. Asnjëherë Shitësi nuk është përgjegjës për pajisjet apo *software* që janë shkëmbyer, modifikuar apo riparuar nga palë të tjera përveç Shitësit; për defektet ose dështimet që rezultojnë nga mbajtja jo në mënyrën e duhur, ruajtja, veprimet, mirëmbajtja, ndërlidhjet ose instalimi nga palë të tjera nga Shitësi; ose nga defektet që lindin nga konsumi normal apo përdorimi i tepërt.

7. Shitësi duhet të sigurojë Blerësit një planveprimi të mirëmbajtjes me shkrim dhe procedura të përcaktuara, në të cilat Blerësi duhet të mbështetet për mbështetjen e mirëmbajtjes. Periudha e garancisë duhet të përfundojë në mente të menjëhershme nëse Blerësi dështon të ndjekë planveprimin e mirëmbajtjes.

8. Garancitë në këtë nen janë ekskluzive në vend të të gjitha garancive të tjera edhe statutore të shprehura apo të përfshira (duke përfshirë të gjitha garancitë e tregtisë dhe ujdiseve për qëllim të veçantë dhe të gjitha garancitë që lindin nga rruga e trajtimit ose përdorimit të tregut). Kompensimet e siguruar që këtej e tutje janë kompensimet ekskluzive të Blerësit për çdo dështim të Shitësit për t'u pajtuar me detyrimet e tij. Korrigjimi i çdo defekti ose jokonformitet në mënyrën dhe për periudhën e kohës së siguruar më sipër, duhet të përbëjë arritje të plotë të të tilla detyrimeve të Shitësit nëse pretendimet e Blerësit janë të bazuara në kontratë (duke përfshirë neglizhencën ose përgjegjësitë strikte), ose në të kundërt në bazë të ose që burojnë nga puna e siguruar ose e kryer që këtej e tutje.

22. Mirëmbajtja e sistemit

Shitësi bie dakord që të bëjë shërbime të mirëmbajtjes së sistemit me afat të gjatë ndaj Blerësit me anë të një kontrate të veçantë për mirëmbajtjen, e cila hyn në fuqi pasi të ketë mbaruar garancia e dhënë e këtij sistemi që po flasim. Kontrata e mirëmbajtjes do të jetë subjekt ndaj negociatave të afateve dhe kushteve të pranueshme reciprokisht, do të përfshijë çmimin dhe pagesat, dhe do të hyjë në fuqi vetëm nëse të dyja palët e ekzekutojnë. Qëllimi dhe grupi i shërbimeve për t'u siguruar do të jetë së paku duke filluar, në përputhje të përgjithshme me nivelin e mbështetjes së garancisë së siguruar.

23. Detyrimet

Kurdo që t'i kërkohet Blerësit, sipas kushteve të kësaj kontrate ose me anë të veprimit të ligjit, që të japë aprovimin e tij, pëlqimin, lejen apo rënien dakord me çfarëdo çështjeje nuk duhet të jetë i fshehur në mënyrë të paarsyetueshme, por duhet të jepet në një mënyrë e kohë të caktuar, në mënyrë të tillë që të evitohen vonesat dhe në mënyrë të tillë që Shitësi të përmbushë detyrimet e tij ose të projektit në përgjithësi. Në qoftë se Blerësi nuk bie dakord me shkrim, një aprovim i tillë, pëlqim apo lejim ose marrëveshje duhet të mendohet të jetë dhënë pas skadimit të periudhës së 21 ditëve kalendarike nga kërkesa për një gjë të tillë nga Shitësi.

24. Heqja dore

Asnjë vonesë apo shmangie nga çdo Palë në ushtrimin e çfarëdo të drejte, fuqie apo kompensimi mbi bazën e kësaj kontrate do të dëmtojë ose të mund të konsiderohet si heqje dorë e një të drejte të tillë, fuqie apo kompensimi. Çdo heqje dorë nga njëra Palë ndaj detyrimeve kundrejt Palës tjetër në bazë të kontratës duhet të jetë me shkrim dhe e firmosur nga Pala që heq dorë. Çdo ushtrim i vetëm apo parcial i një të drejte të tillë, fuqie apo kompensimi nuk duhet të pengojë ushtrime shtesë të një të drejte të tillë, fuqie apo kompensimi nga secila prej Palëve.

25. Lejet dhe licencat

Të gjitha pajisjet dhe mjetet, të cilat kërkojnë çfarëdolloj licence qeveritare ose që lejojnë për përdorimin e tyre operativ nga Blerësi duhet të kenë marrë licenca të tilla ose leje të tilla përpara fillimit të lejes kërkuese të punës. Është përgjegjësia e Blerësit për të marrë licenca të tilla ose leje në formën e duhur. Nëse mungesa e licencave të tilla ka një impakt të pafavorshëm në performancën e projektit, pastaj ai duhet të konsiderohet si një urdhër ndryshimi ashtu siç tregohet në nenin 17.

26. Mbrojtja e të dhënave

Që mund të jetë e nevojshme që të shkëmbejnë informacione konfidenciale dhe pronësie gjatë përmbushjes së kësaj kontrate. Palët bien dakord që të gjitha këto ndryshime do të zhvillohen në vijim të një marrëveshje të posaçme e të pavarur mbi shkëmbimin e informacionit të pronësisë.

27. Licenca *software/* të drejtat e pronësisë intelektuale

a) Pronësia

Blerësi njih Shitësin si pronari dhe licencuesi i produkteve të programit. Blerësi miraton që produktet e programit kanë të drejtë autori nga Shitësi ose licencues të tjerë dhe janë subjekt ndaj Konventës së Bernës. Blerësi nuk ka asnjë të drejtë ndaj produkteve të programit përveç kur i është dhënë kjo e drejtë në mënyrë specifike nga kjo licencë. Blerësi mund të përdorë këto produkte programi vetëm në Qendrën e Kontrollit të Trafikut Ajror në aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza” (ose në vende të tjera të caktuara nëse është rënë dakord reciprokisht nga të dyja palët) (që këtej e tutje “vendet e projektuara”) për qëllimin e kontrollimit të hapësirës ajrore në hapësirën ajrore të kontrolluar.

b) Përdorimi i autorizuar

Shitësi me anë të kësaj i jep Blerësit një përdorim joeksluziv dhe jo të transferueshëm, me licencë të paguar tërësisht për të përdorur produktet e programit vetëm në vendet e autorizuar. Kjo licencë është për përdorimin e produkteve të programit dhe nuk është një marrëveshje për shitje. Porcionet e lexueshme me makineri të produkteve të programit janë të siguruara vetëm me kod objekti.

Blerësi është i autorizuar nga Shitësi:

1. Për të përdorur porcionet e lexueshme të makinerisë të produkteve të programit në vendet e caktuara;

2. Të ruajë produktet e programit, të transmetojë dhe të shfaqë në makineritë e ndodhura në vendet e caktuara;

3. Të përdorë porcionet jomakineri të lexueshme të produkteve të programit në mbështetje të përdorimit të autorizuar të Blerësit për produktet e programit;

4. Si i autorizuar, të kopjojë dhe të përkthejë porcionet e lexueshme të makinerisë së produkteve të programit në çfarëdo forme me makinë leximi në mbështetje të përdorimit të autorizuar të produkteve të programit.

5. Blerësi mund të bëjë deri në tri kopje të produkteve të programit vetëm me qëllimin e arkivimit ose mbulimit të shkatërrimeve pa miratimin shtesë të Shitësit. Të gjitha kopjet e bëra duhet të riprodhojnë të gjitha pronësitë dhe shënimet shtrënguese dhe ato të të drejtave të autorit, dhe një llogaritje duhet t'i sigurohet Shitësit me kërkesë për të gjitha kopjet. Të gjitha kopjet e bëra do të jenë subjekt ndaj kushteve të kësaj kontrate.

Blerësi ka të drejtën të shpërndajë informacionin e produkteve të programit vetëm brenda dhe ndërmjet vendit të përcaktuar.

Blerësi nuk ka të drejtë t'i japë akses për produktet e programit ndonjë palë tjetër, duke përfshirë, por jo i kufizuar, konsulentët dhe kontraktuesit mbështetës, pa pasur lejen me shkrim nga Shitësi. Një leje e tillë mund t'i jepet vetëm pasi të gjithë individët e përfshirë të kenë ekzekutuar një marrëveshje konfidencialiteti me pëlqimin e Shitësit. As Blerësi dhe as ndonjë palë tjetër e tretë s'kanë të drejtë të kopjojnë produktet e programit të siguruara nga Shitësi në çdo formë, vetëm nëse është autorizuar në mënyrë specifike nga kjo licencë.

c) Kufizimet në përdorim

1. Blerësi nuk ka të drejtë të ndryshojë montimin, ndryshojë inxhinierin, ndryshojë përpilimin ose në asnjë mënyrë nuk ka të drejtë të deshifrojë tërësisht apo pjesërisht logjikën apo koherencën e produkteve të programit.

2. Blerësi nuk është i autorizuar të nënlicencojë produktet e programit ose t'i japë këtë licencë palëve të treta.

3. Blerësi nuk mund të kopjojë porcionet e lexueshme të makinerisë të produkteve të programit.

4. Blerësi nuk mund të kopjojë porcionet e lexueshme të makinerisë të produkteve të programit veç në mos qoftë i autorizuar gjatë në këtë kontratë.

5. Në rastin e një konflikti ndërmjet kushteve të kësaj licence dhe afateve të një licence të marrë nga Shitësi për produktet e programit në pronësi të palëve të treta dhe nënlicencoi Blerësin, licenca e palës së tretë duhet të konsiderohet si dokumenti qeverisës.

6. Blerësi nuk mund të modifikojë produktet e programit apo të krijojë punime derivate nga produktet e programit.

d) Afati i licencës

Licenca e dhënë që këtej e tutje duhet të mbetet në fuqi dhe në efekt, në mënyrë që Shitësi të mos përfundojë këtë kontratë me konfliktin e parë në një çështje të lidhur të kësaj kontrate nga Blerësi. Blerësi duhet që menjëherë pas një konkludimi të tillë t'i kthejë Shitësit të gjitha origjinalet dhe kopjet e produkteve të programit, si të lexueshme nga njerëzit. Ashtu edhe nga makineritë, si të plota ashtu edhe pjesërisht që i janë pajisur dhe të fshijë ose të shkatërrojë të gjitha format e produkteve të programit me çdo mënyrë ruajtjeje.

e) Rritja e produkteve të programit

Çfarëdo produktesh të programit që i sigurohen menjëherë Blerësit nga Shitësi, i cili modifikon, shton apo rrit produktet e programit të siguruara që këtej e tutje duhet të konsiderohen si pjesë e produkteve të programit të marra që këtej e tutje dhe do të jenë subjekt ndaj të gjitha kushteve të kësaj licence.

f) Mbrojtja e produkteve të programit

Blerësi bie dakord që të mbajë konfidenciale produktet e programit. Veçanërisht, Blerësi bie dakord që të mos zbulojë produktet e programit ndaj palëve të treta dhe të ndërmarrë hapa të tillë, ashtu siç normalisht Blerësi duhet për të parandaluar zbulimin nga palët e treta për materialit e tij konfidencial. Blerësi bie dakord për më tepër që të mbajë këto produkte të programit në konfidencë si një domosdoshmëri për t'u pajtuar me rregulloren e Konventës së Bernës.

28. Shkelja

1. Shitësi duhet, me shpenzimet e tij, të mbrojë, ose sipas zgjedhjes së tij, të vendosë të padisë në proces kundrejt Blerësit, duke u bazuar që ndonjë shërbim, produkt programi (duke përfshirë pjesët) ose me qëllime përdorimi, është krijuar shkelje e çfarëdo të drejte të pronësisë intelektuale amerikane e të tjerëve në momentin e shitjes në vendin e blerësit, kështu që:

a) Në rastin e shkeljes së patentës ka një patentë korresponduese amerikane me një patentë të tillë në vendin e Blerësit, në fuqi në atë moment.

b) Kjo deklaratë e shkeljes do të aplikohet në patentën e tillë të Shteteve të Bashkuara ose në të drejtën e autorit dhe do të bëhet një padi për shkelje sipas ligjeve të Shteteve të Bashkuara nëse kjo shkelje është bërë në Shtetet e Bashkuara.

c) Shitësi duhet të ketë qenë i njoftuar nga Blerësi në mënyrën e duhur me shkrim dhe i duhet dhënë autoriteti, informacioni dhe asistencë në mënyrën e duhur në mbrojtjen e këtij procesi.

Shitësi do të paguajë dëmtimet dhe shpenzimet e bëra në çdo proces gjyqësor në mbrojtje të tij.

Shitësi nuk do të jetë i përgjegjshëm për çdo kërkesë padie të tillë të bërë pa miratimin e tij me shkrim. Në rastin kur shërbimi, produkti i programit apo çdo pjesë tjetër aty, si rezultat i një procesi të tillë gjyqësor mbahet sikur përbën shkelje ose përdorimi i kësaj nga Blerësi është i ndaluar, në këtë rast Shitësi, sipas opsionit të tij dhe shpenzimeve të tij: a) do të sigurojë për Blerësin të drejtën për të vazhduar përdorimin e këtij shërbimi në fjalë ose të produkteve të programit; b) do të zëvendësojë menjëherë ato me produkte të programit joshkelëse të rregullave ekuivalente; c) do të modifikojë atë në mënyrë të tillë që të mos jetë në shkelje; ose d) nëse gjithçka tjetër dështon, do të dëmshpërblejë një porcion të çmimit të paguar te Shitësi.

2. Shitësi nuk do të ketë asnjë detyrë apo detyrim ndaj Blerësit në bazë të këtij neni, në kontekstin që shërbimi ose produkti i programit është: (a) i siguar në përputhje me projektin e

Blerësit ose me udhëzimet ku pajtueshmëria, përveç kësaj ka bërë që Shitësi të derivojë nga rruga e tij normale e realizueshmërisë; (b) e modifikuar nga Blerësi ose kontraktuesit e tij pas dërgesës; ose c) e kombinuar nga Blerësi ose kontraktuesit e tij me objektet jo të furnizuara në këtë kontekst dhe për arsye të skicës së dhënë, ndërtimit, modifikimit ose kombinimit, një kërkesë padi është sjellë kundrejt Blerësit. Për më tepër, nëse për arsye të një skice të tillë, udhëzimi, modifikimi apo kombinimi, një kërkesë gjyqësore sillet kundrejt Shitësit, Blerësi duhet të mbrojë Shitësin në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën bazë që Shitësi ka rënë dakord për të mbrojtur Blerësin sipas rregullave të këtij neni.

3. Ky nen është një deklaratë ekskluzive e të gjitha detyrave të palëve në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe për shkeljet direkte apo kontribuese dhe për të gjitha kompensimet e Blerësit në lidhje me ndonjë pretendim, kërkesë padi apo proces gjyqësor që përfshin të drejtat e pronësisë intelektuale.

Pajtueshmëria me këtë nen, ashtu siç është treguar në kontratë, do të përbëjë në thelb realizimin e të gjitha përgjegjësiave të palëve në kontratë në përputhje me të drejtat intelektuale të pronësisë.

29. Kufizimi i detyrimeve

Blerësi bie dakord tërësisht që asnjëherë dhe në asnjë situatë shitësi, firma mëmë, suplementet, anëtarët dhe furnizuesit të jenë të detyruar ose përgjegjës në kontekstin e ndonjë teorie rimëkëmbjeje, edhe nëse është e bazuar në kontratë, në dëm (duke përfshirë neglizhencën dhe përgjegjësinë strikte), me garanci ose në të kundërt për çdo dëmtim indirekt, të veçantë, aksidental ose të rëndësishëm (duke përfshirë, por jo i kufizuar, humbjen e pronësisë ose pajisjes; humbja e përfitimeve ose burimeve të të ardhurave; humbja e përdorimit të pronësisë së Blerësit, bimët, pajisja apo sistemi; kostot e rritura të çfarëdo lloji; apo pretendim i klientëve të Blerësit.

Blerësi bie plotësisht dakord që kompensimet e siguruara që këtej e tutje janë ekskluzive dhe që në asnjë rrethanë totali i detyrimeve të Shitësit, firma mëmë, suplementet, anëtarët dhe furnizuesit të jenë të detyruar ose përgjegjës në kontekstin e ndonjë teorie rimëkëmbjeje, edhe të bazuar në kontratë në dëm (duke përfshirë neglizhencën dhe përgjegjësinë strikte), me garanci ose në të kundërt, të tejkalojë çmimin total të paguar ndaj Shitësit mbi bazën e kësaj kontrate. Ky nen duhet të mbizotërojë mbi çdo masë konfliktuale apo kontradiktore të kësaj kontrate.

29.1. Dëmet e likuiduara që janë për t'u paguar nga Blerësi për vonesa në ndërtimin e kullës dhe ACC Tiranë.

Blerësi do të bie dakord t'i paguajë Shitësit dëmin e likuiduar (LD) për vonesa në përfundimin e ndërtimit të kullës dhe ACC Tiranë, sipas afateve dhe kushteve të mëposhtme:

Blerësi do t'i paguajë shitësit një LD në shumën prej 200,000.00 USD për çdo muaj kalendarik vonesë në arrijtjen e datës së të qenit në dispozicion të ndërtesës më 30.6.2011 për kullën dhe ACC e re Tiranë, siç është caktuar në shtojcën 3 të kontratës.

200,000.00 USD e LD mujore bazohen në kostot e vlerësuara mesatare të mbartura të Shitësit për mirëmbajtjen e sigurt të programit dhe stafit inxhinierik të tij në SHBA dhe Shqipëri, dhe kostot përkatëse të trajtimit të materialit dhe ruajtjes ndërkohë që pritet që kulla dhe ACC e re Tiranë të jetë e disponueshme për kryerjen e plotësimin e qëllimit të punës së shitësit – faza 3 amendimi 3.

200,000.00 USD e LD mujore do të përlllogaritet me bazë mujore mbi numrin e ditëve brenda një muaji të caktuar kalendarik që janë subjekt i vonesave përtej datës së programuar të disponueshmerisë së ndërtesës së kullës dhe ACC Tiranë, siç është caktuar në shtojcën 3 të kontratës.

Autorizimi për të paraqitur një propozim amendimi 4, nëse kërkohet nga Blerësi, do të jepet jo më vonë se data 30.8.2011. Kjo datë bazohet në 60 ditë që nga data e programuar e disponueshmerisë së kullës dhe ACC Tiranë, siç është caktuar në shtojcën 3 të kontratës.

Blerësi nuk do të jetë i detyruar të paguajë LD sapo të arrihet marrëveshja mes palëve mbi afatet dhe çmimin e amendimit 4 të kontratës, i cili do të shpjegojë kostot e lidhura me vonesat në datën e disponueshmërisë së ndërtesës së kullës dhe ACC Tiranë, siç përshkruhet më sipër.

Kërkesat e kësaj klauzole do të mbijetojnë edhe përtej afatit të kontratës.

29.2. Dëmet e likuiduara që janë për t'u paguar nga Shitësi për vonesa në përmbushjen e testit të sistemit të pranimit (SAT) CLIN SU03

Shitësi do të bie dakord t'i paguajë Blerësit dëmin e likuiduar (LD) për vonesa në përmbushjen e testit të sistemit të pranimit (SAT) CLIN SU03, duke qenë subjekt i afateve dhe kushteve të mëposhtme:

Shitësi do t'i paguajë Blerësit një LD në shumën prej 100,000.00 USD për çdo muaj kalendarik vonesë në përmbushjen e programuar të testit të sistemit të pranimit (SAT) CLIN SU03 15.12.2011 për kullën dhe ACC e re Tiranë, siç është caktuar në shtojcën 3 të kontratës.

100,000.00 USD e LD mujore do të përlllogaritet me bazë mujore mbi numrin e ditëve brenda një muaji të caktuar kalendarik që janë subjekt i vonesave përtej datës së programuar të disponueshmërisë të testit të sistemit të pranimit (SAT) CLIN SU03 më 15.12.2011, siç është caktuar në shtojcën 3 të kontratës.

Shitësit nuk do t'i kërkohet të paguajë LD me shumë se 200,00.00 USD gjatë gjithë afatit të kontratës, i cili do të zgjatet nga data efektive e amendimit 3 deri më 15.6.2014.

Shitësit nuk do t'i kërkohet të paguajë LD për vonesa, të cilat vijnë nga dështimi i Blerësit në plotësimin apo adresimin e ndonjë varësie që do të ndikonte aftësinë e Shitësit për të plotësuar detyrimet e tij sipas afateve të kontratës.

Kërkesat e kësaj klauzole do të mbijetojnë edhe përtej afatit të kontratës.

30. Dëmshpërblimi

Blerësi duhet të dëmshpërblejë dhe të mbajë jashtë rrezikut Shitësin nga çdo pretendim apo kërkesë të ndonjë personi apo entiteti ligjor të çfarëdo lloji natyre kundrejt Shitësit, nga kompania mëmë apo suplementet e saj, apo nga çdo oficer, drejtor apo punonjës i të mësipërmes, nëse Shitësi nuk është përgjegjës, në lidhje me çdo vdekje, plagosje, dëmtim apo humbje duke përfshirë interesat, kostot dhe shpenzimet e vuajtura, të cilat mund të lindin ose pretendohet të lindin, si në mënyrë direkte ashtu edhe indirekte, nga përdorimi ose veprimi i pajisjes, produkteve të programit ose çdo materiali tjetër të dërguar mbi bazën e objekteve të transportueshme të kësaj kontrate. Detyrimet e parashtruara në këtë nen mund të aplikohen kur një vdekje e tillë, plagosje, dëmtim apo humbje është e shkaktuar, ose ka kontribuar neglizhenca e Shitësit, firmës së tij mëmë ose suplementeve të tij, nënkontraktuesve, furnizuesve dhe shitësve ose çdo oficer, drejtor apo punonjës i të mësipërmeve. Dispozitat e këtij neni duhet të mbijetojnë përtej afateve të kontratës.

31. Forca madhore

Një vonesë në parandalimin e realizueshmërisë së kontratës nga një forcë madhore jashtë kontrollit të Shitësit/ose Blerësit, ose nënkontraktuesit e tyre, furnizuesit dhe shitësit, dhe jo nga neglizhenca ose gabimi, nuk do të konsiderohet si një dhunim apo prishje e kësaj kontrate.

Shitësi dhe/ose Blerësi nuk do të mbahen të përgjegjshëm për dëmtimet apo humbjet e shkaktuara nga vonesat ose realizueshmëria e ndaluar. Forcat madhore përfshijnë, por nuk janë të kufizuara te: veprat nga Perëndia duke përfshirë: stuhitë, përmytjet, tërmetet dhe tufanet; sulmet, revolucionet, trazirat dhe kryengritjet civile; zjarret, vërshimet e ujit, shpërthimet dhe incidentet nukleare; lufta me ose pa deklaram, invazionet, luftërat dhe grabitjet; embargot, sëmundjet, karantinat dhe nxjerrjet jashtë ligjit të tregtisë; dhe veprimet apo mosveprimet e qeverisë dhe forcat ligjore të dhëna, gjithsesi, Blerësi nuk ka të drejtë të kërkojë një mbrojtje nga forcat madhore në lidhje me veprimet apo mosveprimet e Qeverisë Shqiptare (apo nënndarje të saj), me qëllimin që këto veprime të mund të ndikojnë performancën e Blerësit. Paraprijësi duhet të aplikojë pavarësisht nga ekzistenca e shkaqeve të tilla, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate ose nëse ndodhin pas performancës së Shitësit për detyrimet e tij të vonuara për shkaqe të tjera.

Shitësi dhe/ose Blerësi duhet të pranojnë një kërkesë për shkarkim përgjegjësish si rrjedhojë e forcave madhore brenda 30 ditëve kur ka ndodhur. Lehtësimi do të jepet me anë të përshtatjes së afatit të kontratës, ashtu siç përmbahet në modifikimin e kontratës. Pretendimi do të jetë vetëm për afatin e kontratës.

32. Regjimi kontrollues i eksportit

Kjo kontratë është subjekt ndaj të gjitha ligjeve të aplikueshme mbi eksportin në Shtetet e Bashkuara dhe në rregullore, për të cilat Blerësi bie dakord për përputhet tërësisht meqenëse ato mund të aplikohen në produktet, teknologjitë dhe produktet e programit të transferuara në bazën e kësaj Marrëveshjeje.

Blerësi kupton që Shitësi mund t'i transferojë Blerësit produktet, teknologjinë dhe produktet e programit që janë në vetvete subjekt ndaj kontrollit ligjor mbi eksportin në SHBA dhe të rregulloreve. Teknologjia dhe produktet e programit, dhe produktet direkte të një teknologjie të tillë dhe produktet e programit, të dhëna ndaj Blerësit mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje, nuk mund të shiten në mënyrë direkte apo indirekte, transferohen, transportohen, ndërrohet drejtimi apo në çfarëdo mënyre të disponohen në ndonjë destinacion tjetër ose përdorues i fundit.

Dispozitat e këtij neni duhet të mbijetojnë dhe binden mbi bazën e Blerësit pas përfundimit të kësaj kontrate.

33. Pronësia e pajisur/siguruar e klientit

Blerësi duhet të sigurojë në kohën e duhur të gjitha materialet e lidhjeve elektronike, duke përfshirë dokumentacionin e kontrollit të lidhjeve, për të gjitha sistemet ekzistuese dhe prospektive për të cilat Shitësi mund të ketë nevojë për të bërë lidhje me sistemin. Për më tepër, Blerësi duhet të sigurojë të gjitha pajisjet dhe materialet e, gjithashtu, mbështetjen dhe shërbimet, të cilat duhet nga koha në kohë të bihen dakord ndërmjet Blerësit dhe Shitësit.

34. Varësitë e përmbljes/realizueshmërisë

Blerësi duhet të jetë i përgjegjshëm për të siguruar, në kohën e duhur, të gjithë aksesin e kërkuar nga Blerësi për vendet ekzistuese me të cilat pajisja duhet instaluar. Blerësi duhet të sigurojë në kohën e duhur, të gjithë dritën, fuqinë, ujin, mjedisin dhe shërbime të tjera në vend ashtu si mund të jenë të nevojshme për Shitësin për një instalim sa më efikas. Blerësi duhet të përfundojë siç duhet dhe mënyrën e duhur të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar zbatimin në vazhdim të afateve të realizueshmërisë së projektit, të përfshijë në mënyrë specifike të gjitha veprimet e nevojshme shqyrtimin në kohë dhe kthimin e dokumenteve të paraqitura për shqyrtim, ashtu siç është e specifikuar. Të gjitha shërbimet e mësipërme, pajisjet dhe veprimet për llogari të Blerësit duhet t'i bëhen Shitësit pa pagesë ose kompensime mbi bazën e çmimit të kontratës.

35. Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik i siguruar mbi bazën e kësaj kontrate ka të drejtën e autorit nga Shitësi, ose nga palët e treta, të cilat janë nënkontraktuese, furnizues apo shitës për llogari të Shitësit.

Riprodhimi i dokumentacionit teknik nga Blerësi mund të lejohet vetëm me autorizim paraprak me shkrim nga ana e Shitësit. Porcionet e dokumentacionit teknik mund të jenë subjekt ndaj kufizimeve shtesë ndaj përdorimit si rrjedhojë e pronësisë intelektuale të licencuar të Shitësit apo licencuesve të tjerë.

36. Shërbimet inxhinierike

Blerësi mund të lëshojë, sipas mënyrës së tij dhe në çdo kohë, urdhra për qëllime të shërbimeve inxhinierike ndaj Shitësit, në mënyrë të tillë që të përmblen çështjet teknike që nuk janë të parashikuara ndryshe nga kontrata. Këta urdhra për realizim duhet të përmbajnë një nivel të përcaktuar për qëllimin e ndihmës, të shprehur në orët e punës, një shumë të autorizuar kufiri për shpenzimet e lidhura me të dhe një deklaratë dispozitash. Shitësi do të fillojë realizueshmërinë e kërkesës në mënyrë të menjëhershme, ashtu siç është e aplikueshme pas marrjes në dijeni. Asnjë urdhërkërkesë nuk do të jetë i vlefshëm kur kërkon që Shitësi të përforcojë në kundërshtim me kushtet e kontratës ose nëse është dhunim i SHBA-së apo ligjeve të tjera të aplikuara. Asnjë urdhër kërkesë nuk do të jetë i vlefshëm, i cili kërkon që Shitësi të transferojë ndonjë pasuri të pronësisë intelektuale me anë të shitjes apo me anë të çfarëdo metode tjetër, vetëm me anë të licencës së lëshuar nga Shitësi si një pronar apo agjent i autorizuar ose person i licencuar nga vetë Shitësi. Faturat për shërbimet inxhinierike mund të lëshohen nga Shitësi 30 ditë pas fillimit të punës së kësaj kërkesë, dhe për 30 ditë intervale që këtej e tutje, për qëllime shpenzimesh. Blerësi duhet të paguajë fatura të tilla plotësisht brenda 30 ditëve pas marrjes në dijeni.

37. Transferimi i teknologjisë

Shitësi do të marrë përsipër implementimin e transferimit të teknologjisë, siç është rënë dakord mes palëve.

38. Ngarkimi/funksionet

Kjo kontratë duhet të jetë në përfitim dhe duhet të mbështetet në pasuesit respektivë dhe në ngarkim të Palëve në fjalë, por nuk mund t'i caktohet ndokujt në mënyrë vullnetare si tërësisht, ashtu edhe pjesërisht nga Blerësi pa pasur lejen me shkrim të Shitësit. Shitësi mund të caktojë, rinovojë, transferojë apo të krijojë ose të lejojë çdo ngarkesë, besim, siguri apo interes tjetër në këtë Marrëveshje, apo ndonjë të drejtë ose licencë të dhënë që këtej e tutje në favor të ndonjë organi Lockheed Martin.

39. Përfundimi

Secila palë mundet, subjekt ndaj masave të këtij neni, me anë të njoftimit për mosrealizim ndaj Palës tjetër (që këtej e tutje “person që nuk plotëson zotimet”) të mbyllë kontratën si tërësisht, ashtu edhe pjesërisht nëse “personi që nuk plotëson zotimet): a) Dështon të përmbushë masat e kësaj kontrate ose ndryshe dështon të bëjë progres dhe rrezikon realizueshmërinë e kësaj kontrate në përputhje me afatet dhe kushtet, dhe në secilin rast të këtyre rrethanave nuk përmbush apo nuk bën hapa që të arrijë në mënyrën e duhur të riparojë këto dështime brenda periudhës prej 30 ditësh, pasi ka marrë njoftim nga Pala tjetër, ose një periudhë më të gjatë, ashtu siç mund ta ketë autorizuar Pala tjetër; b) Nëse aplikon ose lejon caktimin e një marrësi, të besuari apo likuiduesi të vetin apo për pronësinë e tij; c) Nuk është në gjendje ose pranon me shkrim paaftësinë e tij për të paguar detyrimet që mund të rrjedhin; d) Bën një funksion të përgjithshëm në përfundim të kreditorëve etj. Konsiderohet falimentim ose njeri i paaftë ose i falimentuar etj.). e) Dokumenton një kërkesë vullnetare në falimentim ose një petition, ose kërkon riorganizim, ose një marrëveshje me kreditorët; ose f) Merr masa që kanë të njëjtin ndikim si këto të mësipërmet.

Nëse cilado Palë përfundon kontratën si rrjedhojë e mosplotësimit të zotimeve, secila palë nuk duhet të këtë pretendime për ndonjë sigurim pagese, ashtu siç parashikohet në këtë nen; dhe do të mbetet e përgjegjshme ndaj palës tjetër për të gjitha humbjet, dëmtimet, shpenzimet dhe kostot me ligj që vijnë si rrjedhojë e mosfunksionimit apo ndodhisë mbi bazën e së cilës një njoftim i tillë është i bazuar.

Pas përfundimit parcial të kësaj kontrate për shkak të një personi që nuk plotëson zotimet e filluara nga Blerësi duhet të vazhdojë realizueshmërinë e kontratës me bazën që ajo nuk ka konkluduar dhe nuk do të ndalojë, pezullojë ose ndalojë çdo aspekt tjetër, ose porcion të realizueshmërisë të rregullimit të kontratës, ose përfundimi i çfarëdo mosmarrëveshje.

Pas përfundimit të kësaj kontrate nga mosrealizuesi të filluar nga Blerësi, Blerësi në shtesë të çfarëdo të drejte mbi bazën e ligjeve të kontratës, mund të kërkojnë që Shitësi të transferojë emërtimin dhe dërgimin ndaj Blerësit, çdo porcion i projektit, i cili është blerë nga Shitësi në mënyrë të drejtpërdrejtë për këtë kontratë dhe, i cili nuk është dërguar dhe pranuar përpara këtij përfundimi.

Pagesat ose kreditë nga Blerësi për çfarëdo porcion të projektit të dërguar dhe të pranuar nga Blerësi, duhet të jetë vlera e të gjitha këtyre e përcaktuar mbi bazën e çmimit të kontratës.

Ligji qeverisës dhe vendi ligjor

Kjo kontratë do të interpretohet në përputhje me ligjet e Anglisë dhe Uellsit, duke përjashtuar masat e saj në lindje me konfliktet e ligjit. Palët bien dakord që Konventa e Kombeve të Bashkuara për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (UNCISG) nuk do të zbatohet në këtë kontratë apo në interpretimet e dispozitave të saj.

41. Vendi i gjykimit

1. Palët duhet të përpiqen të zgjidhin çdo diskutim që lind në bazë apo i lidhur me këtë kontratë ose në lidhje me prishjen e kësaj kontrate brenda 30 ditëve të marrjes së njoftimit nga njëra palë ndaj palës tjetër kur ekziston një diskutim, ose sipas një periudhe tjetër kur ato në mënyrë reciproke bien dakord.

2. Në rastin kur një konflikt është i pazgjidhshëm, siç tregohet në paragrafin 1, konflikti ose problemi duhet të referohet për zgjidhje në një nivel më të lartë menaxhimi sipas organizimeve të palëve. Nëse një nivel i tillë i lartë menaxhimi është i pamundur që të arrihet brenda 30 ditëve të

referimit ose brenda një kohe tjetër, ashtu siç mund të jetë rënë dakord reciprokisht, atëherë konflikti duhet të zgjidhet me anë të gjykatës në përputhje me nenin e gjykimit.

3. Në rastin kur çdo konflikt ndërmjet Palëve që nuk është zgjidhur duke kënaqur Palët ashtu siç është parashtruar më sipër atëherë duhet të referohet si i zgjidhur nga ndërhyrje jodetyruese të administruara nga Dhoma Tregtare Ndërkombëtare në Zvicër dhe e mbajtur në Tiranë, Shqipëri.

4. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve që nuk është zgjidhur duke kënaqur palët ashtu siç është rënë dakord më sipër, duhet të zgjidhet detyrimisht me anë të vendimit të gjykatës së administruar nga Dhoma e Tregtisë në Zvicër mbi bazën e rregullave të vendimeve gjyqësore tregtare dhe procedurave plotësuese për problemet e mëdha dhe komplekse, dhe gjykimi dhe vendimi i dhënë nga gjyqtarët mund të hyjë në çdo gjykatë që ka një juridiksion të tillë.

5. Brenda 15 ditëve pas fillimit të gjykimit, secila Palë duhet të përzgjedhë një person për të vepruar si gjykues dhe këto dy të përzgjedhur duhet të zgjedhin një gjykues të tretë brenda 10 ditëve të caktimit të tyre. Nëse gjykuesit e përzgjedhur nga Palët nuk janë në gjendje të bien dakord për gjykuesin e tretë, pastaj gjykuesi i tretë do të caktohet nga autoriteti përkatës gjykues. Nëse Palët dështojnë të zgjedhin dy gjykuesit brenda kohës së përcaktuar, me pas tre gjykues do të caktohen nga shoqata gjyqësore, ashtu siç tregohet në rregulloren e saj të gjykimit tregtar. Para fillimit të seancës, secili nga gjyqtarët e caktuar do të sigurojë një betim për paanshmëri.

6. Vendimi duhet të jetë me shkrim, duhet të jetë i firmosur nga pjesa më e madhe e gjyqtarëve dhe duhet të përfshijë një deklaratë në lidhje me arsyet dhe dispozitat e këtij konflikti. Gjyqtarët duhet të cilësojnë vendimin e tyre dhe proporcionet përkatëse të çmimeve në dollarë amerikanë për të dyja palët.

7. Brenda 30 ditëve të marrjes në dijeni (të cilat nuk duhet të jenë detyruese nëse po bëhet një apelim), secila Palë mund të njoftojë autoritetin gjyqësor në këtë rast për qëllime apelimi në një gjykatë tjetër, e përbërë në të njëjtën mënyrë si gjykata fillestare. Gjykata e Apelit duhet të përshtatë vendimin e parë siç e gjykon ajo, ta modifikojë vendimin e parë ose ta zëvendësojë atë me vendimin e saj. Gjykata e Apelit nuk duhet të modifikojë apo zëvendësojë vendimin e parë të dhënë përveç gabimeve të pasta të ligjeve ose për gabime faktike bindëse. Vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit duhet të jetë përfundimtar dhe i duhet bindur, dhe gjykimi mund të hyjë në çdo gjykatë që ka juridiksionin.

8. Secila Palë duhet të mbajë përgjegjësitë e veta financiare dhe shpenzimet dhe një ndarje e barabartë e shumave të gjyqtarëve dhe pagesave të administratave për gjykimin e bërë, duke përfshirë edhe apelin kur është e nevojshme.

9. Vendi i gjykimit përfundimtar duhet të jetë Gjenevë në Zvicër, sipas ligjeve të pavarura të Anglisë dhe Uellsit, duke përjashtuar masat e Konventës së Shteteve të Bashkuara për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave. Gjuha e gjykimit duhet të jetë në anglisht.

10. Gjykimi sipas vendimit të dhënë mund të përfshijë dëmtimet e kompensueshme ndaj Palës tjetër, por pa asnjë rrethanë me dëmtime të shumëfishta të veçanta, konsektive, apo ndëshkuese, por jo e kufizuar ndaj humbjes së përfitimeve, autorizimit të bërë apo të paguar.

11. Palët bien dakord dhe pranojnë që ato po veprojnë në kapacitetin tregtar në ekzekutimin dhe implementimin e kësaj kontrate. Një pale apo një nënndarje e saj do të emërtohej për të kërkuar lutje ndaj imunitetit mbretëror ose një imuniteti të ngjashëm në lidhje me pretendimin ose procesin gjyqësor duke pasur parasysh detyrimet e tij në këtë kontrate, një Palë e tillë në mënyrë të pakthyeshme prapa heq dorë nga një imunitet i tillë dhe bie dakord që të mos pranojë një imunitet të tillë në bazë të juridiksionit të çdo gjykate apo procesi gjyqësor që e përfshin atë ose pasuritë që përfshihen, por jo e kufizuar për një ndalim të tillë (si paragjykim apo ndryshe) ose ekzekutimin e vendimit.

12. Ndryshimet në rrethana

Disa kategori ndryshimesh të rrethanave ndikojnë të drejtat dhe detyrimet e Shitësit në bazë të kontratës dhe në bazë të të cilave Shitësi nuk duhet të këtë asnjë rrezik.

Këto kategori janë:

a) ndryshimi i ligjit;

b) ndryshimi në taksimin e lidhur me të;

c) direktiva e autoritetit kontraktues, të cilat ndikojnë te Shitësi dhe/ose Blerësi.

Nëse ndonjë nga këto ndryshime ndodhin në rrethana, ato duhet të konsiderohen si një urdhër ndryshim i lëshuar në bazë të nenit 17.

Shitësi nuk duhet të jetë i detyruar për ndonjë dështim për t'u pajtuar apo vonuar në pajtueshmëri me masat e kësaj kontrate, me qëllimin që një dështim apo vonesë e tillë është një rezultat direkt apo indirekt i cilido nga këto ndryshime në rrethana, pavarësisht nëse këto ndryshime e kanë ndikuar atë, furnizuesit e tij apo cilindo nga punonjësit e tij, oficerët apo agjentët.

43. Kompensimi ekskluziv

Palët mendojnë që të drejtat e tyre respektive, detyrimet dhe përgjegjësitë, ashtu siç është thënë në këtë kontratë, duhet të jenë dobësuar nga të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë ndërmjet tyre që lindin në lidhje me kontratën. Në përputhje me rrethanat, përgjegjësitë e shprehura në këtë kontratë dhe çdo dokument që lidhet me to duhet të jenë përgjegjësitë e vetme dhe ekskluzive të Palëve për përgjegjësitë ndaj njëri-tjetrit që burojnë nga kjo ose në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë përfaqësimin, garancinë ose sipërmarrjen e dhënë në lidhje me të, pavarësisht nga ndonjë përgjegjësi e gjindshme ndryshe në ligj ose në drejtësi. Ky nen nuk duhet të kufizojë përgjegjësitë në lidhje me mashtrimet.

44. Kushtet e ndryshimeve të vendit të punimeve

Shitësi vëren që është një detyrim për të drejtuar një kërkim të arsyeshëm të kushteve fizike të vendit dhe vendeve të përcaktuara. Gjithsesi, nëse këto kushte ndryshojnë kryesisht ndërmjet kohës së kërkimit dhe në kohën kur elementet specifike të projektit fillojnë, ai ndryshim mund të interpretohet, me zgjedhje të Shitësit, si një urdhër ndryshim në përputhje me nenin 17.

Për më tepër, nëse kushtet gjenden mjaft të ndryshme nga ato të identifikuar dhe të parashikuara në sitin e kontrollit, të cilat kanë një ndikim të pafavorshëm ose dëmtues në aftësinë e Shitësit për të kryer projektin në përputhje me planet e përcaktuara, Shitësi mundet, me zgjedhje të tij, t'i konsiderojë ato kushte të ndryshme një urdhër ndryshimi në përputhje me nenin 17.

45. Marrëveshja e plotë

Kjo kontratë, duke përfshirë shtojcat e treguara, përbën të kuptuarit total dhe marrëveshjen e Palëve, duke zëvendësuar kështu të gjitha deklaratat e mëparshme me shkrim apo me gojë, të kuptuarit apo marrëveshjet sipas çështjes së subjektit të kësaj kontrate, me përjashtim të një instrumenti me shkrim të datës së menjëhershme të kësaj kontrate kur është ekzekutuar nga përfaqësuesi i autorizuar i Palës. Kokat e paragrafëve në këtë kontekst janë vetëm për efekt leverdie dhe nuk kufizojnë qëllimin e kësaj kontrate. Nëse ndonjë term, masë, marrëveshje apo kusht i kësaj kontrate mendohet i pavlefshëm ose si detyruar për ndonjë arsye, pjesa tjetër e masave duhet të vazhdojë në fuqi të plotë dhe fuqia është e plotë sikur kjo kontratë është ekzekutuar pa porcionin invalid dhe masat që mbeten duhet të interpretohen që t'i japin forcë dhe ndikim qëllimit të Palëve pa dispozitat e eliminuara.

Lockheed Martin Global Inc.

Nga: _____

Titulli: _____

Data: _____

Qeveria e Shqipërisë

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

Nga: _____

Titulli: _____

Data: _____

Lockheed Martin

SHTOJCË 1
PROGRAMI (LISTA) E KËRKESAVE DHE ÇMIMIT
Amendim i rishikuar 3
Versioni 3.0
Nr. reference: ALBGEN02-0025
1 tetor 2010

Ky dokument i jepet Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar për qëllimet e fazës së 3-të, amendimit të 3 për NAMP (programi i modernizimit të hapësirës ajrore). Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të kopjohet, fotokopjohet, riprodhohet, përkthehet apo të kthehet në ndonjë formë elektronike të mesme apo në ndonjë program lexues pa miratimin paraprak me shkrim të Lockheed Martin Corporation. Logot *SkyLine* dhe Lockheed Martin janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të Lockheed Martin Corporation. Këta artikuj të përdorimit të gjerë, teknologji apo *software* janë eksportuar nga Shtetet e Bashkuara në përputhje me rregullat e administratës së eksportit për destinacion final Shqipërinë. Devijimi në kundërshtim të ligjit të SHBA-së është i ndaluar.

SHTOJCA 1
LISTA E KËRKESAVE DHE ÇMIMIT
Amendim 3 i rishikuar

1. Faza 1

Të asistojë Republikën e Shqipërisë për të marrë financime tregtare. Të sigurojë produkte dhe shërbime afatgjata të nevojshme për të bërë të mundur instalimin e një sistemi automatizimi fillestar, në mënyrë që të fitohet një mjedis kontrolli me radar për fazën 2. Të sigurohet një asistencë për operimet në trafikun ajror për të arritur kompetencën e kontrollit me radar brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kontratës duke përdorur mjedisin e tanishëm të kontrollit. Të modifikohet dhe rinovohet ndërtesa ekzistuese ACC/APP për të mbështetur instalimin e sistemit të automatizimit fillestar. Të realizohet një ndryshim i ndërtesës për kullën ACC/APP. Të kryhen detyra të ndryshme të operimeve të trafikut ajror. Pritet që këto punime të financohen direkt nga të ardhurat nga ANTA në përputhje me ligjet e taksave të Shqipërisë.

.....\$ 3,295,000

2. Faza 2

Të sigurojë një sistem fillestar automatizimi që të arrijë të ketë një kapacitet kontrolli radar për trafikun që pritet nga trafiku i Lojërave Olimpikë të verës së vitit 2004 ku përfshihet dhe hapja e një sektori të ri në zonën e tanishme. Të projektohet një ndërtesë kullë ACC/APPT e re. Të kryhen veprimet për përgatitjen e tenderit për komunikacionet, fluturimin dhe survejimin e nënsistemeve e automatizuara të menaxhimit për trafikun ajror. Të kryejë detyra të ndryshme lidhur me operimet e trafikut ajror. Të vendoset një zyrë e menaxhimit të projektit, e cila do të kompletohet me staf shqiptar për të pranuar transferimin e teknologjisë dhe teknikave.

..... \$ 12,152,109

3. Faza 3 amendimi 1

Të sigurohet një automatizim shtesë i sistemeve *hardware* dhe *software*, për të vazhduar me përmirësimin e sigurisë, shërbimit dhe kapacitetit, në mënyrë që të plotësohen standardet ndërkombëtare. Të bëjë parashikime, si një qëllim për t'u arritur, që të funksionojë si një qendër virtuale për hapësirën ajrore unike europiane. Të ndërtojë një ndërtesë të re kullë ACC/APP/. Të modernizojë sistemet e komunikacioneve, qarkullimeve, survejimeve. Të kryejë detyra të ndryshme që lidhen me operimet e trafikut ajror.

.....\$ 34,982,529

4. Faza 3, amendimi 2 i rishikuar

Të sigurohet një automatizim shtesë i sistemeve *hardware* dhe *software*, për të vazhduar me përmirësimin e sigurisë, shërbimit dhe kapacitetit, në mënyrë që të plotësohen standardet ndërkombëtare. Të bëjë parashikime (marrë masa), si një qëllim për t'u arritur, që të funksionojë si

një qendër virtuale për hapësirën ajrore unike europiane. Të ndërtojë një ndërtesë të re kullë ACC/APP/. Të modernizojë sistemet e komunikacioneve, qarkullimeve, survejimeve. Të kryejë detyra të ndryshme që lidhen me operimet e trafikut ajror.

.....\$ 6,370,362

5. Faza 3, amendimi 3

Të sigurohet një automatizim shtesë i sistemeve *hardware* dhe *software*, për të vazhduar me përmirësimin e sigurisë, shërbimit dhe kapacitetit, në mënyrë që të plotësohen standardet ndërkombëtare. Të bëjë parashikime, si një qëllim për t'u arritur, që të funksionojë si një qendër virtuale për hapësirën ajrore unike europiane. Të ndërtojë një ndërtesë të re kullë ACC/APP/. Të modernizojë sistemet e komunikacioneve, qarkullimeve, survejimeve. Të kryejë detyra të ndryshme që lidhen me operimet e trafikut ajror.

.....\$ 3,051,305

CLIN	Përshkrimi	Faza 1	Faza 2	Faza 3 (amendim 1)	Faza 3 (amendim 1) Totali	Faza 3 (amendim 2)	Faza 3 (amendament 2) Totali	Faza 3 (amendament 3)	Faza 3 (amendament 3) Totali	Shënime
	Totali duke përfshirë opsionet	\$ 3,295,000	\$12,152,109	\$ 34,982,529	\$ 50,429,638	\$6,370,362	\$56,800,000	\$3,051,305	\$59,851,305	
F102	Asistim për të fituar financim tregtar	\$ 441,236	\$0	0	\$441,236	\$0	\$444,236	\$ -	\$441,236	
SU03	Sistemi i ri automatizimi ATM	\$ 714,350	\$ 6,168,852	\$ 7,781,904	\$14,665,106	\$7,850,209	\$22,515,315	\$779,606	\$23,294,921	
BL10	Rinovim i ndërtesës ekzistuese	\$ 229,702			\$ 229,702	\$0	\$229,702	\$-	\$229,702	
BL07	Ndërtesë e re DCGA/ANTA	\$331,350	\$916,514	\$10,870,341	\$12,118,205	\$8,696,273	\$3,421,932	\$-	\$3,421,932	5
FI01	Asistencë financiare për DCGA/ANTA	\$ 73,588	\$ 129,000	0	\$ 202,588	\$0	\$202,588	\$-	\$202,588	
OR05	Asistencë e jashtme PMO	\$ 1,078,515	\$ 1,655,079	\$ 2,821,826	\$5,554,858	\$4,430,521	\$9,985,379	\$1,756,953	\$11,742,332	
AT10	Të gjitha detyrat e tjera	\$ 426,259	\$1,644,453	\$545,606	\$3,616,318	\$261,419	\$3,877,737	\$(491,361)	\$3,386,376	
CO03	VCS të reja	\$0	\$75,000	\$ 1,311,200	\$ 1,386,200	\$30,072	\$1,356,128	\$276,005	\$1,632,133	
CO02	Instalim i elementeve të radios në distancë / radio marrës-dhënës	\$	\$154,000	\$2,474,797	\$ 2,628,797	\$216,918	\$2,845,715	\$192,479	\$3,038,194	1
CO05	Miniautomat UHF/VHF	\$0	\$ 18,000	\$435,420	\$453,420	\$115,584	\$569,004	\$192,639	\$761,643	2
CO07	VHF SATCOM	\$0	\$ 0	\$0	\$ 0	\$0	\$0	\$0	\$-	3
NA03	DVOR në rrugëtim	\$ 0	\$ 96,000	\$ 573,144	\$ 669,144	\$0	\$669,144	\$-	\$669,144	
NA04	Mt ILS dhe DVOR aeroport	\$ 0	\$ 60,000	\$ 946,983	\$ 1,006,983	\$232,596	\$1,239,579	\$111,690	\$1,351,269	
SU02	Terminal PSR	\$ 0	\$364,000	\$ 3,542,215	\$ 3, 906, 215	\$0	\$3,906,215	\$-	\$3,906,215	4
OT01	Pajisje të kullës së re	\$ 0	\$ 0	\$555,699	\$ 555,699	\$444,559	\$111,140	\$-	\$111,140	5
OT02	Pajisje MET përmirësimi	\$ 0	\$ 0	277,850	\$ 277,850	\$222,280	\$55,570	\$-	\$55,570	5
OR07	PMO zona shqiptare	\$ 0	\$ 296,000	\$ 1,846,105	\$ 2,142,105	\$1,856,300	\$3,998,405	\$(284,673)	\$3,713,732	6
OR05	Buxhet i pashpërndarë	\$ 0	\$ 575,211	\$ 0	\$ 575,211	\$800,000	\$1,375,211	\$400,000	\$1,775,211	
	Totali i qëllimit të amendimit 3						\$56,800,000	\$2,933,337	\$59,733,337	
CO06		\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$117,967	\$117,967	
CO04		\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$-	\$-	
	Totali i përgjithshëm						\$56,800,000	\$3,051,305	\$59,851,305	

Shënime. Në fazën 3 amendimi 1 CLIN CO02 u ndryshua nga instalim i elementeve të radios në distancë në sigurim Rele radioje në distancë dhe radio ndërmarrës VHF/UHF.

Në fazën 3 amendimi 1 CLIN CO05 u ndryshua nga radio marrës-dhënës VHF/UHF në çelës miniautomat AFTN.

Në fazën 2 ITP6, nga klienti u dha direktiva për ndalim punimi.

Në fazën 2 ITP6, nga klienti u dha direktiva për të ndërruar qëllimin e CLIN SU02 nga Terminal PSR në MSSR rrugëtim (enroute).

Në amendimin 2, Blerësi e udhëzoi Shitësin të ndalojë punimet në BL07, OT01, OT02.

Në fazën 3, amendimin 3, CLIN OR07 u fshi dhe u kombinua në CLIN OR05.

Afatet dhe kushtet e kontratës ALBANIA NAMP

SHTOJCA 2

DEKLARIMI (GJENDJA) I PUNIMIT (SOW)

Amendim i rishikuar 3

Versioni V3.2

Numër reference ALBGE02-0025

1 tetor 2010

Ky dokument i jepet Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar për qëllimet e fazës së 3-të, amendimit të 3 për NAMP (programi i modernizimit të hapësirës ajrore). Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të kopjohet, fotokopjohet, riprodhohet, përkthehet apo të kthehet në ndonjë formë elektronike të mesme apo në ndonjë program lexues pa miratimin paraprak me shkrim të Lockheed Martin Corporation. Logot *SkyLine* dhe Lockheed Martin janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të Lockheed Martin Corporation. Këta artikuj të përdorimit të gjerë, teknologji apo *software* janë eksportuar nga Shtetet e Bashkuara në përputhje me rregullat e administratës së eksportit me destinacion final Shqipërinë. Devijimi në kundërshtim të ligjit të SHBA-së është i ndaluar.

HISTORIA E NDRYSHIMIT TË KONTROLLIT TË DOKUMENTEVE PËR SOW

Rishikim	Data e publikimit	Përmbledhja e ndryshimit
Versioni 0.1	tetor 2002	Drafti fillestar
Versioni 1.0	4 nëntor 2002	Versioni i bazës së linjës
Versioni 2.0	6 nëntor 2002	Versioni i negociuar
Versioni 2.1	16 nëntor 2002	Version i aprovuar LM
Versioni 2.2	13 qershor 2005	Faza 3 versioni i rinovuar i modelit
Versioni 2.3	11 korrik 2005	Ndryshime në paragrafët BL07, CO03, CO02, CO05, NA03, NA04 dhe SU02
Versioni 2.4	20 shtator 2007	Rinovim të të gjithë CLIN për amendimin 2
Versioni 2.5	2 prill 2008	Rinovim nga komentet DGCA dhe ANTA plus redaktim LMGI
Versioni 2.6	26 gusht 2008	Kapje e rinovimeve nga negociimet e amendimit 2, ndalimi i punimeve në BL07, OT01 dhe OT02
Versioni 2.7	8 dhjetor 2008	Heqje e dokumentacionit të vijueshmërisë dhe rinovim për të treguar punën e papaguar është e vetmja përmbajtje që ngelet në amendimin 2 të rishikuar.
Versioni 3.0	21 maj 2010	Rinovim për amendimin 3 për ndryshimet në datë dhe në vonesën e ndërtesës. Heqja e punës përgjatë amendimit 2, duke treguar vetëm çështjet e mbetura për këtë amendim.
Versioni 3.1	10 shtator 2010	Rinovimi për të pasqyruar komentet e ANTA, përfshin listën e detajuar të funksioneve të fuqishme të <i>SkyLine</i> për 7.0, heqje e qëllimit për CLIN-et OT01, OT02, dhe AT11
Versioni 3.2	1 tetor 2010	Rinovime për të pasqyruar qëllimin e amendimit 3 të rishikuar

FJALOR

ACS	Shërbime të kontrollit ajror
APP	Shërbime të kontrollit të nisjes dhe mbërritjes
RMA	Siguria, mirëmbajtja dhe gatishmëria
ATC	Kontrolli i trafikut ajror
ATSA	Autoriteti i Shërbimeve të Trafikut Ajror
CCDS	Sistemi bazë i të dhënave të shenjave të thirrjes
CM	Menaxhim i konfigurimit
CMP	Plani i menaxhimit të konfigurimit
COTS	Komerciali i daljeve
CWP	Pozicioni i vendstacionit kontrollues
DP	Përpunuesi i informacionit të nxjerrë
FAT	Testim i pranimi të linjës
HMI	Ndërfaqe makinerie njerëzore
IDS	Sistemi i nxjerrjes së të dhënave të pranimi
IFAT	Testim i pranimi të linjës së brendshme
IP	Plani i instalimit
IPR	Të drejtat e pronësisë intelektuale
LMTSS	Zgjidhjet e sigurisë dhe transportit Lockheed Martin
LMATM	Menaxhimi i trafikut ajror të Lockheed Martin
LM IS&GS	Sistemet e informimit dhe shërbimet globale të Lockheed Martin
LRU	Njësi e rivendosjes së linjës
MAC	Muajt pas kontratës
MPW&T	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MTBF	Koha mesatare e dështimeve
MTTR	Koha mesatare për t'u riparuar
NAMP	Projekti i modernizimit të hapësirës ajrore kombëtare
ODS	Sistemi i informacionit operacional
PMO	Zyra e menaxhimit të projektit
QA	Sigurimi i cilësisë
QP	Plani i cilësisë
RDPDS	Përpunimi i të dhënave të radarit dhe sistemi i nxjerrjes së të dhënave
RP	Procesor radari
RSS	Simulues i vendndodhjes së radarit
RTQC	Kontroll i cilësisë në kohë reale
SAT	Testim i pranimi në vendndodhje
SDF	Element zhvillimi në vendndodhje
SQP	Plani i cilësisë <i>software</i>
SWP	Mbështetje e pozicionit të punës
TDA	Tregu i Shteteve të Bashkuara dhe Agjencia e Zhvillimit
TDS	Sistemi i zhvillimit dhe testimit
TIM	Takim i shkëmbimit teknik
TMCS	Monitorim teknik dhe sistem kontrolli
TP	Plan testimi

1. HYRJA

Kjo deklaratë punimesh (SOW) përshkruan qëllimin e punës së kontratës së rënë dakord midis Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) dhe sistemet e informacionit dhe shërbimet globale të Lockheed Martin, Civile (LM IS&GS Civil) (formalisht LMATM dhe LMTSS). Propozimi do të paraqitet përmes Lockheed Martin Global Inc. (LMGI) dhe do të shërbejë si bazë për kontratën midis MPPT dhe LMGI. Brenda kësaj deklarate punimesh LMGI identifikohet si Shitësi dhe Qeveria Shqiptare MPPT-ja identifikohet si Blerësi. Deklarata e punimeve u rishikua përsëri për amendamentin 1 të kontratës në datën 29 qershor 2005 dhe u rishikua përsëri për amendamentin 2 të kontratës në datën 15 gusht 2008. Amendamenti 2 i kontratës u firmos në datën 8 dhjetor 2008. Kjo deklaratë punimesh u krijua për të mbuluar përfundimin e programit në ndërtesën e re dhe ndryshimet e lidhura me qëllimin e programit. Kjo deklaratë punimesh mbulon vetëm detyrat që do të kryhen sipas amendamentit 3. Ju lutemi referojuni versioneve të mëparshme të kësaj deklarate punimesh dhe raporteve mujore të dorëzuara për informacion në lidhje me statusin dhe përmbajtjen e segmenteve të programit.

Dispozitat e deklaratave të mëparshme të punimeve, të cilat datojnë më 29 qershor 2005 dhe 8 dhjetor 2008 janë të përfshira, por jo të bashkuara me këtë deklaratë punimesh. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj deklarate punimesh zbulohet të jetë i jashtëligjshëm ose i pazbatueshëm, të gjitha dispozitat e tjera do të vazhdojnë të jenë në fuqi, sidoqoftë.

1. QËLLIMI

Ky relacion pune (SOW) specifikon punën që do të kryhet, produktet, shërbimet dhe artikujt që duhen siguruar dhe përgjegjësitë e sistemit që i caktohen LMGI-së si kontraktues i parë për NAMP-në si pjesë e amendimit 3.

Shitësi do të jetë përgjegjës për zhvillimin e projektit, dokumentimin, blerjen, prodhimin shpërndarjen, integrimin dhe testimin e produkteve, të dërgesave dhe shërbimeve në përputhje me dispozitat e treguara këtu. Përgjegjësia do të vendoset si pjesë e urdhrave të detyruara individuale. Shitësi do të sigurojë mbështetje me asistencë në vendin e instalimit siç përshkruhet këtu.

Shitësi do të japë asistencën e tij në punët e listuara me poshtë, siç përcaktohet në pajisjet e Blerësit ose me sistemet e poseduara të Blerësit në paragrafin 8 të këtij dokumenti ose në çështje pune të rëna dakord në mënyrë dypalëshe:

0. Të asistojë me detyrat e operimeve të trafikut ajror.

1. Të organizojë dhe drejtojë takime ndërshkëmbimi teknik (TIMs).

2. Të drejtojë sigurinë, analizimin e rrezikut dhe mjedisit.

3. Të sigurojë lidhshmëri teknike për të zgjidhur çështje teknike.

4. Të sigurojë mbështetje teknike gjatë integritetit të sistemeve të Shitësit brenda impianteve të Blerësit ose në sistemet e Blerësit.

5. Të organizojë dhe të drejtojë rishikime të programit të menaxhimit.

6. Të organizojë dhe të drejtojë takime shkëmbimi teknik.

2. DOKUMENTET E APLIKUESHME

Dokumentet në vijim janë të aplikueshme për këtë SOW dhe do t'i përkasin Shitësit meqë ato lidhen me punën që do të kryhen.

3.1. Standarde

Blerësi do ta pajisë Shitësin me versionin e aplikueshëm të ICAO dhe përdorimin e standardeve *Eurocontrol*.

3.2. Dokumentet e punës sistematike/institucionale

Përshkrimi i dokumentit

Studimi i fizibilitetit për menaxhimin e trafikut ajror Lockheed Martin, tetor 2001

Masterplani i menaxhimit të trafikut ajror nga *Eurocontrol*, shtator 2000, përditësuar në mars 2002

4. Kërkesat

4.1 Kërkesat

Shitësi do të sigurojë produkte dhe shërbime për modernizimin e shërbimeve të qarkullimit ajror në Shqipëri (ANS) dhe në infrastrukturë, siç përshkruhet në këtë kontratë. Kjo do të përfshijë asistencë me detyrat në menaxhim, inxhinieri, financim, burime njerëzore, organizimin dhe

sigurinë. Shitësi do të sigurojë kërkesat draft për rishikim dypalësh dhe marrëveshje nga Blerësi dhe Shitësi. Shitësi do të drejtojë analizën kosto-efikasitet për të siguruar se një set opsionesh dhe alternativash tërësore dhe të detajuara është konsideruar dhe analizuar për projektim, duke marrë parasysh për të gjitha aspektet e ciklit jetësor të sistemit dhe të gjitha aspektet e kostove të ciklit jetësor të sistemit. Niveli i detajit të çdo analize do të jetë proporcional me performancën, programin, koston, riskun dhe faktorët e oportunitetit.

4.1.1. Funksionimi

Shitësi do të asistojë Blerësin, siç specifikohet në paragrafin 8 të këtij dokumenti, përshkrimet CLIN dhe/ose çështjet për të siguruar një sistem ATM për të përmbushur me siguri kërkesën e kapacitetit zhvillues. Shitësi do të shpërndajë/dërgojë arkitekturën e sistemit, inxhinierinë e sistemit dhe integrimin e sistemit për të arritur një infrastrukturë të modernizuar ANS që është e ndëroperueshme me ICAO dhe standardet e *eurocontrol* të specifikuar në paragrafin 8 të këtij dokumenti.

4.1.2. Konfigurimi

Shitësi do të asistojë me kontrollin e konfigurimit të sistemit për të siguruar integrimin e suksesshëm të sistemit dhe ndëroperueshmërinë.

4.2 Dërgesat

Shitësi do të dërgojë produktet dhe shërbimet që identifikohen brenda kësaj SOW në përputhje me paragrafin 8, plani i dërgesave.

4.2.1 *Hardware/Software/Firmware*

Shitësi do të dërgojë dhe ndihmojë instalimin siç tregohet në planet e projektit për artikujt e dërgesave. Shitësi do të identifikojë COTS dhe NDI (artikujt jozhvillimorë), artikujt kritikë dhe afatgjatë që janë pjesë e linjave bazë të projektimit.

4.2.2 Dokumentimi

Shitësi do të sigurojë dokumentacion në mbështetje të programit të menaxhimit, operacioneve dhe mirëmbajtjes. Shitësi do të sigurojë dokumentacion në mënyrë progresive për të ndjekur zhvillimin e sistemit.

4.2.3 Manualet e operimeve dhe mirëmbajtjes

Shitësit do t'i dërgojnë si vizatime ndërtesë dhe manuale përdorimi, të cilat shpjegojnë instalimin e vendit të punimeve, sesi të kryejmë kontrollin dhe monitorimin rutine, mirëmbajtjen parandaluese dhe çështjet e mirëmbajtjes riaktive lidhur me artikujt e dërgueshëm.

Këtu do të përfshihen manualet COTS plus çdo dokumentacion shtesë i vjen në dërgesë bashkë me produktin. Aty ku mund të aplikohet, dokumentacioni duhet të ketë 2 sete të plota, si vizatime të ndërtimeve dhe manuale teknike (operim, mirëmbajtje, shërbim, pjesë këmbimi dhe diagrame të rrjetit elektrik) për të gjitha pajisjet. Një (1) kopje të gjitha manualeve duhet t'i dërgohet LMTSS Rockville dhe një (1) set Blerësit me dërgesat *hardware* për Blerësin. Nëse është e mundur, dy (2) kopje të thjeshta të gjithë dokumentacionit të sjellë duhet të jetë me CD-ROM. Për formatin duhet rënë dakord reciprokisht ndërmjet LCGI dhe furnizuesit, por *Microsoft Word* është formati i preferuar.

Për ato dërgesa ku është e mundshme, manualet teknike standarde duhet të përmbajnë sa vijon në formatin e furnitorit:

0. Përshkrimi funksional i nivelit të lartë;
1. Të dhëna fizike;
2. Udhëzime për ndërtimin dhe operimin;
3. Udhëzimet e mirëmbajtës në nivel vendndodhjeje dhe përshkrimet LRU;
4. Diagramet e ndërlidhjes;
5. Skema të nivelit të përbërjes për pajisje të veçanta;
6. Guida për operim nga ana e përdoruesit; dhe
7. Formate dhe protokolle për të gjitha lidhjet kompjuterike (nëse kërkohet).

4.2.4 Material trajnimi

Shitësi do të sigurojë material të përshtatshëm trajnimi i shoqëruar me të gjitha kurset e trajnimit dhe do të tregojë në të gjitha propozimet se cili material do të jetë i disponueshëm. Për më tepër, manualet teknike të aplikimit do t'u jepen studentëve gjatë kurseve të trajnimit.

4.2.5. Riprodhimi

Shitësi do t'i akordojë Blerësit të drejtat sipas marrëveshjes për të riprodhuar gjithë dokumentacionin e dërguar që është ekskluzivisht i limituar të përdoret në projektin shqiptar pa ndonjë kosto shtesë.

4.3. Sigurimi i cilësisë

4.3.1. Programi i sigurimit të cilësisë

Shitësi do të operojë dhe mirëmbajë një program për sigurimin e cilësisë në përputhje me ISO9001. Shitësi do të implementojë programin e sigurimit të cilësisë për Blerësin në përputhje me manualin e cilësisë. Shitësi do të sigurojë konformitet me të gjitha dispozitat e kontraktuara dhe do të sigurojë cilësinë e të gjitha produkteve dhe shërbimeve të kërkuara me anë të kontratës për sa kohë të zgjasë koha e sigurimit. Shitësi do të sigurojë një pikë QA kontakti për ndërlidhje me Blerësin.

4.3.2. Inspektimet dhe revizionimi nga LMGI

Shitësi do të kryejë inspektime dhe/ose sipas nevojës do të përcaktojë përshtatshmërinë e një programi QA nga furnizuesi. Shitësi do të implementojë veprimet e kërkuara korrigjuese për të zgjidhur mospërputhshmërinë në kohën e duhur.

4.3.3. Relacion për cilësinë

Shitësi do të mbajë relacione për cilësinë në përputhje me ISO9001 për të gjithë punën e ndërmarrë në sisteme, *hardware* dhe *software* për të treguar arritjen e cilësisë së treguar dhe veprimtarinë efikase të menaxhimit të cilësisë nga Shitësi. Shitësi do të mbajë të gjitha relacionet e cilësisë në përputhje me sistemin e cilësisë së dokumentuar të Shitësit.

4.4 Menaxhimi i konfigurimit

Shitësi do të implementojë një program menaxhimi të konfigurimit (CM) që siguron një kontroll dhe ndjekje zyrtare gjatë programit. Praktikata e menaxhimit të konfigurimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ISO CM (ISO 1007-1995). Praktikata CM të Shitësit do të sigurojnë një zhvillim të kontrolluar, ndjekje të strukturuar të problemit, koordinatat dhe dokumentacionin shoqërues.

Shitësi do të vendosë të mirëmbajë dhe do të raportojë për statusin e të gjithë pajisjes së dërguar dhe mirëmbajtur sipas kësaj SOW. Shitësi do të sigurojë një raport njoftimi për dërgesën për secilën dërgesë dhe veprim mirëmbajtës për pajisjen dhe do të përfshijë si të nevojshëm këtu edhe informacionin që vijon:

0. Numrin e porosisë së blerjes, numrin e transportit të mallit, numrin e artikullit të linjës së kontratës.

1. Numrin e identifikimit të prodhuesit.
2. Tipin e makinerisë/modeli numri.
3. Numri i pjesës.
4. Numri seria.
5. Niveli i inspektimit.
6. Tiparet apo variante shtesë.
7. Instalim, informim me udhëzime, data e instalimit dhe lokalizimi i instaluar.
8. Sistemi i instaluar.
9. Informacion testimi.
10. Aksioni i mirëmbajtjes i kërkuar.

Formati i relacionit për njoftim dërgese sipas formatit të shitësit i mjaftueshme për të dokumentuar dërgesën ose veprimin për mirëmbajtje. Blerësi të vërtetojë marrjen e dokumentit të dërgesës. Ky mund të dërgohet me anë të medias elektrike.

4.5. Plotësimi i tërësisë së informacionit

Plotësimi i tërësisë së informacionit për kërkesat origjinale do të mirëmbahet përgjatë të gjitha fazave të zhvillimit të sistemit. Konfigurimi do të mbështetet nga mjete *software* të dedikuara. Shitësi do të mirëmbajë plotësimin e tërësisë së informacionit nëpërmjet SAT. Blerësi do të mirëmbajë plotësimin e tërësisë së informacionit pas SAT.

Shitësi do të prodhojë një matricë të kryqëzuar reference verifikimi (VCRM). VCRM-ja identifikon të gjitha kërkesat e sistemit (Shalls) dhe metoda e verifikimit (demostrim, inspektim, analizim, testim), së bashku me referencat e procedurës për të identifikuar plotësimin e tërësisë së informacionit të testimit.

Matricat e kërkesave të detajuara janë përfshirë në planet individuale të testimit dhe procedurat e testimit.

4.6. Pranimi

4.6.1. Të përgjithshme

Ky seksion identifikon kërkesat e verifikimit që janë të nevojshme për të marrë aprovimin e nënsistemeve. Filozofia e verifikimit, procesi, përgjegjësitë dhe procedurat do të përshkruhen në planin e testimit nga Shitësi. Verifikimi i të gjitha kërkesave do të verifikohet sapo të jetë e mundur në procesin e sigurimit. Ndërlidhjet e nënsistemeve do të verifikohen si pjesë e gjithë verifikimit. Nivelet dhe metodat e verifikimit për çdo dispozitë do të përcaktohen në planin e testimit. Nivelet dhe metodat e identifikuar do të konsiderohen si minimale.

4.6.2 Plani i testimit

Shitësi do të sigurojë një plan testimi për nënsistemet më të mëdha dhe ta paraqesë brenda 90 ditëve pas lëshimit të kontratës. Meqë do të porositen nënsisteme më të mëdha, do të dërgohen dhe instalohen brenda disa viteve të parashikuara në kontratë për planin e testimit do të jetë zhvillues dhe përfshin në vetvete plan-testimin për dërgime të mëvonshme nënsistemesh sipas versioneve më të fundit për planin e testeve. Plani i testimit do të përfshijë minimalisht sa vijon:

0. Axhendën e aktiviteteve; test miratimi nga fabrika (FAT), integrim sistemi dhe testim dhe testim pranimi në vendndodhje (SAT);

1. Identifikim të niveleve të testimit dhe metodat për nënsisteme kryesore;

2. Nivelet e verifikimit janë përcaktuar për të përfshirë pajisjet (FAT), integrimi (testim pajisje dhe integrimi) dhe në vendndodhje (SAT).

4.6.3 Test i pranimit që në fabrikë

Shitësi do të kërkojë kryerjen e testeve të pranimit që në fabrikë (FAT) në impiantin e fabrikës së furnitorit përpara se të transportohen te nënsistemet. Procedurat e pranueshme të testimit të pranimit që në fabrikë dhe të gjitha dokumentet operacionale/teknike duhet të përgatiten të paktën 30 ditë përpara testeve të parashikuara në axhendë.

4.6.4. Integrimi i sistemeve dhe testimi (SI&T)

Shitësi do të drejtojë integrimin e sistemeve dhe testimin në vendndodhje në përputhje me planin e testimit dhe procedurat e testimit. Kjo do të bëhet në vendndodhjen e kullës së Tiranës ACC/APPT për të qenë në përputhje me axhendën e kontratës.

4.6.5. Procedurat e testimit të aprovimit në vendndodhje

Pas instalimit dhe integrit të çdo nënsistemi kryesor në vendndodhje, Shitësi do të kryejë një test pranimi në vendndodhje (SAT) në përputhje me procedurat e aprovuara për testimin. Procedurat e testimit të pranimit në vendndodhje do të paraqiten të paktën 30 ditë para planifikimit të testimit.

Gjatë SAT, verifikimi do të bëhet në zonën e planifikuar. Pjesa e certifikimit të instalimit dhe kontrollit të nënsistemit do të demonstrojë kërkesat e nënsistemit.

Çdo procedurë SAT do të përmbajë në vetvete informacion e nevojshëm siç vijon:

0. emri i testimit;

1. objektivi i testimit;

2. kërkesat e specifikimit teknik të verifikuar;

3. metoda e verifikimit;

4. marrëdhënia me testimet e tjera;

5. sistem elementi i kërkuar;

6. pajisje për testimin ose mjete të kërkuara (p.sh.: simulatorë, regjistruer date etj.);

7. pajisje të jashtme, impiante ose shërbime me komunikim të jashtëm, nëse ka ndonjë;

8. një diagram që tregon ndërlidhjen e të gjitha elementeve në konfigurimin e testimit;

9. një procedurë hap-pas-hapi për të proceduar gjatë testimit;

10. identifikim i rezultateve që do të regjistrohen; dhe

11. rezultatet që priten në çdo hap.

4.6.6. Testimet e pranimit/aprovimit në vendndodhje (SAT)

Shitësi do të demonstrojë që nënsistemet përmbushin kërkesat themelore të Blerësit, siç është dokumentuar nga Shitësi në listën e përputhshmërisë së kërkesave dhe janë gati të dërgohen në vendin e tyre.

SAT në Kullën Tirana ACC/APPT do të kryhen në përputhje me axhendën e kontratës. Çdo mospërputhje e dalë nga testimi pranimit mbi nënsistemet që do të dërgohen do të jetë përgjegjësi e Shitësit. Shitësi do të sigurojë personel teknik të kualifikuar për të zgjidhur problemin në kohë dhe për të korrigjuar gabimin me anë të kryerjes me sukses të SAT. Testimi i suksesshëm SAT në vendndodhje dhe plotësimi i certifikatës së pranimit dypalësh në përputhje me klauzolën 13 të kontratës do të përbejë pranim formal nga Blerësi.

4.6.7 Relacioni i testimit të pranimit në vendndodhje (SAT)

Një relacion për SAT duhet të paraqitet brenda 60 ditëve pas kryerjes së testimit. Relacioni SAT përmbledh rezultatet e të gjitha testeve në tërësi, të bëra nga shitësi dhe i lidh ato me kërkesat që ishin testuar. Relacioni i testimit duhet të paraqitet me një fletë të plotë të dhënash për çdo SAT të kryer.

Ky relacion duhet të përbëhet nga objektivat e testimit, përmbledhje e analizës, përfundimin, rezultatet dhe rekomandimet. Duhet të përfshihen këtu edhe rezultatet për cilësinë dhe sasinë dhe limitet e besueshmërisë duhet të përmbliken dhe të referohen sipas kërkesave për specifikimin e duhur. Të paktën temat në vijim, duhet të përmenden në relacionin e testimit që kanë të bëjnë me eliminimin e sistemit që do të testohet:

0. Funksionimet e impiantit;

1. Performanca e pajisjes;

2. Cilësia;

3. Testimi i rezultateve.

4.6.8. Periudha e vlerësimit paraoperacional

Në vijim të përmbushjes së SAT, Blerësi synon të drejtojë një set testimi operacional dhe aktivitete vlerësimi për të vlerësuar gatishmërinë për integrimin dhe dorëzimin operacional. Blerësi synon të drejtojë aktivitetet e mëposhtme:

1. Performanca operationale e vlerësuar,

2. Optimizimi i sistemit (akordimi),

3. Integrimi operacional – çështje teknike,

4. Integrimi operacional – rasti i sigurisë dhe çështjet rregullatore,

5. Projektimi dhe ndëroperimi i sistemit gjithëpërfshirës.

4.7. Dorëzimi dhe integrimi operacional

Kur Blerësi të ketë kryer me sukses periudhën e vlerësimit të sistemit paraoperacional, Shitësi do të përmbushë integrim dhe dorëzim operacional.

4.8. Trajnimi

Për nënsistemet e dërgueshme Shitësi do të sigurojë mësimet standarde trajnimi për mirëmbajtje dhe operim të ofruara bashkë me nënsistemet COTS. Shitësi do të sigurojë një përshkrim të trajnimit të ofruar ku përfshihet tipi i trajnimit, kohëzgjatja, vendndodhja numri i studentëve për klasë. Blerësi kërkon që trajnimi i aplikueshëm për personelin e mirëmbajtjes dhe të operimit t'i mundësojë Blerësit që të përforcojë në sferat e mëposhtme:

1. Trajnim gjithëpërfshirës në teknologjinë e propozuar;

2. Trajnim përdoruesi në kapacitetet funksionale të sistemit;

3. Trajnim teknik në të gjithë arkitekturën e sistemit, kjo do të lejojë një kuptim të fortë të nivelit të sistemit të operimit dhe lejon supervizimin e sistemit dhe rikonfigurimin;

4. Trajnim i shërbimit të restaurimit në nivel zëvendësimi të modulit;

5. Trajnimi i riparimit të modulit të *hardware*;

6. Përmirësimet dhe mirëmbajtja e adaptimit të sistemit;

7. Trajnimi i adaptimit të sistemit.

Shitësi duhet të paraqesë një plan trajnimi brenda 90 ditëve pas nënshkrimit të kontratës dhe duhet të përfshijë në të përvijimin e çdo kursi trajnimi dhe të tregojë kushtet paraprake për kërkesat e trajnimit. Meqë do të porositen nënsisteme kryesore, do të dërgohen dhe instalohen në disa vite pune sipas kontratës, plani i trajnimit do të jetë zhvillues dhe do të përfshijë trajnim edhe me dërgesat e nënsistemeve të kohëve më të fundit sipas versioneve të fundit të planit të testimit.

4.9 Garancia

Shitësi do të japë 24 muaj garanci për të gjitha produktet e dërguara. Periudha e garancisë do të fillojë pas kryerjes së testimit të pranimit në vendndodhje (SAT). Për produktet *commercial off the shelf (COST)* – kompjuterë *hardware* dhe *software-shitësi* do të ofrojë një garanci standarde 24-mujore e ofruar bashkë me këto produkte nëse është e aplikueshme. Shitësi do të sigurojë një përshkrim të garancisë standarde të produkteve. Shitësi do të specifikojë pranueshmërinë e sigurisë për secilin produkt dhe do të përshkruajë mënyrën e rekomanduar për të arritur një funksionim të vazhdueshëm me anë të një pranueshmërie paraprake të sistemit.

4.10 Aktivizimi dhe planifikimi i përgatitjes së vendndodhjes

4.10.1 Asistenca në instalim

Shitësi do të jetë përgjegjës për të mbështetur instalimin në vendndodhje të nënsistemeve. Shitësi do të sigurojë përmbushjen e kërkesave për instalimin në nënsisteme, ku do të përfshihen, por jo vetëm kaq, hapësira, akses shërbimi, ftohës, energjia, kërkesat për lëvizjet sizmike, menaxhim i kabllave dhe tokëzimit. Shitësi do të sigurojë që këto kërkesa janë të konstatuar në mënyrë korrekte dhe Blerësi do të sigurojë që impianti është krejt i përgatitur për instalim. Kërkesat për impiantin në zonë do të përshkruhen në planin e instalimit të sistemit. Shitësi do që ky plan do të përdoret si “projekt zyrtar i impiantit” për këtë pikë vendndodhjeje. Përgatitja e zonës dhe punimet civile duhet të kryhen nga NATA, që paraqet konformimin se zona është e gatshme për instalim.

4.10.2. Plani i instalimit

Shitësi do të përgatisë dhe do të paraqesë një plan instalimi për nënsistemet e paaplikueshme brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës. Meqë do të porositen vetëm nënsisteme kryesore, për të cilat dërgimi dhe instalim i zgjat disa vjet, plani i testimit do të bëhet herë pas here dhe do të përfshijë të rehat më të fundit të versioneve për testimin e planit. Vizatimet paraprake do të paraqiten si punime/ndryshime që do të kryhen dhe do të vihen në përdorim. Një paraqitje përfundimtare e paketës së plotë të vizatimeve për punimet duhet të bëhet brenda 90 ditëve, pasi është përfunduar testimi i pranimit në vendndodhjen e nënsistemit.

4.11. Ruajtja, paketimi, ambalazhimi dhe shënimi

Të gjithë artikujt elektronikë do të ruhen, paketohen dhe ambalazhohen në përputhje me praktikat më të mira tregtare ashtu siç përshkruhen këtu për të parandaluar dëmtimet mekanike apo teknike dhe për të lehtësuar mbartjen me anë të mjeteve mekanike.

Pajisjet elektronike të montuar brenda kabineteve do të sigurohen me material jastëkësh mbrojtjes për të parandaluar spostimin apo dëmtimin e pajisjes gjatë transportimit me traget. Një material i tillë ambalazhimi do të bëjë të mundur lëvizjen me lehtësi për në zonën e instalimit.

Do të sigurohet, gjithashtu, një fletë udhëzimi në ballë të çdo kabineti ose në brendësi të derës përballë, e cila do të identifikojë materialet e ambalazhimit, të cilat do të hiqen në vendin e instalimit. Mënyra e mbrojtjes së pajisjes në brendësi dhe fleta e udhëzimeve duhet të aprovet nga LMGI përpara dërgimit të montimit të parë për të LMGI.

Elementet elektronike duhet të montohen të sigurta në një kuti druri (e sjellë me artikujt) dhe e mbyllur me mbrojtje me mur të valëzuar me mbështjellje fibre dhe kapak për njësinë e montimit për Fed.Spec.PPP-B-640 ose ndonjë material tjetër ekuivalent më të. Pas montimit të kutisë dhe përpara mbylljes, secili artikull do të mbështillet me material jastëku prej celuloze sipas FEd. Spec. PPP-B-843, ose ekuivalent tregtar, i siguruar me ngjitës/zam rezistent ndaj shtypjes/trysnisë me një trashësi 2 inç. Pastaj mbështjellja prej jastëkësh duhet mbuluar me një tabak 4 mil polietileni, e puthitur me lehtësi dhe e sigurt me një mbyllje ngjitëse/adezive.

Dimensionet e brendshme të mbështjelljes së valëzuar duhet të jetë afërsisht 4 inç më lart se pajisja pas mbylljes së pajisjes mbuloni mbështjelljen me një mbulesë 6 inç përgjatë gjithë përmasës. Mbështjellja dhe izolimi i pajisjes duhet të mbërthehen mirë të paktën me dy shirita prej ¾ inç fije çeliku. Mbrojtëset e buzëve duhet të vendosen nën çdo rrip.

Të shënohet çdo kontejner në panelin e përparmë me një etiketë identifikimi dhe etiketa adrese në përputhje me udhëzimet e detajuara të dhëna nga LMGI. Etiketa ID duhet të jetë me sfond të bardhë e fiksuar në qoshen e majtë të sipërme të panelit të përparme. Etiketa e transportit duhet të sigurohet nga LMGI dhe duhet të fiksohet në qendër sipër mbi panelin e përparmë.

4.12. Mbështetja me logjistike të integruara dhe mirëmbajtje.

4.12.1. Mbështetja për mirëmbajtje

Shitësi do të paraqesë mjetet me çmimin më të leverdishëm në treg, për sa i përket mbështetjes në mirëmbajtjen e sistemit që ofrohet me anë të sigurimit në shërbim. Koncepti i propozuar do të përfshijë shërbime riparimi për nivelin njësi/stend 7 ose një shërbim shkëmbimi. Shitësi do të sigurojë një fuqi punëtore të nivelit të kënaqshëm, e cila kërkohet për mbështetjen e sistemeve në zonën e funksionimit.

Propozimi do të përfshijë detaje të kostos së riparimit dhe rishikime të herëpashershme dhe do të tregojë burimet për të mbështetur shërbimet e asistencës të ofruara si në fabrikë, ashtu edhe në zonën e punës. Shitësi do të rekomandojë nivelin e zonës dhe do të depozitojë pjesë këmbimi të kërkuara për mirëmbajtjen e sistemit përgjatë kohës që është në shërbim.

Shitësi do të detajojë një strategji mbështetëse për produktin e sistemit për kohën në të cilën ai do të jetë efikas.

4.12.2 Koncepti i mirëmbajtjes

Blerësi do të drejtojë nivelin 1 dhe 2 të mirëmbajtjes. Koncepti i mirëmbajtjes për pajisjen/sistemin që të ka të bëjë me këtë projekt përfshin sa vijon:

1. Pajisje dhe sisteme përfshin testimin e pajisjes në vend (BITE);
2. Dëmtime që diktohen dhe izolohen në njësitë e zëvendësueshme të linjës (LRUs);
3. Dëmtime në pajisje dhe sistem do të jenë të korigjueshme në zonë nga zëvendësimi i thjeshtë në dëmin e bërë LRU;
4. Këto dëmtime do të riparohen falas nga Shitësi deri në mbarimin e periudhës së garancisë;
5. Do të sigurohet një kapacitet mirëmbajtjeje depozite efektive kostoje, në mënyrë që të mbështeten problemet dhe dëmtimet e LRU në nivel pjese të së tërës;

6. *Software*.

4.12.3 Mbështetje të tjera

Me anë të testimit të pranimit në fabrikë (FAT), shitësi do të sigurojë mbështetje për aktivitete të tilla, por jo vetëm, si vijon:

1. Diskutime për arkitekturën dhe takime teknike;
2. Personalizimi i kërkesave të përdoruesit;
3. Të programojë takime/rishikime; dhe
4. Integrim sistemi.

Për të gjitha produktet Shitësi do të mbështesë instalimin, personalizimin dhe shërbimet e supervizimit, të cilat mund të përshijnë sa vijon:

1. Instalim i pjesëve kompjuterike, procesorëve, kabllave, paneleve të komandimit etj.; dhe
2. Personalizim për në zonën specifike të punës.

4.12.4 Pajisje të testimit të veçantë

Shitësi do të minimizojë nevojën për pajisje të testimit të veçantë. Kur kjo nuk është e mundur, Shitësi duhet të sigurojë pajisjen e testimit të veçantë të nevojshme për mirëmbajtjen diagnostikuese, e cila nuk mund të bëhet duke përdorur “si zakonisht” me anë të pajisjes së testimit që disponohet në tregun tregtar.

4.12.5. Materialet e instalimit

Shitësi do të sigurojë të gjitha elementet e kërkuara për instalimin e pajisjes. Shitësi do të jetë përgjegjës për furnizimin me përcjellës me rezistencë të plotë për të lidhur të gjitha njësitë e sistemeve me referencat e aeroplanit në tokë, aeroplani do të funksionojë si një pajisje tokësore dhe sigurie.

4.12.6. Mjete pune

Shitësi do të sigurojë çdo mjet punën për të kryer testimin, transmisione dhe/ose simulatore që janë të nevojshme për të verifikuar kërkesat themelore të Blerësit.

4.11. Matrica e përputhshmërisë së kërkesave

Shitësi do të sigurojë një përgjigje të përputhshmërisë së kërkesave të bazuara në formatin e specifikuar më poshtë. Kjo përgjigje do të përdoret për të vlerësuar kapacitetet e nënsistemeve kundër kërkesave të projektit shqiptar.

Kopjet elektronike të dokumenteve të paaplikueshëm në këtë SOW do t'u sigurohen furnitorëve ashtu siç kërkohen. Shitësi do të sigurojë një përgjigje konformiteti me anë të plotësimin të secilit prej dokumenteve të kërkuara. Shitësi mund të zgjedhë që edhe:

1. Të printojë një kopje të plotë të kërkesave dhe t'i nënvizojë më të kuqe dokumentin siç deklarohet më poshtë; ose

2. Të shtojë/fusë përgjigjen në kopjen elektronike duke futur informacionin e përshkruar më poshtë në dokument.

Shitësi mund të zgjedhë edhe mënyrën e sigurimit të informacionit për përputhshmërinë.

Nëse një kapacitet i mundshëm është në përputhje me kërkesat "përputhshmëri të plotë" duhet shënuar në vijën e titullit/emërtimit të kërkesës shoqëruese.

Nëse një kapacitet i çfarëdoshëm i nënsistemit ka njëfarë kufizimi për plotësimin e kërkesës specifike "përputhshmëri e pjesshme" duhet shënuar në një linjë me emërtimin e kërkesës shoqëruese. Ky kufizim specifik duhet përshkruhet me çdo alternativë ose data të përputhshmërisë së plotë të planifikuar. Kufizimi mund të futet në kopjen e elektronike menjëherë pas emërtimit të kërkesës OSE. Nëse kemi shënim me të kuqe në një kopje bruto, atëherë bashkëlidhet një fletë ku jepet numri i referencës së kërkesës dhe kufizimi mund të sigurohet.

Nëse një kapacitet i nënsistemit që është propozuar nuk përmbush kërkesën "s'ka fare përputhshmëri" duhet shënuar në linjën e emërtimit të kërkesës. Nëse kapaciteti i dhënë është në zhvillim ose përfshihet në planin e produktit, duhet të jepen datat e planifikuara për disponueshmërinë/gatishmërinë e funksionimit në mënyrë të njëjtë si të "përputhshmëri e pjesshme", siç u tregua më lart.

4.14. Siguria e produktit dhe sistemit

Shitësi do të përputhet me rregulloret e sigurisë lokale, europiane dhe të SHBA-së gjatë zbatimit të kontratës.

1. Blerësi ka si qëllim të kryejë një analizë rreziku dhe vlerësim rreziku për të identifikuar të gjitha funksionet kritike për sigurinë dhe të lidhura me sigurinë dhe të caktojë një nivel sigurie për secilin nga këto funksione.

2. Për tërë sistemin dhe për çdo funksion kritik për sigurinë dhe të lidhur me sigurinë, Blerësi ka si qëllim të përgatitë një rast sigurie, i cili do të caktojë mjetet me anë të të cilave niveli i sigurisë do të arrihet. Rasti i sigurisë do të përfshijë njerëz, procedura dhe sisteme. Rastet e sigurisë mbulojnë ciklin jetësor komplet të një sistemi të navigacionit ajror, nga përcaktimi fillestar i sistemit, përmes dizenjimit, implementimit, integritit dhe transferimet në operacione, operacionet, mirëmbajtjen dhe përmirësimet për të ardhmen.

3. Shitësi do të ofrojë hollësi të disponueshme të masave të zbutjes së rrezikut dhe një konfigurim i tillë pajisjesh (pajisje duale), teknika tolerante faji dhe burime të dhënash alternativa (të pavarura).

4. Blerësi dhe Shitësi do të kenë përgjegjësi të përbashkët për dizenjimin e sistemit të bazuar në miratim të përbashkët të dokumenteve të dizenjimit të sistemit.

4.15 Prodhimi

4.15.1 Menaxhimi i prodhimit

Shitësi do të jetë përgjegjës për prodhimin.

4.15.2 Planifikimi i prodhimit

Shitësi do të planifikojë prodhimin e sistemeve dhe nënsistemeve. Shitësi do të planifikojë metodat dhe konceptet për përdorimin e materialeve të pajisjeve të Shitësit, mjetet dhe burimet njerëzore.

Shitësi do të planifikojë të gjitha aktivitetet që lidhen me prodhimin sipas fazave kohore që kërkohen për të blerë, fabrikuar, inspektuar dhe dorëzuar mjetet e pranueshme kontraktuale.

4.15.3 Prodhimi i programeve kompjuterike/hardware


Shitësi do të blejë, prodhojë, inspektojë dhe dorëzojë pajisjet e misionit të sistemit siç është përcaktuar këtu.

4.15.4 Raportimi i prodhimit

Shitësi do të paraqesë statusin e planit dhe progresin e prodhimit çdo muaj në raportet mujore të progresit. Ky raportim duhet të identifikojë arritjet, statusin afatgjatë të pajisjes, prodhimin, mbledhjen dhe testimin, por nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm në këto. Shitësi do të identifikojë fushat e problemit aktual dhe potencial dhe planet e veprimeve korrigjuese. Ky raportim duhet, gjithashtu, të përfshijë aktivitete nëkontraktuale të lidhura dhe mbështetëse.

5. PLANI I PROGRAMIT

Plani i programit përfshin fushat me domethënëse për programin e Shqipërisë që Shitësi do të mbështesë. Plani i kontratës do të përditësohet dhe do të paraqitet te PMR-të.



Lidhjet e programit të modernizimit të hapësirës ajrore kombëtare shqiptare janë të paraqitura më sipër.

Shitësi do të pajtohet me pikat e mëposhtme në kryerjen e kësaj kontrate.

1. Të ofrojë menaxhimin e nevojshëm, prodhimin, inxhinierinë, pajisjet, materialin dhe shërbimet për t'u pajtuar plotësisht me kërkesat e kësaj deklarate pune (SOW).

2. Të mbajë nivele të përshtatshme stafi për prodhimin, menaxhimin e konfigurimit, menaxhimin e problemit, kontrollin e cilësisë, integrimin, mbështetjen e instalimit, testimin, mirëmbajtjen, mbështetjen në vendin e punimeve dhe trajnimin.

3. Të planifikojë, administrojë dhe kontrollojë dokumentacionin financiar, teknik dhe mbështetës.

4. Të planifikojë, menaxhojë dhe mbështesë nevojat e tërë programit përmes periudhës së kontratës për kryerjen.

5. Të implementojë procedura për menaxhim efektiv të të dhënave.

Të dhënat e dorëzuara si rezultat i përmbushjes së kërkesave të përshkruara në këtë deklaratë pune (SOW) do të përgatiten, ofrohen dhe përditësohen në përputhje me seksionin 8.2 të këtij dokumenti.

Menaxheri i programit

Shitësi do të caktojë një menaxher programi (PM) për të organizuar, planifikuar, caktuar, implementuar, kontrolluar, analizuar dhe raportuar të gjitha elementet e kontratës. Menaxheri i programit do të ketë burimet dhe autoritetin për të siguruar zbatim efektiv, eficient dhe në kohë të

programit dhe do të jetë pika kyçe brenda organizatës së Shitësit për të gjitha detyrat e kërkuara të programit.

Rishikimet

Rishikimet e mëposhtme do të kryhen gjatë periudhës së performancës. Shitësi do të caktojë rishikime shtesë nëse mendohet e nevojshme nga programi.

6.2.1 Rishikimet e menaxhimit të programit (PMR)

Shitësi do të drejtojë rishikimet e menaxhimit të programit, siç tregohen në planin e kontratës apo më shpesh siç e kërkon aktiviteti. Blerësi dhe Shitësi do të bien dakord në lidhje me vendndodhjen përpara çdo PMR. Menaxheri i programit i Shitësit do të drejtojë PMR-të.

6.2.2 Takimet e shkëmbimit teknik (TIM)

Shitësi do të mbështesë takimet e shkëmbimit teknik (TIM) me Blerësin, furnitorët dhe aksionerët e tjerë sipas kërkesës. Takimet e shkëmbimit teknik mund të drejtohen përmes Telecom-it apo personalisht, rregullisht, sipas kërkesës së programit përgjatë periudhës së performancës. Edhe Blerësi edhe Shitësi mund të kërkojnë takime të shkëmbimit teknik (TIM). Kryeinxhinieri i Shitësit do të ofrojë një plan për takimet e shkëmbimit teknik (TIM) për përfshirje në planin e kontratës, ndërkohë që TIM kërkohe. Kryeinxhinieri i Shitësit (kontrata teknike primare (PTC)) do të drejtojë takimet e shkëmbimit teknik. Qëllimi i takimeve të shkëmbimit teknik do të jetë të përmirësohen së bashku specifikimet dhe të sigurohet që të gjitha çështjet teknike po zgjidhen në kohën e duhur. Ata mund të përfshijnë një sistem të detajuar dhe kërkesa arkitekturore, program sistemi, çështje instalimi, testim, nënalokime të kërkesave të nivelit të sistemit të tërësishëm për performancë, siguri dhe besueshmëri, mirëmbajtje dhe disponueshmeri (RMA) dhe përkufizime përshtatjeje. Përveç takimeve të shkëmbimit teknik të planifikuara më parë, takime *ad hoc* ose takime vendore teknike të planifikuara rregullisht mund të kërkohe nga Blerësi apo Shitësi.

6.2.3 Takimet mujore

Shitësi do të organizojë takime mujore me Blerësin. Këto takime do t'i japin Shitësit dhe Blerësit një mundësi për të diskutuar çdo pyetje apo ndonjë çështje të identifikuar, apo ndonjë ndryshim në program, apo menaxhim konfigurimi. Blerësi dhe Shitësi do të bien dakord së bashku për kohën dhe vendin.

6.3 Raportimi

6.3.1 Raportimi i statusit

Shitësi do të paraqesë raporte mujore progresi me shkrim. Raportet e progresit do t'i paraqiten Blerësit. Qëllimi i raporteve të tilla është që Shitësi të japë një vështrim në progresin e programit, planifikimin dhe qasjen e menaxhimit të tërësishëm. Të gjitha pjesët e veprimit të hapura gjatë muajit do të regjistrohen dhe çohen për zgjidhje. Raportet do të përfshijnë minimalisht të dhënat e mëposhtme:

1. Arritjet e muajit të mëparshëm.
2. Arritjet e planifikuara në një afat të afërt.
3. Deklarata e punës (SOW), plani i kontratës, duke përfshirë mbulimin specifik të fushave problematike dhe ndryshimet e njohura apo të paraprirura midis deklaratës së punës së planifikuar dhe asaj aktuale, plani teknik dhe puna financiare.
4. Kryerja e planit, duke përfshirë identifikimin e transmisioneve kryesore pas mospërputhjeve të planit dhe planet e veprimit për të zgjidhur këto mosmarrëveshje.
5. Pjesët kritike të planit.
6. Përkufizimi dhe implementimi i planeve të rastit apo planeve në lidhje me punën.
7. Rreziqet e programit dhe mundësitë dhe planet për të pakësuar rrezikun dhe për të kapur mundësitë.
8. Statusi i prodhimit, duke përfshirë statusin e planit, identifikimin e aktiviteteve kyçe, statusin e montimeve madhore dhe sasinë e pakët të pjesëve kryesore.
9. Statusin e testit, duke përfshirë statusin e raporteve teknike të programit dhe raporteve të mospërputhjes së pajisjeve duke përfshirë planet e kërkuara.
10. Statusin e mbështetjes së logjistikës së integruar.
11. Probleme me planet korrigjuese të veprimit.
12. Statusi i të gjitha pjesëve, dorëzimeve CDRL, propozimet inxhinierike të ndryshimit.

13. Statusi i cilësisë, veprimet e hapura dhe statusi i pjesëve pas veprimit dhe inspektimet e cilësisë deri tani.

Të gjitha raportet do t'i dorëzohen Blerësit në formatin e Shitësit.

6.3.2 Pjesët e veprimit

Shitësi do të mbajë një listë të pjesëve të veprimit, e cila do të përfshijë pjesët kontraktuale, teknike, të planit dhe ato financiare. Kjo listë do të koordinohet rregullisht me Blerësin dhe do të mbahet e përditësuar. Një kopje e pjesëve të veprimit do të paraqitet me raportet mujore.

Plani i menaxhimit të programit

Shitësi do të paraqesë një plan të menaxhimit të programit, nëse është e nevojshme, nëntëdhjete (90) ditë pas dhënies së kontratës për të përfshirë pjesët e mëposhtme.

1. Një plan për kryerjen e punës me aktivitetin, dorëzimet dhe fushat kryesore.

2. Matjen e përpjekjes së Shitësit.

3. Njerëzit kyç menaxherial dhe teknik, të cilët do të përfshihen në program dhe përgjegjësitë e tyre.

4. Planet e konfigurimit.

5. Planet e testimit.

6. Një përmbledhje sesi do të kryhet puna me qëllim për t'u pajtuar me kërkesat e deklaratës së punimeve.

7. Datat e nevojshme të projektuara për çdo pjesë të furnizuar të Blerësit.

8. Matricën e pajtueshmërisë së kërkesave me këtë deklaratë pune (SOW).

6.4.1 Plani i menaxhimit të rrezikut dhe mundësive

Shitësi do të krijojë dhe implementojë një plan të menaxhimit të rrezikut dhe mundësive, i cili identifikon, vlerëson dhe menaxhon rreziqet dhe mundësitë e programit nga një perspektivë teknike, plani dhe kostoje.

6.5 Modifikimet

Shitësi do të këshillojë Blerësin për ndryshimet për të formuar, përshtatur apo vënë në funksion në dizejnimin e pjesëve, njërive apo nënsistemeve të zhvilluara pasi pajisjet janë furnizuar. Vetëm nëse është rënë dakord ndryshe midis Shitësit dhe Blerësit do të merret me mend që çdo pjesë ndërrimi e furnizuar apo çdo njësi e riparuar nga Blerësi do të jetë për të ndërtuar standardin e pajisjes që është ofruar fillimisht sipas kontratës. Shitësi do të raportojë çdo situatë "fund i ekzistencës" që pritet përgjatë periudhës së performancës.

6.6 Menaxhimi i programit

Shitësi do të vlerësojë dhe ofrojë input për Blerësin në programe të jashtme të sistemit.

Shitësi do të dokumentojë çdo ndryshim programi të propozuar apo përditësime që rezultojnë nga analiza apo vëzhgime. Shitësi do të mbështesë Blerësin në zgjidhjen e çështjeve të programit që mund të dalin.

6.7 Menaxhimi i ndryshimit

Shitësi do të mbajë linjat në bazë të kontratës, nëse Blerësi kërkon apo shkakton që puna të bëhet jashtë qëllimit bazë të linjave të kontratës, Shitësi do të paraqesë një ndryshim propozimi, duke dokumentuar ndryshimin e qëllimit të punës, ndryshimin e planit dhe ndryshimin e çmimit që lidhet me ndryshimin e linjës bazë të kontratës. Blerësi dhe Shitësi do të përgatitin urdhra dhe do të negociojnë qëllimin, planin dhe çmimin para fillimit të punës. Përgatitja e rendit të ndryshimit është qëllim pune shtesë dhe propozimi i rendit të ndryshimit do të përfshijë qëllimin, planin dhe përgatitjen e kostos së propozimit të rendit të ndryshimit.

6.8 Zgjedhja e furnitorëve

Shitësi do të koordinojë zgjedhjen e furnitorit dhe nënkontraktorit me Blerësin. Blerësi dhe Shitësi do të bien dakord së bashku në lidhje me procedurën për përfshirjen e Blerësit në zgjedhjen e furnitorëve. Gjatë zgjedhjes së furnitorëve, Shitësi do të ndjekë procesin e zgjedhjes së burimit. Blerësi do të ketë autoritetin miratues për furnitorët shqiptarë.

7. ADMINISTRIMI

7.1 Komunikimet

7.1.1 Komunikimet midis Blerësit dhe Shitësit

Të gjitha komunikimet formale midis Shitësit dhe Blerësit do të ndodhin midis funksioneve të emërtuara. Shitësi do të emërojë një pikë të vetme formale të kontratës për të gjitha këto komunikime. Administratori i kontratës (CA) apo menaxheri i programit, siç janë deleguar do të jenë pika formale e kontratës me Blerësin për të gjitha çështjet teknike, komerciale apo programuese. Do të jetë përgjegjësia e administratorit të kontratës (CA) apo të deleguarit të tij për të regjistruar atë komunikim, t'ia caktojë atë personit përgjegjës funksionalë dhe ta çojë në përfundim.

Përveç kësaj, ka një nevojë për komunikim informal, në një nivel pune, midis skuadrave të Blerësit dhe të Shitësit. Edhe pse drejtuesit funksionalë do të marrin pjesë në PMR-të dhe TIM, një dialog pune informal i vazhdueshëm inkurajohet në mënyrë aktive.

Korrespondenca

Korrespondenca e Shitësit do të adresohet në adresën e mëposhtme:

Michael Konefal

Administrator i kontratës

Lockheed Martin IS&GD Civil

9221 Corporate Blvd

Rockville, Maryland 20850

USA

Tel: +1 301-640-3426

E-mail: michael.j.konefal@Lmc.com

apo

Alberta Allan

Program Manager

Lockheed Martin IS&GS Civil

321 Ballenger Center Drive, Suite 125

Frederick, MD 21703

USA

Tel: +1 240-205-2665

E-mail: Alberta.allan@lmco.com

Korrespondenca e Blerësit do të adresohet në adresën e mëposhtme:

Ernest Noka

Zëvendësministër, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

Sheshi Skënderbej, nr.5, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4222 7140

Fax: +355 4222 7590

E-mail: ernest.noka@mppt.gov.al

7.2 Informacioni i dërgimit

Dërgimet fizike të Shitësi ndryshe nga korrespondenca do të adresohen te personeli korrespondues në adresat e mëposhtme. Përveç kësaj, emri i programit, numri i kontaktit dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm do të shfaqet në dokumentet e dërgimit. Shitësi do të pajtohet me të gjitha rregulloret e Shteteve të Bashkuara të Kontrollit të eksportit kur i eksporton çdo material Blerësit.

7.2.1 Shitësi

Lockheed Martin Information Systems and Global Services, Civil (IS&GS Civil)

Materials Distribution Center

19000 Woodfield Road

Gaithersburg, Maryland 20879

Telefon: +1 240-388-1009 ose +1 301-519-3880

Telefaks: +1 301-258-0735

Pika e Kontaktit: Lawrence Israel

E-mail: lawrence.israel@lmco.com

7.2.2 Blerësi

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Sheshi Skënderbej, nr.5, Tiranë, Shqipëri
E-mail: ernest.noka@mppt.gov.al

Tel: +355 4222 7140

Fax: +355 4222 7590

7.2.3 Përfituesi final i dërgesave:

Agjencia Kombëtare e Trafikut Ajror (ANTA)

Aeroporti ndërkombëtar "Nënë Tereza"

Rinas, Shqipëri

Telefon: +355 4371 231

Telefaks: +355 4371 231

Pikë kontakti: Të jepet nga Blerësi

E-mail: Të jepet nga Blerësi

7.3 Kontrolli i eksportit

Shitësi do të pajtohet me rregulloret amerikane, vendore dhe ndërkombëtare e kontrollit të eksportit gjatë kryerjes së kontratës. Shitësi do të kryejë koordinim të përshtatshëm me koordinatorin e kontrollit të eksportit civil LM IS&GS gjatë gjithë dërgesave të eksportit dhe do të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për kalimin e doganave në Shtetet e Bashkuara. Shitësi do të paraqesë dokumentacionin e dërgimit për të gjitha dërgesat në Shtetet e Bashkuara dhe, gjithashtu, edhe në vendin e punimeve ACC.

Shitësi, gjithashtu, do të paraqesë një pikë kontakti për të gjitha çështjet e eksportit dhe do të koordinojë të gjitha dërgesat.

Pika e kontaktit e Shitësit për të gjitha çështjet e kontrollit të eksportit është:

Kynyetta Thomas

Zyrë dhe postë zanore: +1 301 640-3107

Faks: +1 301 640 20 54

Adresë e-mail: kynyetta.r.thomas@lmco.com

Adresë postare:

Lockheed Martin IS&GD Civil

9221 Corporate Blvd

Rockville, MD 20850

8. PLANI I DËRGESAVE

Shitësi do të paraqesë artikujt që do të dorëzohen sipas kontratës siç është përmbledhur më poshtë. Vetëm nëse thuhet ndryshe në këtë Deklaratë të Punimeve, artikujt e të dhënave do të përgatiten në formatin e Shitësit.

CLIN të përfshira në versionet e mëposhtme të kësaj deklarate punimesh, por që nuk shfaqen më poshtë duhet të konsiderohen të mbyllura.

8.1. Dërgesa fizike sipas numrit të elementeve të renditjes në kontratë (CLIN)

Këtu në vijim përshkruhen produktet kryesore që dërgohen dhe shërbimet caktimet e një identifikuesi të vetëm alfanumerik (CLIN), me qëllim që të identifikohen në sistemet dhe elementet për planifikimin, menaxhimin dhe vënien e çmimit. Paraqitja e çmimeve në kontratë liston dërgesë thelbësore, sipas numrit të elementit të renditjes në kontratë, përshkrimin dhe çmimin.

8.1.1 CLIN SU03. Dërgim dhe instalim i sistemit të ri automatik të menaxhimit të trafikut ajror

Shitësi do të japë mbështetje garancie për *software* e sistemit automatik të menaxhimit të trafikut ajror për periudhën mes fundit të garancisë së ndërtesës 6.0 dhe zgjatjes për 6 muaj, për të siguruar veprimet e vazhduara të sistemit deri në kalimin e planifikuar në ndërtesën e ACC-së së re.

Shitësi do të projektojë, sigurojë, integrojë, dërgojë, instalojë, testojë dhe dorëzojë Blerësit një sistem automatik të ri për menaxhimin e trafikut ajror, për t'u instaluar në ndërtesën e re ACC/APP dhe do të sigurojë automatizim për të mbështetur mjedisin e radarit CNS/ATM plotësisht të modernizuar. Shitësi do të dorëzojë një specifikim kërkesash të sistemit të përditësuar dhe faturë materiale të rishikuar për sistemin e ri.

8.1.1.1.1.1 CLIN SU03 Plani i ndërtimit për pjesën e mbetur të kontratës

Për çdo ndërtesë Shitësi do të kryejë dizejnim të sistemit, do të përditësojë kërkesat e sistemit, do të implementojë ndryshimin e programit të sistemit dhe me sukses do të përfundojë FAT. Shitësi do të integrojë sistemin me sistemet ATS ndërvepruese dhe me sukses të kryejë SAT. Shitësi do të përditësojë manualin e përdoruesit ATC, manualin e përshtatjes dhe manualin e mirëmbajtjes dhe do të ofrojë trajnim kontrolli në përdorim të funksionalitetit të tyre.

8.1.1.1.2 CLIN SU03. Garancia e zgjatur e pajisjes 6.0

Ky program tregon boshllëkun në garancinë e *software* që nga plotësimi i garancisë së ndërtesës 6.0 deri në instalimin e *software* final të ndërtesës në ndërtesën e re. Garancia shtesë do të sigurohet nga plotësimi i garancisë ekzistuese, qershor 2011, për një periudhë 6-mujore.

8.1.1.2. CLIN SU03. Plani i përfundimit për amendamentin 3

Sistemi i automatizimit *skyline* do të ofrojë një përditësim programesh dhe pajisjesh, kur ndërtesa e re të jetë e disponueshme për të mbështetur ndërrimin te ndërtesa e re e kullës ACC.

8.1.1.1.2.1 CLIN SU03. Përmirësimi i produktit *skyline* dhe mirëmbajtja e pajisjes *build 7.0*

8.1.1.1.2.1.1 Përmbledhje

Kjo ndërtesë/pajisje do të dorëzohet te kulla/ACC e re dhe do të bëjë integrimin e programeve dhe pajisjeve të reja *skyline* me të gjitha sistemet e reja që po ofrohen brenda kësaj kontrate.

Me qëllim për të përfunduar me sukses SAT për SU03, e tërë infrastruktura e re mbështetëse duhet të jetë e disponueshme dhe ka qenë përmes një SAT të suksesshëm për CLIN individual. Plani i instalimit të sistemit do të përfshijë të gjitha varësitë e ndërsjellta dhe ai do të vërë në dukje se cilat CLIN mund t'i nënshtrohen aktivitetit të pavarur SAT dhe, gjithashtu, se cilat CLIN kanë nevojë të testohen paralelisht me SU03. Pjesët ekzistuese tashmë në përdorim përpara lëvizjes te qendra e re nuk do të kërkojnë SAT të mëtejshëm. CLIN që do të merren në konsideratë në planin e instalimit do të jenë:

1. CO02, instalimi i transmetuesit/marrësit të ri radiofonik zanor, duke përfshirë vendin e stafetës së largët UHF/VHF.
2. CO03, instalimin e sistemit të komunikimeve zanore.
3. CO05, instalimin e minindezësit/AMHS të rrjetit telefonik fiks aeronautik.

8.1.1.1.2.1.2 CLIN SU03. Pajisja 7.0 përditësimi i pajisjeve *hardware*

Shitësi do të krijojë një faturë materialesh (BOM) për pajisjen 7.0 për tërë sistemin, duke përfshirë ACC, kabinën e kullës, TDU dhe të gjitha pajisjet shtesë. Shitësi do të porosisë, dërgojë dhe instalojë pajisjet e BOM në ndërtesën e kullës/ACC të re në përputhje me planin e kontratës. Materiali do të porositet nga furnizuesit COTS, i zgjedhur dhe i identifikuar në BOM. Detaje shtesë për hardwarin *skyline* mund të gjenden në dokumentin BOM të dorëzuar sipas amendimit 2.

Sasitë e BOM janë përfshirë për referencë vetëm dhe do të bazohen me dhënien/sigurimin e të mëposhtmeve:

Shumica e komponentëve të sistemit operacional:

1. Pjesa e sipërme ACC – pozicionet taktike dhe planifikuese me 2Kx2K ekran secila.
2. Pjesa e mesme ACC – pozicionet taktike dhe planifikuese me 2Kx2K ekran secila.
3. Rezerva ACC – pozicionet taktike dhe planifikuese me 2Kx2K ekran secila.
4. Drejtimi – 2 pozicione taktike individuale me 2Kx2K ekran secila.
5. Pjesa e sipërme Kosovë – pozicionet taktike dhe planifikuese me 2Kx2K ekran secila.
6. Koordinatori ushtarak ACC - 2 pozicione taktike individuale me 2Kx2K ekran secila.
7. Supervizori ACC – pozicioni i vetëm me një ekran të gjerë 24.
8. Pozicioni FDR – pozicioni i vetëm me një ekran të gjerë 24.
9. Kontrollori i kullës - pozicioni i vetëm me një ekran të gjerë 24.
10. Kontrolluesi i tokës - pozicioni i vetëm me një ekran të gjerë 24.
11. RDP/FDP – 2 servera të ndarë për opsionin 01 dhe opsionin 02.
12. M&C – server i vetëm për opsionin me dy ekrane 24 të gjerë.
13. Kutia e mbështetjes – serveri i vetëm për opsionin 01 me një ekran 24 të gjerë.
14. RCOM – dy servera të ndarë për RCOM1 dhe RCOM2, të aftë të programojnë deri në 8 radarë.

15. DRP- 2 servera regjistrimi me ekran
16. *By pass* - një server për operbp01
17. Regjistruet me ekran – dy servera të veçantë për OPDRF01 dhe OPDRF02.

Shumica e komponentëve të sistemit TDU:

1. Pjesa e sipërme TDU – pozicionet taktike dhe planifikuese me 2Kx2K dhe një ekran të gjerë 24.
2. Pjesa e mesme TDU – Pozicionet taktike dhe planifikuese me 2Kx2K dhe një ekran të gjerë 24.
3. Rezerva TDU – Pozicionet taktike dhe planifikuese me 2Kx2K dhe një ekran të gjerë 24''
4. RDP/FDP – 2 servera të ndarë për OPDRF01 dhe OPDRF02.
5. M&C – server i vetëm për opsionin me dy ekrane 24 të gjera.
6. Simultator– server i vetëm për opsionin me dy ekrane 24 të gjera.
7. RCOM– dy servera të ndarë për RCOM1 dhe RCOM2, të aftë të programojnë/ndërveprojnë deri në 8 radarë.
8. Regjistruet me ekran – 1 server i vetëm për OPDRF01.

Pajisja e dërguar sipas *skyline build 7.0* do të përfshijë një mbështetje UPS te komponentët për të siguruar kapacitetin e suportit të mjeteve transistente të shkëputjes së energjisë. Kjo është e pavarur nga ndërtimet e pritura UPS.

8.1.1.2.1.3 CLIN SU03. Pajisja 7.0. Përditësimi i programit *software*

Pajisja e përmirësimit të programit 7.0 do të ofrojë programin për të mbështetur BOM të ri dhe funksionalitetin e nevojshëm për të mbështetur kullën/ACC të re, gjithashtu, të sigurojë përmirësimet e mëposhtme:

- Përpunimi i CFMU SAM dhe mesazheve SRM dhe ekrani i kohës CTOT në listën e nisjes dhe pista e uljes së fluturimit.
- Zgjerimi i rangut/linjave të prodhuara në një total prej 7 dhe përfshirja e aftësisë për të ekranizuar një kohë në fiks për të fiksuar një linjë që zgjerohet nga një udhë në një pikë fikse dhe një kohë për ndërprerje për një linjë mes dy shtigjeve/udhëve.
- Prezantimin e caktimit të kodit të centralizuar SSR dhe sistemin e menaxhimit (CCAMS).
- Implementimin e teknologjisë TCP/IP për protokollin e komunikimeve për programet OLDI.

- Amendamentin 1 të implementimit për të prokuruar për shërbimet e navigacionit ajror – menaxhimi i trafikut ajror (PANS-ATM ICAO Dok. 4444). Ndryshimet u njoftuan nga ICAO në datën 25 qershor 2008 në letrën shtetërore 50/2008 dhe u bënë të zbatueshme në datën 15 nëntor 2012. Njoftimi i hershëm i ndryshimit të standardeve është për të lejuar transmetimin e formatit të ri përpara datës së zbatueshme.

- Përpunimin e mesazhit të gjatë ACK IFPS.
- Përditësimet e programeve të lidhura me pajisjet e reja dhe sistemin operativ të përfshirë në rifreskimin e pajisjes 7.0.
- Përpunimin e mesazheve METAR dhe SPECI në dritaret e vendndodhjeve A&M, si vende teksti të lira. Vendndodhja A&M do të tregojnë nxjerrjen e saj standarde në hap kurdo që ndryshojnë të dhënat.
- Zbatimi i sistemit të dërgimit të të dhënave në procesorët ASMT për ASMT ICD.
- Sigurimi i aftësisë për të sinkronizuar rishikimin e regjistruetit me ekran me regjistrim me zë.

8.1.1.3 CLIN SU03. Pajisja 7.0. Varësitë e Blerësit që do të përmbushen në përputhje me planin e kontratës

Blerësi do të japë pjesën e mëposhtme deri në fillim të aktivitetëve të instalimit të SU03. Pajisja 7.0, siç është përcaktuar në planin e programit:

- Akses në vendin e punimeve dhe mbështetje të përgatitjes së vendit të punimeve dhe integrim të pajisjeve (hapësirë, akses në shërbim, freskim, fuqi, kabllo, tokëzim etj. për ndërtesën ICD).

- Ndërtesa duhet të jetë në gjendje kontrolli mjedisor me dritare të mbyllura, energji pune, dritë dhe me ngrohje/ftohje. Ashensori i kullës duhet të jetë në gjendje pune. Duhet të instalohen tavanet e varura të dhomës ACC dhe pajisja.

- Të dhënat e radarit drejt radarëve operacionalë TIA, APR, KRK, SKJ.

- Komunikime të programuara ndaj qendrave ACC të afërta për program koordinimi OLDI (TCP/IP).

- Të marrë pjesë në aktivitetin e pranimit.

8.1.1.4 CLIN SU03. Mbështetja e garancisë

Gjatë periudhës së garancisë, mbështetja e garancisë dhe e mirëmbajtjes do të ofrohen në përputhje me klauzolën 21 të termave dhe kushteve të kontratës.

8.1.1.5 CLIN SU03. Dokumenti i kontrollit të programit të ndërtimit (ICD)

Dokumenti i kontrollit të programit të ndërtimit (ICD) do të përcaktohet në konfigurimin e pajisjeve dhe dokumentin e instalimit të vendit të punimeve. Ky dokument përshkruan varësinë e hollësishme për përgatitjen e vendit të punimeve në mbështetje të instalimit të sistemit *skyline* dhe pjesëve të tjera CLIN të dorëzuara te Shitësi. Ky dokument do t'i japë Blerësit të nevojave të nënsistemit që do të përcaktojnë karakteristikat e kullës dhe ndërtesës së re ACC të nevojshme për të instaluar, testuar dhe vënë në funksion pajisjet CLIN të dorëzuara te Shitësi në kullën dhe ndërtesën ACC. Ajo bazohet në njohuritë e Shitësit për sistemet që duhet të instalohen dhe kërkesat që ndërtesa duhet të përmbushë sukseset e programit shqiptar të modernizimit. Dorëzimi i këtij specifikimi të hollësishëm do t'i japë Blerësit fleksibilitet më të madh në trajtimin e ndryshimeve dhe çështjeve potenciale të ndërtimit që dalin gjatë fazës së ndërtimit. Ky dokument do të shërbejë si një metodë komunikimi të nevojave të pjesëve CLIN dhe do të ofrojë një kuptim të përbashkët midis Blerësit dhe Shitësit për kërkesat e kullës dhe ndërtesës ACC. Ky dokument do t'i japë Blerësit më shumë autonomi në procesin e marrjes së vendimeve në lidhje me ndërtimin.

Dorëzimi i dokumentit do të ndahet në dy faza të ndara. Shitësi do të dorëzojë një version draft për planin e programit, shtojca 3. Duke ndjekur përfundimin e specifikimit final të faturës së materialeve (BOM). Pajisja 7.0, Shitësi do të përgatisë dhe dorëzojë versionin final të konfigurimit të pajisjeve dhe dokumentin e instalimit të vendit të punimeve për planin e programit, shtojca 3. Ndryshimet në amendamentin 3 të kontratës do të rezultojnë në përditësime shtesë të konfigurimit të pajisjeve dhe dokumentin e instalimit të vendit të punimeve.

8.1.1.5.1 CLIN SU03. Dokumenti i kontrollit të programit të ndërtimit (ICD)

Puna për t'u bërë sipas amendamentit 3

Shitësi do të përditësojë ndërtimin e ICD-së për të përshkruar programet e kërkuara për ndërtesën e kullës/ACC të lidhur me kërkesa shtesë apo të ndryshuara si rezultat i amendamentit 3. Këto ndryshime mund të përfshijnë:

- Ndryshime në numrin e pozicioneve punuese të kontrolluesit.

- Ndryshime në programin OLDI për të mbështetur TCP/IP.

8.1.1.5.2 CLIN SU03. Dokumenti i kontrollit të programit të ndërtimit (ICD)

Varësitë e blerësit që duhet të arrihen në përputhje me planin e kontratës

Shitësi do të ofrojë:

1. Rishikim në kohë dhe komente për përditësimet e ICD në përputhje me klauzolat 15 dhe 23 të termave dhe kushteve të kontratës.

2. Pajtueshmëri teknike të plotë me dokumentin IDC të kontratës.

3. Hartë aktuale të terrenit të përdorur për të adaptuar terrenin MSAW, veçanërisht në zonën e sektorit të përpjekjes.

4. Lidhjet e rrjeteve të lidhura me ndërfaqet TCP/IP OLDI.

8.1.2 CLIN OR05. Të ofrojë shërbime dhe asistencë të menaxhimit të programit

Shitësi do të ofrojë një zyrë të menaxhimit të programit për të planifikuar, organizuar, drejtuar dhe kontrolluar programin. Shitësi do të japë ekspertizë në operacionet e trafikut ajror, inxhinieri, pune teknike civile, prokurim, logjistikë, menaxhim të sigurisë financiare dhe të cilësisë.

8.1.2.1 CLIN OR05. Plani i përfundimit për amendamentin 3

Shitësi do të ofrojë menaxhim programi për performancën e të gjitha CLIN deri në datën e përfundimit të kontratës. Shitësi do të japë asistencë për të marrë financim siç është rënë dakord

bashkërisht. Shitësi do të bëjë propozime për modifikim të kontratës për Blerësin siç kërkohet dhe financohet nga Blerësi. Shitësi do të japë një aftësi në vend për të planifikuar, organizuar, drejtuar dhe kontrolluar programin.

Shitësi do të ofrojë arsimin për menaxhimin e programit për Blerësin deri në financimin e disponueshëm.

8.1.2.2. CLIN OR05. Mbështetja e garancisë

Gjatë periudhës së garancisë, shërbimet e menaxhimit të programit do të vazhdojnë për koordinimin e veprimeve të garancisë.

8.1.3 CLIN AT10. Operacionet e trafikut ajror dhe detyra të tjera të lidhura me to

Objekti i këtij CLIN është të ofrojë shërbim të një ofruesi të shërbimeve të navigacionit ajror të pjekur, të aftë dhe të respektuar dhe/ose organizata të tjera të afta për të asistuar Blerësin në detyra të operacioneve të trafikut ajror, financiare, burimeve njerëzore, edukative, ligjore, organizative dhe sigurie. Shitësi do të përmbushë disa detyra të operacioneve të trafikut ajror, financiare, burimeve njerëzore, edukative, ligjore, organizative dhe sigurie, siç është rënë dakord bashkërisht. Blerësi dhe Shitësi gjithashtu do të përcaktojnë dhe së bashku do të bien dakord në detyra të tjera të nevojshme për t'u kryer që nuk janë specifikisht të identifikuar në CLIN të tjera.

8.1.3.1. CLIN AT10. Plani i përfundimit për amendamentin 3

Shitësi do të ofrojë ekspertë të operacioneve të trafikut ajror dhe ekspertizë tjetër për të ofruar rishikim, këshillim dhe konsultim për të mbështetur të gjitha detyrat e CLIN të tjera me objektivin e sigurimit të tranzicioneve efektive dhe të sigurta në operacione. Shitësi do të ofrojë ekspertizë operacionale, ekspertizë financiare ATC dhe ekspertizë ofrimi të shërbimeve të trafikut ajror tjetër ndaj Blerësit sipas kërkesës mbështetja financiare ATC do të përbëhet nga:

- Dy (2) udhëtime nga një (1) javë në vit në Tiranë për të punuar me personelin e Blerësit në përgatitjen e dokumenteve të njëjësive monetare për takimet e komitetit të zgjeruar.

- Dy (2) udhëtime tre (3) ditore për të mbështetur Blerësin në takimet e komitetit të zgjeruar.

- Tri (3) udhëtime të tjera një (1) javore për të mbështetur dhe përfaqësuar Blerësin në takimet e Komitetit të Zgjeruar. Këtë takime përfshijnë marrjen pjesë në grupin e studimit të komitetit të zgjeruar, seminare dhe takime për pagesat e rrugëve.

Shitësi gjithashtu do të ofrojë planifikim teknik dhe mbështetje në implementim gjatë periudhës së performancës së tranzicionit të operacioneve të përcaktuara në planin e programit për të zgjidhur çështje të lidhura me komponentët e automatizimit.

8.1.3.2 CLIN AT10. Mbështetja e garancisë

E pazbatueshme.

8.1.4 CLIN CO03. Sistemi i ri i komunikimit zanor (VCS)

Shitësi do të prokurorë, integrojë dhe instalojë një VCS të re me HMI të avancuar dhe funksion të avancuar, i cili do të jetë i ndërveprueshëm me standardet me ICAO dhe *Eurocontrol* të specifikuar në seksionin 3 të këtij dokumenti.

8.1.4.1 CLIN CO03. Plani i përfundimit pas amendamentit 3

Shitësi do të menaxhojë testin e prokurimit, instalimit dhe pranimit të sistemit të ri VCS. Qëllimi do të përfshijë:

1. 24 Pozicione operatorësh, secili me panele zanore G/G & A/G

Pozicionet përfshijnë (12 pozicione OPS, supervizor, FDR, 2 kulla, 6 TDU dhe instruktor stimulimi):

2. 1 terminal dhe printer M&G;

3. Program radioje deri në 30 transmetues radiofonikë VHF/marrës.

4. Program radioje deri në 6 transmetues radiofonikë VHF/marrës.

5. Programet 14 MFC-R2 në 5 qendra të afërta (Serbi, Itali, Greqi, Maqedoni dhe Korfuz) dhe ofrim të 2 lidhjeve të reja me ACC të Kosovës dhe Malit të Zi.

6. Një ndërfaqe në *link microwave* (mikrovale) dhe një ndërfaqe me fibra optike dhe një ndërfaqe me PABX.

7. Të ndryshme, 48 sete me kufje dhe mikrofona.

8. Program i serverit kohor me VCS (burim i zakonshëm kohor).

9. Regjistruer shtesë zanor.

Shitësi do t'i ofrojë Blerësit trajnim përdorimi dhe mirëmbajtjeje për sistemin.

Shitësi do të ofrojë produkte dhe shërbime për të mbështetur instalimin, integrimin dhe testin e pajisjeve të misionit të kontraktuar në ACC-në e re dhe kullën e re në përputhje me planin e kontratës.

8.1.4.1.1 CLIN CO03. Varësitë e Blerësit për t'u përmbushur në përputhje me planin e kontratës

Blerësi do të ofrojë pikat e mëposhtme në fillim të aktivitetit të instalimit CO03 siç është përcaktuar në planin e programit:

1. Mjedisi dhe aksesin i ndërtesës ACC/Kullë të re që i mundëson Shitësit të instalojë VCS në përputhje me planin e kontratës në shtojcën 3.

2. Linjat COMM për komunikim të disponueshëm në ndërtesën e re ACC.

3. Përshkrimet dhe linjat e programit të radios së vendit të fundit.

4. Pjesëmarrja në aktivitetin e pranimit dhe Komisionimit.

5. Korniza kryesore e shpërndarjes (MDF) për linjat hyrëse të komunikimit si pjesë e ndërtesës.

6. Korniza mesatare e të dhënave (IDF) midis kateve në ACCTWR të re, në përputhje me ndërtesën ICD.

8.1.4.3 CLIN CO03. Mbështetja e garancisë

Gjatë periudhës së garancisë, mbështetja e garancisë dhe e mirëmbajtjes do të ofrohet në përputhje me klauzolën 21 të termave dhe kushteve të kontratës.

8.1.5 CLIN CO02. Transmetuesi UHF/VHF dhe pajisja radiofonike e largët

Shitësi do të prokurojë dhe mbështesë instalimin e transmetuesve VHF/UHF në të dyja ndërtesat ACC/APP/kullë dhe vendi radiofonik i largët që do të jetë i ndërperueshëm me standardet e ICAO dhe *Eurocontrol* të specifikuar në seksionin 3 të këtij dokumenti. Blerësi do të ofrojë një vend të përshtatshëm me hapësirën e mjaftueshme dhe aksesin në rrjetin elektrik kombëtar dhe aksesin e motorit të përshtatshëm për transport të pajisjeve ndërtuese dhe furnizimeve me benzinë.

Përderisa vendi i largët dhe pjesët zëvendësuese të ishin dorëzuar në çerekun e dytë të 2010-s, pjesët më poshtë lidhen me sistemet që do të instalohen në ndërtesën e re.

8.1.5.1 CLIN CO02. Plani i përfundimit për shtojcën 3

Shitësi do të menaxhojë testin e prokurimit, instalimit dhe pranimit të radiove të reja në kullën/ACC të re.

Qëllimi i kësaj pune përfshin një total prej 16 transmetues/marrës (Tx/Rx), që përmbajnë 14 VHF dhe 2 UHF për pajisjen e misionit.

Dorëzimi në ACC/kullën e re do të përfshijë:

- në ACC, 10 Tx/Rx (8 VHF dhe 2 UHF) do të instalohen për të ofruar një pajisje rezervë deri në frekuencat MAIN/STANDBY në vendin e largët.

- në kullë, 6 Tx/Rx do të instalohen për të ofruar një total prej 3 frekuenca kullash kryesore VHF me *stand-by* në vend (6 Tx/Rx në total).

- Kapacitet rezervë/karikim baterie për të mbështetur 2 orë veprim pa mjete energjie.

Shitësi do të ofrojë produkte dhe shërbime për të mbështetur instalimin, integrimin dhe testimin e pajisjeve radiofonike VHF/UHF në ACC dhe kullën e re në përputhje me planin e kontratës.

Shitësi do të ofrojë produkte dhe shërbime për të mbështetur instalimin, integrimin dhe testimin e një linku të ri me mikrovalë mes vendit të largët dhe ndërtesës së kullës së re ACC.

8.1.5.2. CLIN CO02. Varësitë e Blerësit për t'u përmbushur në përputhje me planin e kontratës.

Blerësi do të ofrojë pikat e mëposhtme në fillim të aktivitetit të instalimit CO02 siç është përcaktuar në planin e programit:

- Miratim për të gjitha frekuencat e kërkuara;

- Akses në vendin e punimeve dhe mbështetje të vendit të punimeve për instalimin dhe integrimin e pajisjes (hapësirë, akses shërbimi, freskim, fuqi, kablllo, përpunim etj. për ndërtesën ICD);

- Radiot e vendit të fundit;

- Pjesëmarrje në aktivitetin e pranimit dhe komisionimit;
- Kontrolli i fluturimit;
- Montim dhe pole për antenë të vendosur në kullën dhe ACC-në e re;
- Pikë aksesi ndërtimi për kabllo të radios VHF/UHF nga antenat te dhoma e pajisjeve.

8.1.5.3 CLIN CO02. Mbështetja e garancisë

Gjatë periudhës së garancisë, mbështetja e garancisë dhe e mirëmbajtjes do të ofrohen në përputhje me klauzolën 21 të termave dhe kushteve të kontratës.

8.1.6. CLIN CO05. Rrjeti i telekomunikacioneve fiks aeronautikë (AFTN)

Minindezësi/çelësi

Shitësi do të prokurojë dhe instalojë një minindezës AFTN me mbështetje të AMHS.

8.1.61. CLIN CO05. Plani i përfundimit për amendamentin 3

Shitësi do të prokurojë, instalojë dhe drejtojë SAT të AFTN minindezës për të përfshirë:

1. Serveri shtesë për të akomoduar dy lidhje (Romë/Athinë).
2. Katër terminale.
3. Tre printera.

4. Aftësia për të përditësuar çelësin për të përfshirë kapacitetin e komunikimeve AMHS që do të përdorë protokollin P1 mbi TCP/IP për të komunikuar me serverat e tjerë të mesazheve ATS.

Shitësi do të prokurojë, instalojë dhe drejtojë SAT në përditësimin e minindezësit AFTN për të siguruar kapacitetin e komunikimeve AMHS që do të përdorë protokollin P1 mbi TCP/IP për të komunikuar me serverat e tjerë të mesazheve ATS.

Shitësi do të zhvillojë dhe dërgojë një dokument kërkesash AHMS-së.

Shitësi do të ofrojë programin e minindezësit AFTN me *skyline* dhe do të demonstrojë programin me *skyline*.

Shitësi do të ofrojë trajnim përdorimi dhe mirëmbajtjeje për sistemin e Blerësit.

Shitësi do të ofrojë mbështetje për tranzicionin operacional ndaj Blerësit, sipas CLIN AT10. Përpara SAT Shitësi do t'i japë informacion planit të tranzicionit operacional të Blerësit që do të përcaktojë pjesëmarrjen e Shitësit.

Shitësi do të ofrojë produkte dhe shërbime për të mbështetur instalimin, integrimin dhe testin e AFTN-së, pajisje minindezës në ACC dhe Kullën e re në përputhje me planin e kontratës.

8.1.6.2. CLIN CO05. Varësitë e Blerësit për t'u përmbushur në përputhje me planin e kontratës

Blerësi do të ofrojë pika në fillim të aktivitetit të instalimit CO05, siç është përcaktuar në planin e programit:

1. Dy lidhje të pavarura AFTN dhe AMHS (një nga Athina dhe një nga Roma) me dhomën e pajisjeve të reja ACC.

2. Akses në vendin e punimeve dhe përgatitje të mbështetjes së vendit të punimeve (hapësira, aksesi i vendit, freskim, fuqi, kablo, përpunim etj., për ndërtesën e sistemit ICD).

3. Pjesëmarrja në aktivitetin e pranimit dhe komisionimit.

8.1.6.3. CLIN CO05. Mbështetja e garancisë

Gjatë periudhës së garancisë, mbështetja e garancisë dhe mirëmbajtjes do të ofrohen në përputhje me klauzolën 21 të termave dhe kushteve të kontratës. Shih planin e kontratës.

8.1.7. CLIN NA04. CAT1 ILS i aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza"

Shitësi do të prokurojë dhe mbështesë instalimin e një CAT1 ILS në aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza", që do të jetë i ndërveprueshëm me standardet e ICAO dhe *Eurocontrol*, të specifikuara në paragrafin 3. Blerësi do të ofrojë një vend të përshtatshëm dhe hapësirë të mjaftueshme dhe akses në rrjetin elektrik kombëtar dhe akses në motorë të përshtatshëm për transport të pajisjeve të konstruksionit dhe furnizimeve me benzinë.

8.1.7.1 CLIN NA 04. Plani i përfundimit për amendamentin 3

Shitësi do të përfundojë SAT.

8.17.2. CLIN NA04

Varësitë e Blerësit që do të përmbushen në përputhje me planin e kontratës.

Blerësi do të ofrojë:

1. Përmirësim të terrenit në jug të rrugës nga qendra e antenës lokalizuese. Përmirësimi i terrenit do të jetë me një diametër prej 400 metrash. Terreni duhet të jetë i lirë nga gëmushat dhe shkurret dhe terreni i përmirësuar duhet të jetë i sheshtë. Niveli i terrenit do të jetë i sheshtë gjatë gjithë sipërfaqes.

2. Përmirësim të terrenit në veri të rrugës nga qendra e strehës së tatëpjetës, përmirësimi do të jetë i një diametri prej 500 metrash në veri dhe 500 metra në jug nga streha e tatëpjetës dhe gjerësia e përmirësimit do të jetë 200 metra me një diametër 100 metër nga secila anë te linja e qendrës së tatëpjetës. Niveli i terrenit do të jetë i sheshtë gjatë të gjithë sipërfaqes.

3. Përgatitje të terrenit në përputhje me ICAO dhe EUROCAE dhe specifikimet, duke përdorur kriteret e fundit nga ICAO, EUROCAE, agjencitë përcaktuese në instalim dhe operim të pajisjeve navigacionale rreth e rrotull botës. (Shitësi të ofrojë kriteret FAA vetëm për informacion).

4. Të ofrojë kablo të transferimit të të dhënave për RSU-në nga kulla në vendin ekzistues të ANTA në dhomën ku RCSU dhe ILS janë të instaluar.

5. Të ofrojë kontroll inspektimi të fluturimeve.

8.1.8.1.3 CLIN NA 04. Mbështetja e garancisë

Gjatë periudhës së garancisë, mbështetja e garancisë dhe mirëmbajtjes do të ofrohen në përputhje me klauzolën 21 të termave dhe kushteve të kontratës.


8.2. Të dhënat e artikujve që do të dërgohen

Numri i artikullit	Të dhënat e përshkrimit të kopjeve	Numri	Kërkesat për akordimin	Seksioni SOW
001	Plani i menaxhimit të programit	1	90 ditë pas kontratës	6.4.
002	Rishikim i agjendave të takimeve	1	5 ditë para takimit	6.2.1.
003	Prezantimi PMR	1	5 ditë para PMR	6.2.2.
004	Raporti i progresit mujor	1	30 ditë pas përfundimit	
005	Plani i testimit	1	90 ditë pas hyrjes në fuqi të kontratës	4.5.2
007	Procedurat e testimit të pranimit në fabrike	1	30 ditë para testimit	4.5.3.
008	Procedura e testimit në vend	1	30 ditë para testimit	4.5.5.
009	Relacioni testimit të pranimit në zonë	1	60 ditë pas testimit	4.5.7
010	Plani i instalimit	1	90 ditë pas hyrjes në fuqi të kontratës	4.8.2
011	Paketë vizatimi e ndërtimit	1	90 ditë pas instalimit	4.8.2
012	Paketa e vizatimeve të ndërtimit përfundimtar	1	90 ditë pas SAT	4.8.2
013	Plani i trajnimit	1	90 ditë pas hyrjes në fuqi të kontratës	4.6
014	Dokumentim dhe manuale teknike	1	Me pajisje	4.2.2.1
015	Forma e përmbushjes së kërkesave	1	90 ditë pas hyrjes në fuqi të kontratës	4.11.
017	Pakica PMR dhe TIM	1	10 ditë pas përfundimit	6.2.2.
018	Elementë të veprimeve	1	Me elementin me të dhëna 017	6.3.2
019	Material trajnimi	TBD	30 ditë para fillimit	4.2.2.2

Shënime 1. Blerësi duhet të ketë deri në 14 ditë kalendarike kohë, pas paraqitjes së të dhënave për të marrë komente, periudhë pas së cilës kjo konsiderohet e aprovuar.

SHTOJCË 3
PROGRAMI I ZBATIMIT (REALIZIMIT)
Nr. reference:ALBGEN02-0025
1 tetor 2010

Ky dokument i jepet Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar për qëllimet e fazës së 3-të, amendimit të 3-të për NAMP (Programi i modernizimit të hapësirës ajrore). Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të kopjohet, fotokopjohet, riprodhohet, përkthehet apo të kthehet në ndonjë formë elektronike të mesme apo në ndonjë program lexues pa miratimin paraprak me shkrim të Lockheed Martin Corporation. Logot *skyline* dhe Lockheed Martin janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të Lockheed Martin Corporation. Këta artikuj të përdorimit të gjerë, teknologji apo *software* janë eksportuar nga Shtetet e Bashkuara në përputhje me rregullat e administratës së eksportit për destinacion final Shqipërinë. Devijimi në kundërshtim të ligjit të SHBA-së është i ndaluar.



ID	Task Name	Dura	Start	Finish	Gantt Chart														
					0	2011				2012				2013				2014	
					Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
37	Vendor VHF/UHF FAT Complete	0 d	7/1/11	7/1/11															
38	Direct Ship VHF/UHF Radios Equipment to Albania	15 d	8/12/11	9/1/11															
39	Install VHF/UHF Radios Equipment	25 d	9/2/11	10/8/11															
40	Integrate VHF/UHF Radios	15 d	10/7/11	10/27/11															
41	Conduct VHF/UHF Radios SAT	10 d	10/28/11	11/10/11															
42	VHF/UHF Radios SAT Complete	0 d	11/10/11	11/10/11															
43	VHF/UHF Radios Maintenance Training	10 d	8/13/11	8/24/11															
44	VHF/UHF Radios User Training	10 d	10/14/11	10/27/11															
45	Radios Warranty Period	522 d	11/1/11	11/11/13															
46	Early Radios Warranty Period	967 d	10/4/10	8/15/14															
47																			
48	CO03	811 d	10/4/10	11/11/13															
49	VCS	289 d	10/4/10	11/10/11															
50	Produce VCS Radios Equipment	180 d	10/4/10	8/10/11															
51	Conduct Vendor VCS FAT	15 d	6/13/11	7/1/11															
52	Vendor VCS FAT Complete	0 d	7/1/11	7/1/11															
53	Direct Ship VCS Radios Equipment to Albania	15 d	8/12/11	9/1/11															
54	Install VCS Radios Equipment	25 d	9/2/11	10/8/11															
55	Integrate VCS Radios	15 d	10/7/11	10/27/11															
56	Conduct VCS Radios SAT	10 d	10/28/11	11/10/11															
57	VCS Radios SAT Complete	0 d	11/10/11	11/10/11															
58	VCS Radios Maintenance Training	10 d	8/13/11	8/24/11															
59	VCS Radios User Training	10 d	10/14/11	10/27/11															
60	VCS Warranty Period	522 d	11/1/11	11/11/13															
61	CO05	806 d	10/4/10	11/4/13															
62	AFTN Mini-Switch with AMHS	284 d	10/4/10	11/3/11															
63	Produce AFTN Equipment	180 d	10/4/10	8/10/11															
64	Conduct Vendor AFTN FAT	15 d	6/13/11	7/1/11															
65	Vendor AFTN FAT Complete	0 d	7/1/11	7/1/11															
66	Direct Ship AFTN Equipment to Albania	15 d	7/22/11	8/11/11															
67	Install AFTN Equipment	30 d	8/12/11	9/22/11															
68	Integrate AFTN	20 d	9/23/11	10/20/11															
69	Conduct AFTN SAT	10 d	10/21/11	11/3/11															
70	AFTN SAT Complete	0 d	11/3/11	11/3/11															
71	Prepare AMHS Specifications	80 d	10/4/10	1/21/11															
72	Deliver AMHS Specification for customer review	0 d	1/21/11	1/21/11															

Project: Albania Amend 3
Date: 10/7/10

Task: Milestone: External Tasks:

Split: Summary: External Milestone:

Progress: Project Summary: Deadline:

Page 2

ID	Task Name	Dura	Start	Finish	Gantt Chart														
					0	2011				2012				2013				2014	
					Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
73	Customer review of specifications	10 d	1/24/11	2/4/11															
74	AMHS Specifications complete	0 d	2/4/11	2/4/11															
75	AFTN Mini-Switch Maintenance Training	10 d	8/13/11	8/24/11															
76	AFTN Mini-Switch User Training	10 d	9/30/11	10/13/11															
77	AFTN Warranty Period	522 d	11/4/11	11/4/13															
78																			
79	AT10	379 d	10/4/10	3/15/12															
80	Financial Support	260 d	10/4/10	9/30/11															
81	Financial Planning Meeting - Prepare for Final 2011 Unit Rate	5 d	10/4/10	10/8/10															
82	Financial Planning meeting report 1	10 d	10/11/10	10/22/10															
83	Financial Planning Meeting - Attend Final 2011 Unit Rate Meeting	5 d	11/8/10	11/12/10															
84	Financial Planning meeting report 2	10 d	11/15/10	11/26/10															
85	Financial Planning Meeting - Prepare for 2012 Preliminary Route Chg	5 d	4/4/11	4/8/11															
86	Financial Planning meeting report 3	10 d	4/11/11	4/22/11															
87	Financial Planning Meeting - Approve 2012 Preliminary Route Charge	5 d	5/6/11	5/13/11															
88	Financial Planning meeting report 4	10 d	5/18/11	5/27/11															
89	Financial Planning Meeting - Review and Recommend Final 2012 Ur	5 d	6/14/11	6/20/11															
90	Financial Planning meeting report 5	10 d	6/21/11	7/4/11															
91	Financial Planning Meeting - Final 2012 Unit Rate	5 d	9/12/11	9/16/11															
92	Financial Planning meeting report 6	10 d	9/19/11	9/30/11															
93	Transition Support	95 d	11/4/11	3/15/12															
94																			
95	OR05	847 d	10/4/10	12/31/13															
96	PMO	325 d	10/4/10	12/30/11															
97	PMO Warranty Period	522 d	1/2/12	12/31/13															
98																			
99	NA04	538 d	9/30/10	10/22/12															
100	ILS Preparation	5 d	9/30/10	10/6/10															
101	ILS SAT	10 d	10/7/10	10/20/10															
102	ILS SAT Complete	0 d	10/20/10	10/20/10															
103	ILS Warranty Period	523 d	10/21/10	10/22/12															
104																			
105	Dependencies	232 d	9/1/10	7/21/11															
106	Negotiation Complete/Customer ATP	0 d	10/4/10	10/4/10															
107	Receive Notification of Flight Test	0 d	9/1/10	9/1/10															
108	Terrain Map	0 d	2/28/11	2/28/11															



Project: Albania Amend 3
Date: 10/7/10

Task: Milestone: External Tasks:

Split: Summary: External Milestone:

Progress: Project Summary: Deadline:

Page 3



SHTOJCË 4
Programi i historikut (Milestone) të pagesës
QEVERIA E SHQIPËRISË
DHE
LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC.
Nr. reference ALBGEN02-0025
1 tetor 2010

Ky dokument i jepet Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar për qëllimet e fazës së 3-të, amendimit të 3 për NAMP (programi i modernizimit të hapësirës ajrore). Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të kopjohet, fotokopjohet, riprodhohet, përkthehet apo të kthehet në ndonjë formë elektronike të mesme apo në ndonjë program lexues pa miratimin paraprak me shkrim të Lockheed Martin Corporation. Logot *SkyLine* dhe Lockheed Martin janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të Lockheed Martin Corporation. Këta artikuj të përdorimit të gjerë, teknologji apo *software* janë eksportuar nga Shtetet e Bashkuara në përputhje me rregullat e administratës së eksportit për destinacion final Shqipërinë. Devijimi në kundërshtim të ligjit të SHBA-së është i ndaluar.

TABELA CLIN KRYESORE E NAMP PËR SHQIPËRINË - AMENDAMENTI 3						
CLIN	Përshkrimi i detyrës	Objekti	Dorëzimi	Produkti ose shërbimi	Përfundimi i punimit	Shuma e pagesës
SU03						
S U 0 3	Shitësi porosit faturën e materialeve të sistemit të automatizimit për instalim në ndërtesën e re të ANTA	Letër me dokumentin që vërteton dorëzimin e porosive	Letra e dokumentit me faturë	Produkti HW dhe SW	prill 2011	\$ 1,347,005
	Shitësi dërgon pajisjet e faturës së materialeve	Letër me dokumentin që vërteton dorëzimin	Letra e dokumentit me faturë	Produkti HW dhe SW	gusht 2011	\$ 1,347,005
	Specifikimi i kërkesave të sistemit të produktit të përmirësimit ndërtesa 7.0	Dokumenti SRS	Dokumenti SRS	Produkti SW	janar 2011	\$ 1,347,005
	Përmirësimi i produktit Ndërtesa 7.0 Përmirësimet në përputhje me SOW. Shitësi përfundon skicimet e sistemit, përditëson kërkesat e sistemit, implementon ndryshimin e sistemit SW dhe me sukses përfundon FAT	Implementimi i suksesshëm dhe përfundimi i FAT	Letra e dorëzuar me FAT. Raporti i testit prapa dhe certifikatën e FAT. Letra e protokollit me faturën fiskale	Produkti SW	qershor 2011	\$ 1,347,005
	Përmirësimi i produktit Ndërtesa 7.0 Shitësi integron sistemin dhe me sukses përfundon SAT	Implementimi i suksesshëm dhe përfundimi i SAT	Letra e dorëzuar me SAT. Raporti i testit prapa dhe certifikatën e SAT. Letra e protokollit me faturën fiskale	Produkti SW	dhjetor 2011	\$ 1,347,005
	AMENDAMENTI TOTAL 3 PAGESAT SU03 \$ 1,347,005					

CO02						
C O 0 2	Ofrim i relese së radios së largët dhe transmarrësit radiofonikë VHF UHF – Shitësi përfundon aktivitetet FAT	Aktiviteti i pranimit i përfunduar	Letra e dorëzimit me raportin e post testit dhe certifikata e pranimit FAT. Letra e protokollit me faturën.	Produkti HW	korrik 2011	\$ 165,733
	Ofrim i relese së radios së largët & transmarrësit radiofonikë VHF UHF – Shitësi dorëzon pajisjen te vendi	Fatura e udhës ajrore	Letra e protokollit dhe fatura e udhës ajrore	Produkti HW	gusht 2011	\$ 202,822
	Ofrim i relese së radios së largët & transmarrësit radiofonikë VHF UHF – Shitësi përfundon aktivitetet SAT	Aktiviteti i pranimit i përfunduar	Letra e dorëzuar me raportin e post testit SAT certifikata e pranimit	Produkti HW	nëntor 2011	\$192,680
AMENDAMENTI TOTAL 3 PAGESA CO02 \$561,235						
CO03						
C O 0 3	Ofrimi i VCS në kullën e re ACC- Shitësi të lidhë VCS me komunikimin ekzistues Shitësi të përfundojë aktivitetet FAT	Aktiviteti i pranimit i përfunduar	Raporti post test FAT certifikata e pranimit	Produkti HW	korrik 2011	\$ 240,689
	Ofrimi i VCS në kullën e re ACC- Shitësi të dorëzojë pajisjet në vendin operues	Fatura e udhës ajrore	Letra e protokollit dhe fatura e udhës ajrore	Produkti HW	gusht 2011	\$ 366,448
	Ofrimi i VCS në kullën e re ACC- Shitësi të lidhë VCS me komunikimin ekzistues Shitësi të përfundojë aktivitetet SAT	Aktiviteti i pranimit i përfunduar	Raporti post test SAT certifikata e pranimit	Produkti HW	nëntor 2011	\$ 348,125
AMENDAMENTI TOTAL 3 PAGESA CO03 \$ 955,263						

TABELA CLIN KRYESORE E NAMP PËR SHQIPËRINË - AMENDAMENTI 3						
CLIN	Përshkrimi i detyrës	Objekti	Dorëzimi	Produkti ose shërbimi	Përfundimi i punimit	Shuma e pagesës
CO05						
	Sistemi ATC i trajtimit të mesazhit së përditësimi (AMHS)	Letra me dokumentin e kërkesave AMHS	Dokumenti i kërkesave AMHS	Produkti SW	shkurt 2011	\$ 117,967
	Ofrimi i minindezësit AFTN – Shitësi të kryejë aktivitetet FAT	Implementim i suksesshëm dhe përfundim i FAT	Raporti post test FAT certifikata e pranimit	Produkti HW & SW	korrik 2011	\$ 155,051
	Ofrimi i minindezësit AFTN – Shitësi të dorëzojë pajisjen te vendi operues	Fatura e udhës ajrore	Letra e protokollit dhe fatura e udhës ajrore	Produkti HW & SW	gusht 2011	\$ 177,881
	Ofrimi i minindezësit AFTN – Shitësi të kryejë aktivitetet SAT	Implementim i suksesshëm dhe përfundim i SAT	Raporti post test SAT certifikata e pranimit	Produkti HW & SW	nëntor 2011	\$ 168,987
AMENDAMENTI TOTAL 3 PAGESA CO05 \$ 619,886						

AT10						
A T 1 0	Takimi 1 i planifikimit financiar (Tiranë) Përgatitje për takim të Komitetit të Zgjeruar Rishikim dhe rekomandime për shkallën finale të njësisë 2011	Raporti i takimit për planifikimin financiar 1	Raporti i takimit për planifikimin financiar 1	Shërbimet	tetor 2010	\$14,223
	Takimi 2 i planifikimit financiar mbështetje për takim të Komitetit të Zgjeruar Rishikim për shkallën finale të njësisë 2011	Raporti i takimit për planifikimin financiar 2	Raporti i takimit për planifikimin financiar 2	Shërbimet	nëntor 2010	\$ 8,361
	Takimi 3 i planifikimit financiar (Tiranë) Përgatitje për takim të Komitetit të Zgjeruar Rishikim dhe rekomandime për ngarkesat e rrugëve paraprake për 2012	Raporti i takimit për planifikimin financiar 3	Raporti i takimit për planifikimin financiar 3	Shërbimet	maj 2011	\$ 14,223

Takimi 4 i planifikimit financiar mbështetje për takim të Komitetit të Zgjeruar Rishikim për shkallën paraprake të njësisë 2012	Raporti i takimit për planifikimin financiar 4	Raporti i takimit për planifikimin financiar 4	Shërbimet	qershor 2011	\$ 8,361
Takimi 5 i planifikimit financiar Përgatitje për takim të Komitetit të Zgjeruar Rishikim dhe rekomandime për shkallën finale të njësisë 2012	Raporti i takimit për planifikimin financiar 5	Raporti i takimit për planifikimin financiar 5	Shërbimet	tetor 2011	\$ 14,223
Takimi 6 i planifikimit financiar përgatitje për takim të Komitetit të Zgjeruar Rishikim dhe rekomandime për shkallën finale të njësisë 2012	Raporti i takimit për planifikimin financiar 6	Raporti i takimit për planifikimin financiar 6	Shërbimet	nëntor 2011	\$ 8,361
Shitësi do të menaxhojë tranzicionin e sistemeve të metalit (p.sh. Sky line, ILS, VCS) në ndërtesën e re të kullës ACC përmes periudhës së tranzicionit. Fillimi i tranzicionit të mbështetjes teknike	Plani i tranzicionit të sistemit LM	Raporti i tranzicionit operacional LM	Shërbimet	janar 2012	\$ 320,629
Shitësi do të menaxhojë tranzicionin e sistemeve të metalit (p.sh. Sky line, ILS, VCS) në ndërtesën e re të kullës ACC përmes periudhës së tranzicionit. Fillimi i tranzicionit të mbështetjes teknike	Plani i tranzicionit të sistemit LM	Raporti i tranzicionit operacional LM	Shërbimet	mars 2012	\$ 320,629
AMENDAMENTI TOTAL 3 PAGESA AT10 \$709,011					

TABELA CLIN KRYESORE E NAMP PËR SHQIPËRINË - AMENDAMENTI 3						
CLIN	Përshkrimi i detyrës	Objekti	Dorëzimi	Produkti ose shërbimi	Përfundimi i punimit	Shuma e pagesës
OR05						
O R 0 5	Shitësi do të ofrojë periudhë menaxhimi për kryerjen e të gjitha CLINS. Shitësi do t'i përgjigjet kërkesave për propozime të ndryshme (CP) (1 nga 5)	Raport mujor, i cili detajon detyrat kryesore për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e Blerësit	Letra e dorëzimit me progres raportin mujor	Shërbim	dhjetor 2010	\$ 415,561
	Shitësi do të ofrojë periudhë menaxhimi për kryerjen e të gjitha CLINS. Shitësi do t'i përgjigjet kërkesave për propozime të ndryshme (CP) (2 nga 5)	Raport mujor, i cili detajon detyrat kryesore për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e Blerësit	Letra e dorëzimit me progres raportin mujor	Shërbim	mars 2011	\$ 415,561
	Shitësi do të ofrojë periudhë menaxhimi për kryerjen e të gjitha CLINS. Shitësi do t'i përgjigjet kërkesave për propozime të ndryshme (CP) (3 nga 5)	Raport mujor, i cili detajon detyrat kryesore për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e Blerësit	Letra e dorëzimit me progres raportin mujor	Shërbim	qershor 2011	\$ 356,274
	Shitësi do të ofrojë periudhë menaxhimi për kryerjen e të gjitha CLINS. Shitësi do t'i përgjigjet kërkesave për propozime të ndryshme (CP) (4 nga 5)	Raport mujor, i cili detajon detyrat kryesore për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e Blerësit	Letra e dorëzimit me progres raportin mujor	Shërbim	shtator 2011	\$ 356,274
	Shitësi do të ofrojë periudhë menaxhimi për kryerjen e të gjitha CLINS. Shitësi do t'i përgjigjet kërkesave për propozime të ndryshme (CP) (5 nga 5)	Raport mujor, i cili detajon detyrat kryesore për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e Blerësit	Letra e dorëzimit me progres raportin mujor	Shërbim	dhjetor 2011	\$ 356,274

	Edukimi i klientëve 1 prej 2	Letra e projektit në përfundimin e kursit	Organizim i kursit të edukimit për konsumator për kërkesat e klientit duke përfshirë instruktorin, vendin, materialet	Shërbim	mars 2011	\$ 61,580
	Edukimi i klientëve 2 prej 2	Letra e projektit në përfundimin e kursit	Organizim i kursit të edukimit për konsumator për kërkesat e klientit, duke përfshirë instruktorin, vendin, materialet	Shërbim	tetor 2011	\$ 61,580
AMENDAMENTI TOTAL 3 PAGESA AT10 \$ 2,023,105						
OR 05 UB						
O R 0 5 U B	Rezerva e konsumatorit – me bazë detyre urdhri – Të faturohet kostoja siç bëhet	Urdhrat e detyrës	Letra e dorëzimit me urdhrin e detyrës	Produkti i shërbimit	Sipas nevojës	\$ 1,202,788
AMENDAMENTI TOTAL 3 PAGESA OR 05UB \$ 1,202,788						
NA04						
	Qëllim shtesë për përfundimin e testit ILS SAT	Implementim i suksesshëm dhe përfundim i SAT	Raporti SAT post test certifikata e pranimi	Shërbim	tetor 2010	\$ 130, 131
AMENDAMENTI TOTAL 3 PAGESA NA04 \$ 130, 131						

Pagesat e amendamenteve totale \$ 12, 407, 96

Letra totale e kreditit (përfshin OR05 UB dhe NA04) \$ 11, 074,877

FATURAT DHE PAGESAT E PAPAGUARA TË AMENDAMENTIT 2				
Numri i faturës	Data e faturimit	Përshkrimi	Shuma	Data e pagesës
08-BNZ-154	30 gusht 2010	SU 03- pagesa finale BOM	\$291,343	20 shtator 2010
08-BNZ-155	30 gusht 2010	NA04 pagesa ILS SAT	\$350,386	
08-BNZ-153	15 korrik 2010	AT10 takimi i Komitetit të Zgjeruar	\$4,971	20 shtator 2010
08-BNZ-156	10 shtator 2010	Su03 ICD finale	\$53,350	6 tetor 2010
08-BNZ-157	01 tetor 2010	OR05 shtator 2010 pagesa e kilometrazhit	\$242.038	
08-BNZ-158	01 tetor 2010	OR05 shtator 2010 pagesa e kilometrazhit	\$ 185,630	
Shënim. Pagesat priten si pjesë e amendamentit 2 ose do t'i shtohen planit të amendamentit 3.				

SHTOJCA 4
PLANI I PAGESAVE TË PUNIMEVE
 Informacion i Lockheed Martin
 Amendamenti NAMP Shqipëri 3

Lockheed Martin

SHTOJCË 5
Letër vërtetuese krediti

QEVERIA E SHQIPËRISË DHE
LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC.
Nr. reference ALBGEN02-0025
1 tetor 2010

Ky dokument i jepet Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar për qëllimet e fazës së 3-të, amendimit të 3 për NAMP (programi i modernizimit të hapësirës ajrore). Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të kopjohet, fotokopjohet, riprodhohet, përkthehet apo të kthehet në ndonjë formë elektronike të mesme apo në ndonjë program lexues pa miratimin paraprak me shkrim të Lockheed Martin Corporation. Logot *SkyLine* dhe Lockheed Martin janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të Lockheed Martin Corporation. Këta artikuj të përdorimit të gjerë, teknologji apo *software* janë eksportuar nga Shtetet e Bashkuara në përputhje me rregullat e administratës së eksportit për destinacion final Shqipërinë. Devijimi në kundërshtim të ligjit të SHBA-së është i ndaluar.

SHTOJCA 5
LETËR VËRTETUESE KREDITI
Forma e letrës vërtetuese të kreditit

Nr. i kredit vërtetues: _____ (plotësohet sapo lëshohet)
Data e lëshimit: _____ Rregullat e aplikueshme: UCP 600
Data dhe vendi i skadencës: [fut datën], me konfirmimin e njehsorëve të bankës SHBA

Aplikanti: [fut emrin e plotë të aplikantit siç paraqitet në faturë]
[fut adresën e plotë të aplikantit siç paraqitet në faturë]
SHQIPËRI

Përfituesi: Lockheed Martin Global Inc.
9211 Corporate Boulevard
Rockville, maryland 20850
SHBA

Monedha: USD

Shuma: 11,074,877 USD

Shuma maksimale e kreditit: nuk e tejkalon

E disponueshme me: [fut emrin e bankës së caktuar të shitësit] SHBA

E disponueshme nga: negocimi

Me: vështrim

Pagesë parciale: e lejuar

Përshkrimi i mallrave dhe shërbimeve:

Për shitjen e mallrave dhe shërbimeve sipas kontratës kryesore të NAMP të rishikuar, amendimi 3, çështja 5, referenca ALBGEN02-0025, që mbulon modernizimin e menaxhimit të trafikut ajror të Shqipërisë, sistemeve të komunikacioneve, navigacionit dhe mbikëqyrjes në Shqipëri.

Dokumentet e kërkuara:

Një faturë origjinale dhe një fotokopje që i referohet kësaj letre krediti të nënshkruar enkas nga aplikanti dhe përfituesi.

Kushte shtesë:

Dokumente që tregojnë një adresë të përfituesit, të ndryshme nga fusha nr.59 janë të pranueshme nëse adresa është ose në SHBA ose në Shqipëri.

Dokumente që tregojnë emrin e përfituesit si LMGI, Lockheed Martin, Lockheed Martin Global Inc, një zëvendës i Lockheed Martin Corporation, ose Lockheed Martin Global Inc, një zëvendës plotësisht i poseduar nga Lockheed Martin Corporation, janë të pranueshme.

Dokumentet e paraqitura më tej se 21 ditë pas datës së lëshimit janë të pranueshme.

Detyrimet:

Tarifat e bankave në Shqipëri duke përfshirë konfirmimin janë për llogari të aplikantit. Tarifa të tjera bankare në SHBA, duke përfshirë konfirmimin, janë për përfituesin.

Instrukcioni konfirmimi: Ju lutem, shtoni konfirmimin tuaj

.....

Banka e rimbursimit: [futni emrin e bankës]

Instrukcione për bankën paguese/pranuese/negociuese: me debit të llogarisë sonë me [futni emrin e bankës] vlerë 3 ditë duke numëruar që nga dita njoftimi SWIFT i kërkesës suaj për fonde drejtuar në (.....) kundrejt dokumenteve në përputhje të plotë me afatet dhe kushtet e letërkreditit.

Dërguesi të marrësi i informacionit: dokumentet që duhet të na dërgohen në duhet të jenë në dy kopje në zarfe të ndara, me postë *courier* ose *express* në adresën tonë [futni adresën e bankës].

VENDIM

Nr.83, datë 13.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.44, DATË 8.6.2005 TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË “PËR MIRATIMIN E SISTEMIT RAPORTUES PËR SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 27 dhe të nenit 43 germa “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 47 pika 3 të ligjit nr.8782, datë 3.5.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Statistikave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.44, datë 8.6.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) në pikën 1, germa “a” “Raportime nga unionet për aktivitetin e tyre” dhe germa “c” “Raportime nga unionet me të dhëna individuale për çdo shoqëri kursim-kreditit, formulari nr.6 “Likuiditeti”, ndryshon sipas formatit bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

SISTEMI RAPORTUES I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE

Formulari nr.6

Nr.	Likuiditeti	Norma e lejuar	Në mijë lekë	Në %
			Shuma	Raportet e mbikëqyrjes
1	Gjendja e arkës			
2	Llogaritë rrjedhëse			
3	Depozitat me afat maturimi mbetës deri në 1 muaj			
4	Totali (1+2+3)			
5	Totali i depozitave të lira me afat maturimi jo më të madh se 6 muaj			
	Raporti 4 / 5 *100	jo më e vogël se 10%		#DIV/0!
1	Kredi me afat mbi 5 vjet			
2	Kapitali (pas zbritjes së aktiveve fikse)			
	Raporti 1 / 2 * 100	jo më e madhe se 100%		#DIV/0!
3	Totali i depozitave			
	Raporti 1 / 3 * 100	jo më e madhe se 10%		#DIV/0!
4	Detyrime me afat mbi 5 vjet			
	Raporti 1 / 4 *100	jo më e madhe se 100%		#DIV/0!
5	Kredi me afat mbi 10 vjet			
6	Kredi me afat mbi 5 vjet në dy vitet e para			
7	Totali i kredive mbi 7 vjet të pagarrantuara			

* Përfshihen kreditë e dhëna me një afat mbi 7 vjet të pagarrantuara me kolaterale të specifikuar në pikën 8.5 të nenit 8 të rregullores "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr.65, datë 29.9.2010.

VENDIM
Nr.88, datë 22.12.2010

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 57 pika 2, nenit 58 pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, dhe neneve 62 dhe 64 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, miratuar me vendimin nr.31, datë 30.4.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 5, shkronja “b” ndryshon si më poshtë:

“titujt (letrat me vlerë) e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose nga Banka e Shqipërisë në monedhë kombëtare”.

b) Në nenin 7, pika 6 ndryshon si më poshtë:

“Ekspozimi i bankës ndaj shoqërisë mëmë, filialit të bankës apo një ose më shumë filialeve të shoqërisë mëmë, nuk mund të tejkalojë 20 (njëzet) për qind të kapitalit rregullator.”.

c) Në nenin 8, shkronja “b” shtohen pikat iii) dhe v) me përmbajtjen e mëposhtme:

“iii)...të drejtat ndaj bankave dhe institucioneve financiare që veprojnë në vendet e OECD dhe shprehimisht të garantuara prej tyre, me përjashtim të rastit kur këto të drejta, sipas rregullave në fuqi, përfshihen në kapitalin rregullator të tyre; dhe

v)...të drejtat me afat deri në maturim jo më shumë se 1 (një) vit ndaj bankave dhe institucioneve financiare të vendeve që nuk bëjnë pjesë në OECD ose të drejtat mbi 1 (një) vit, të garantuara shprehimisht nga bankat qendrore dhe nga qeveritë qendrore të vendeve që nuk bëjnë pjesë në OECD, me përjashtim të rastit kur këto të drejta sipas rregullave në fuqi përfshihen në kapitalin rregullator të tyre.”

d) Në nenin 9 shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Banka e Shqipërisë, në rastet kur e gjykon të arsyeshme, mund të caktojë kërkesa dhe norma të përkohshme më kufizuese lidhur me ekspozimet e mëdha, të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë rregullore. Në këto raste, Banka e Shqipërisë përcakton kohën e vlefshmërisë së zbatimit të këtyre kërkesave/normave, dhe/ose masat dhe kohën e nevojshme për vendosjen e ekspozimeve brenda këtyre kufizimeve, si dhe mënyrën e monitorimit dhe raportimit të tyre.”.

2. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, rast pas rasti urdhëron vendosjen e kërkesave dhe normave të përkohshme më kufizuese lidhur me ekspozimet e mëdha, siç përcaktohet në shkronjën “d” pika 1 të këtij vendimi. Lidhur me këto masa, Guvernatori informon Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e tij më të afërt.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Stabilitetit Financiar, së bashku me Departamentin e Statistikave për të përgatitur dhe propozuar në Këshillin Mbikëqyrës të gjitha ndryshimet e nevojshme në formularët e raportimit (SRU) që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit European dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.89, datë 22.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 59 pika 3 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin nr.58, datë 5.5.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 12 pika 12.1 ndryshon si më poshtë:

“Lista e vendeve anëtare të OECD është lista më e fundit e publikuar nga kjo organizatë në faqen e saj zyrtare të internetit.”.

b) Neni 12 pika 2 shfuqizohet.

c) Pikat 12.3 dhe 12.4 të nenit 12 rinumërohen përkatësisht, si 12.2 dhe 12.3.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.90, datë 22.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE FINANCIARE JOBANKA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 126 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr.25, datë 24.3.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, neni 23 ndryshon si më poshtë:

“Lista e vendeve anëtare të OECD, është lista më e fundit e publikuar nga kjo organizatë në faqen e saj zyrtare të internetit.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.91, datë 22.12.2010

PËR SHFUQIZIMIN E UDHËZIMIT “MBI KUJDESTARINË DHE LIKUIDIMIN E BANKAVE”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.45, DATË 12.6.2002 TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë udhëzimin “Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave”, miratuar me vendimin nr.45, datë 12.6.2002 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Europian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 13.1.2011

Doli nga shtypi më 15.1.2011

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 64 lekë